



**KOMISIONI
EVROPIAN**

Bruksel, 4.11.2025

SWD(2025) 750 final

DOKUMENT PUNE I STAFIT TË KOMISIONIT

Raporti për Shqipërinë 2025

Dokument shoqërues i

**KOMUNIKIMIT NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN
EVROPIAN, KËSHILLIN, KOMITETIN EKONOMIK DHE
SOCIAL EVROPIAN DHE KOMITETIN E RAJONEVE**

Komunikimi i vitit 2025 për politikën e zgjerimit të BE-së

{COM(2025) 690 final} - {SWD(2025) 751 final} - {SWD(2025) 752 final} -
{SWD(2025) 753 final} - {SWD(2025) 754 final} - {SWD(2025) 755 final} -
{SWD(20245) 756 final} - {SWD(2025) 757 final} - {SWD(2025) 758 final} -
{SWD(2024) 759 final}

1. HYRJJE

1.1. KONTEKSTI¹

Pas konferencës së dytë ndërqeveritare të 15 tetorit 2024, e cila hapi negociatat e pranimit për Grupimin e I - rë “Themelorët”, u mbledhën edhe katër konferenca ndërqeveritare të cilat çuan në hapjen e negociatave për këto katër grupime kapitujsh. Shqipëria vazhdoi të zbatojë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, dhe mbledhjen e takimeve të përbashkëta sipas kësaj marrëveshjeje.

Angazhimi i fortë politik i autoriteteve shqiptare ndaj qëllimit strategjik të integritimit në BE është deklaruar vazhdimisht si përparësia kryesore e vendit, dhe një nivel i lartë ambicieje për të ecur përpara në negociatat e pranimit është ruajtur përgjithësisht. Momenti i vazhdueshëm në procesin e negociatave të pranimit duhet të çojë në reforma më të shpejta në lidhje me BE-në. Shqipëria ruajti rekordin e saj të përafrimit të plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së, duke u përafruar me qëndrimin e BE-së, duke përfshirë masat kufizuese dhe sanksionet kundër Rusisë. Qëndrimi i Shqipërisë dërgon një sinjal të fortë të zgjedhjes së saj strategjike për pranimin në BE dhe të rolit të saj si një partner i besueshëm.

Shqipëria është angazhuar në mënyrë aktive dhe ka filluar të zbatojë Planin e ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor në të katër shtyllat: (i) integrimi gradual me tregun e vetëm të BE-së; (ii) integrimi ekonomik rajonal; (iii) reformat themelore; dhe (iv) rritja e mbështetjes financiare. Sipas Programit të Reformës dhe Rritjes (RGF), një instrument i BE-së i bazuar në performancë që mbështet procesin e pranimit në BE, vendi miratoi axhendën e tij të reformave, e cila mbulon reformat në fushat e: (i) mjedisit të biznesit; (ii) kapitalit njerëzor; (iii) dixhitalizimit; (iv) energjisë dhe tranzicionit të gjelbër; dhe (v) të drejtave themelore dhe sundimit të ligjit. Pas vonesave fillestare në krijimin e strukturave të koordinimit të brendshëm, Shqipëria emëroi një koordinator kombëtar të RGF-së dhe vazhdoi të punojë drejt objektivave të axhendës së reformave.

Raporti² i Komisionit për Sundimin e ligjit për vitin 2025 e mbuloi Shqipërinë për herë të dytë.

1.2. GJETJET KRYESORE TË RAPORTIT

¹ Ky raport mbulon periudhën nga 1 shtatori 2024 deri më 1 shtator 2025. Ai bazohet në të dhëna nga një sërë burimesh, duke përfshirë kontributet nga qeveria e Shqipërisë, shtetet anëtare të BE-së, raportet e Parlamentit Evropian dhe informacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare dhe joqeveritare. Ai gjithashtu përfshin rezultatet e vlerësimeve krahasuese dhe indekseve të prodhuara nga palë të tjera të interesuara, veçanërisht në fushën e sundimit të ligjit.

Raporti përdor shkallën e mëposhtme të vlerësimit për të përshkruar gjendjen aktuale: fazë e hershme, një nivel i caktuar përgatitjeje, përgatitje mesatare, nivel i mirë përgatitjeje dhe shumë i avancuar. Për të përshkruar progresin e bërë gjatë periudhës së raportimit, ai përdor shkallën e mëposhtme: kthim prapa, asnjë progres, progres i kufizuar, një farë progresi, progres i mirë dhe progres shumë i mirë. Kur është e përshtatshme, janë përdorur edhe hapa të ndërmjetëm.

² COM(2025) 900 final.

GRUPKAPITULLI 1: THEMELORET E PROCESIT TË ADERIMIT

Demokracia

Kuadri i përgjithshëm mundëson zgjedhje përgjithësisht të lira dhe të ndershme. Zgjedhjet parlamentare të mbajtura më 11 maj 2025, të cilat pasuan një reformë të pjesshme zgjedhore, rezultuan në një mandat të katërt radhazi për partinë në pushtet. Përfundimet paraprake të misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) / Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) vunë në dukje se zgjedhjet ishin konkurruese dhe u administruan në mënyrë profesionale, por identifikuan disa mangësi, përfshirë mungesën e kushteve të barabarta të garës dhe abuzimin me burimet publike. Reforma e pjesshme zgjedhore ndryshoi Kodin Zgjedhor, por nuk adresoi një sërë rekomandimesh të kahershme të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias. Nevojitet një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse. Parlamenti ushtron kompetencat e tij në mënyrë pjesërisht efektive. Polarizimi politik, mungesa e dialogut të mirëfilltë politik dhe përplasjet mes shumicës qeverisëse dhe pjesëve të opozitës vijuan të ndikojnë në veprimtarinë e Parlamentit, ndërsa proceset e konsultimit publik mbetën të kufizuara. Parlamenti është gjithashtu i penguar nga mbikëqyrja e kufizuar mbi ekzekutivin, ndërsa politizimi i emërimeve parlamentare në pozita të larta në organet kushtetuese ose në institucionet e pavarura të krijuara me ligj mbetet një çështje serioze. U shprehën shqetësime lidhur me punën, metodologjinë dhe ndikimin e komisionit ad hoc parlamentar për thellimin e reformave për qeverisjen e mirë, sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit. Pas zgjedhjeve të 11 majit, numri i komisioneve të përhershme u rrit nga tetë në njëmbëdhjetë, prej të cilave katër kryesohen nga opozita.

Qeveria vijoi të dëshmojë angazhimin e saj ndaj integritetit në BE. Pas zgjedhjeve parlamentare të 11 majit, një qeveri e re mori detyrën në shtator 2025. Ndarja e kompetencave ndërmjet qeverisjes vendore dhe asaj qendrore mbetet një problem.

Organet përgjegjëse të Shqipërisë për procesin e integritetit në BE janë funksionale. Ato koordinuan me sukses qëndrimet kombëtare, duke çuar në hapjen e negociatave për pesë nga gjashtë grupkapitujt gjatë periudhës së raportimit. Ekspertiza për integritetin në BE, planifikimi dhe mekanizmat ndërinstitucionalë duhet të forcohen më tej për të mbështetur ambicien e Shqipërisë për të përshpejtuar reformat që kërkohen nga procesi i anëtarësimit në BE. Procesi i integritetit në BE duhet të jetë më gjithëpërfshirës, ndërpartiak dhe i mbështetur nga mekanizma efektivë konsultimi. Duhet intensifikuar përpjekjet e komunikimit mbi integritetin në BE.

Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) veprojnë në një mjedis pjesërisht mundësues. Ato përballen me sfida që lidhen me kërkesat për regjistrim dhe me financimin publik të kufizuar, si edhe me shtimin e narrativave negative dhe fushatave denigruese online.

Reforma e Administratës Publike

Shqipëria mbetet **mesatarisht e përgatitur** në fushën e reformës së administratës publike (PAR). Ajo bëri **njëfarë përparimi** gjatë periudhës raportuese, duke rezultuar në miratimin e Strategjisë së re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (ISAC) 2024–2030 dhe Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave 2024–2027 në dhjetor 2024, dhe të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën e Administratës Publike 2025–2030 në korrik 2025. Ndryshimet në ligjet për shërbimin civil dhe për organizimin e administratës shtetërore mbeten për t'u miratuar, me këto të fundit të paraqitura për konsultim publik. Praktika e rishikimit të buxhetit e kryer përmes akteve normative të miratuara nga ekzekutivi vazhdon. Axhenda e PAR vazhdon të ketë një lidhshmëri të qartë politik nëpërmjet Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- fillojë zbatimin e strategjisë së re të administratës publike dhe të rishikojë efektivitetin e strukturave aktuale të monitorimit; të kufizojë përdorimin e akteve normative për rishikimet e buxhetit dhe të ndjekë një kthim në proceset e rregullta të rishikimit të buxhetit;
- miratojë dhe zbatojë një kuadër të ri legjislativ për shërbimin civil, i cili përfshin rregulla të rishikuara mbi rekrutimin, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin bazuar në meritë në ligjin e shërbimit civil në të gjitha nivelet, veçanërisht në nivelin e lartë, dhe të fillojë përsëri automatizimi i sistemit të pagave;
- miratojë dhe zbatojë legjislacionin e rishikuar që rregullon siç duhet tipologjinë dhe kriteret për të ngritur institucionet e varësisë dhe për të sqaruar linjat e llogaridhënies.

Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e gjyqësorit dhe të të drejtave themelore dhe ka bërë **njëfarë përparimi** gjatë periudhës së raportimit.

Funksionimi i gjyqësorit

Shqipëria ndodhet ndërmjet një niveli **të moderuar dhe të mirë** të përgatitjes dhe ka bërë **njëfarë përparimi** në funksionimin e gjyqësorit. Shqipëria vazhdoi zbatimin e reformës në drejtësi. Procesi i rivlerësimit kalimtar (vetingut) për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët përfundoi në shkallë të parë, duke forcuar më tej pavarësinë dhe llogaridhënien gjyqësore. Procedurat e vetingut në apel janë përshpejtuar dhe aktualisht janë në rrugën e duhur për të përmbushur afatin kushtetues të qershorit 2026. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGj) ka miratuar akte nënligjore që përmirësojnë procedurat dhe standardet e zbatueshme për anëtarët e tij dhe për gjyqtarët. Këshilli i Lartë i

Prokurorisë (KLP) ka përmirësuar gjithashtu standardet e zbatueshme për magjistratët. KLGj ka vijuar me emërimet e reja të magjistratëve, duke kontribuar në uljen e vakancave në nivelin e shkallës së parë. Sfidat në emërimin e anëtarëve jo-magjistratë të KLGj dhe KLP, si dhe në kryerjen në kohë dhe me cilësi të vlerësimeve, emërimeve, ngritjeve në detyrë dhe transferimeve të magjistratëve, mbetën të pranishme. Ndërsa qëndrueshmëria e gjyqësorit është përmirësuar në tërësi, përpjekjet e shtuara të zyrtarëve publikë ose politikanëve për të ushtruar ndërhyrje dhe presion të pajustificuar mbi sistemin gjyqësor mbetën një shqetësim serioz. Është miratuar Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2024-2030. U alokua buxhet i mjaftueshëm për zhvillimin e një sistemi modern, të integruar, elektronik të menaxhimit të çështjeve, por funksionaliteti i plotë aktualisht parashikohet vetëm për vitin 2030. Çështje të ngutshme që lidhen me efikasitetin, cilësinë dhe integritetin gjyqësor ende duhet të adresohen, në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

Nevojiten përpjekje të qëndrueshme reformuese për të vijuar forcimin e sistemit gjyqësor dhe për të ruajtur standarde të larta integriteti pas përfundimit të procesit të vetingut. Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe për rrjedhojë mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin në vijim, Shqipëria duhet në veçanti të:

- **forcojë më tej llogaridhënien** duke: (i) përfunduar procesin e vetingut; (ii) përmirësuar standardet e vlerësimit të pasurisë dhe të pastërtisë së figurës, duke siguruar cilësi të lartë dhe përshtetshmëri të raporteve të vlerësimit për të gjithë magjistratët; (iii) përafruar rregullat e zbatueshme për të gjithë jo-magjistratët e KLGj dhe KLP me ato të zbatueshme për magjistratët, sa i përket deklarimit të pasurisë dhe verifikimeve të pastërtisë së figurës; (iv) plotësuar vakancat për inspektorë magjistratë në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë; dhe (v) ulur ndërhyrjen politike ndaj gjyqësorit dhe shërbimit të prokurorisë;
- **përmirësojë cilësinë e drejtësisë** duke: (i) plotësuar vakancat për kryetarë gjykatash, magjistratë, këshilltarë ligjorë dhe personel gjyqësor në të gjitha nivelet e gjyqësorit dhe duke rritur numrin total të magjistratëve dhe këshilltarëve ligjorë në të gjitha nivelet, drejt mesatares së BE-së; (ii) rishikuar në mënyrë gjithëpërfshirëse provimin e pranimin dhe kurrikulat e formimit fillestar dhe të vazhdueshëm të Shkollës së Magjistraturës; dhe (iii) rritur cilësinë dhe integritetin e stafit të Shkollës së Magjistraturës;
- **përmirësojë efikasitetin gjyqësor** duke: (i) miratuar masa tërësore ligjore dhe rregullatore për të rritur efikasitetin në të gjitha nivelet dhe për të ulur më tej numrin e çështjeve të prapambetura (backlog), në përputhje me Udhërrëfyesin për Efikasitetin Gjyqësor, parimet e reformës në drejtësi dhe standardet evropiane; (ii) përfunduar prokurimin dhe pilotimin e parë të moduleve të sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve; dhe (iii) zgjeruar sistemin e njoftimit online për akses në dosjet dhe proceset gjyqësore në të gjitha gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

Lufta kundër korrupsionit

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** dhe ka treguar **njëfarë përparimi**. Është miratuar Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024–2030. Struktura e Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) ka konsoliduar më tej rezultatet pozitive në luftën kundër korrupsionit të nivelit të lartë dhe ka bërë përparim të prekshëm drejt krijimit të një praktike të qëndrueshme rezultatesh në këtë fushë. Megjithatë, korrupsioni ka mbetur i përhapur në sektorët e cenueshëm, duke prekur si sferën publike, ashtu edhe atë private. Kuadri institucional për parandalimin e korrupsionit vazhdoi të ketë ndikim të kufizuar dhe bashkërendimi me organet e zbatimit të ligjit mbeti i dobët. Mangësitë lidhur me transparencën dhe efektivitetin e kontrolleve të deklaramit të pasurive mbeten për t'u adresuar.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe për rrjedhojë mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- **vazhdojë të forcojë hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin** e çështjeve të korrupsionit dhe të sigurojë më shumë vendime përfundimtare dënuese, veçanërisht në nivelet e larta; të përfshijë sekuestrimin dhe konfiskimin përfundimtar të aseteve kriminale që burojnë nga vepra penale të lidhura me korrupsionin; si dhe të rrisë referimet proaktive nga institucionet shtetërore përkatëse dhe agjencitë e zbatimit të ligjit drejt SPAK-ut;
- **plotësojë dhe thjeshtëzojë kuadrin ligjor të parandalimit të korrupsionit** në përputhje me standardet evropiane dhe të adresojë rekomandimet e mbetura të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO); të kryejë vlerësime të thelluara të rrezikut në sektorët e cenueshëm; të zbatojë me efektshmëri planet e integritetit në institucionet me rrezik të lartë korrupsioni, si p.sh. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK); dhe të rrisë kapacitetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit (DPA);
- **bëjë më efektive dhe transparente kontrollet e deklaramit të pasurive** nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe i Kontrollit të Pasurive dhe i Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) duke përditësuar procedurat dhe duke siguruar burime të mjaftueshme; duke adresuar pasuritë e padeklaruara ose të fshehura; si dhe duke siguruar që deklaramet e pasurisë së personave të ekspozuar politikisht të jenë të disponueshme publikisht online.

Të drejtat themelore

Kuadri ligjor i Shqipërisë përcakton **një bazë përgjithësisht të mirë** për mbrojtjen e të drejtave themelore. Gjatë periudhës së raportimit u arrit një sukses i rëndësishëm me miratimin e Ligjit të ri për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shtatë prej dhjetë akteve nënligjore zbatuese të tij, në përafrim të plotë me *acquis* të BE-së, si dhe me miratimin e akteve nënligjore për të drejtat e personave që u përkasin pakicave kombëtare, në fushat thelbësore të vetëidentifikimit dhe të përdorimit të gjuhëve të pakicave, në përputhje me standardet evropiane. Gëzimi i lirisë dhe pluralizmit të medias, i së drejtës së pronës dhe i të drejtave të personave që u përkasin pakicave mbetet problematik. Në përgjithësi, përpjekjet për zbatim duhet të intensifikohen.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan vetëm pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin në vijim, Shqipëria duhet në veçanti të:

- sigurojë zbatimin efektiv të kuadrit ligjor për të drejtat e personave që u përkasin pakicave dhe të rrisë kapacitetet dhe burimet e Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare dhe të autoriteteve vendore;
- zgjerojë gëzimin e së drejtës së pronës dhe sigurinë juridike duke: (i) bërë përparim me regjistrimet e para; (ii) digjitalizuar titujt e pronësisë, dokumentet dhe hartat; (iii) përmirësuar cilësinë dhe saktësinë e të dhënave kadastrale; (iv) rritur integritetin, transparencën dhe efektivitetin në ofrimin e shërbimeve publike në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës; dhe (v) avancuar me kompensimet dhe garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në rastet e shpronësimeve dhe heqjes së pronave;
- përafrohet më tej me *acquis* të BE-së dhe të zbatojë atë në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, përfshirë sa i përket orientimit seksual dhe shprehjes gjinore; të sigurojë që projektligji i ardhshëm për barazinë gjinore të ruajë një nivel të lartë ambicieje në përputhje me standardet e BE-së; dhe të dëshmojë kapacitet të mirë zbatimi për Ligjin e ri për mbrojtjen e të dhënave personale, të zbatojë me efektivitet Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës dhe të përmbyllë deinstitutionalizimin e fëmijëve.

Liria e shprehjes

Shqipëria ndodhet midis **njëfarë niveli të caktuar** dhe një **niveli mesatar** të përgatitjes në fushën e lirisë së shprehjes dhe ka bërë përparim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit. Situata mbetet kryesisht e pandryshuar: pavarësia dhe pluralizmi i medias vijojnë të preken nga ndërthurja e interesave të biznesit me ato politike, mungesa e transparencës mbi burimet e financimit, përqendrimi i lartë i pronësisë së mediave, intimidimi dhe kushtet e pasigurta të punës për gazetarët. Nisja e një dialogu të strukturuar midis institucioneve shqiptare dhe aktorëve të medias, si edhe miratimi i masave të buta për sigurinë e gazetarëve, përbënin zhvillime pozitive. Megjithatë, u ngritën shqetësime në lidhje me ligjshmërinë dhe respektimin e procedurës së rregullt gjatë nxjerrjes nga autoritetet kompetente të një mediaje nga zyrat në pronësi publike që ajo zotëronte.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- **miratojë një reformë madhore të kuadrit ligjor dhe rregullator** për të: (i) forcuar transparencën e pronësisë së mediave, pluralizmin mediatik dhe pavarësinë editoriale; (ii) forcuar transparencën e financimit të mediave nga burimet private dhe shtetërore; (iii) forcuar autonominë e rregullatorit të medias dhe pavarësinë e transmetuesit publik; (iv) shfuqizuar plotësisht dispozitat penale për fyerjen dhe shpifjen; dhe (v) përafrohet aspektet civile të shpifjes me standardet evropiane;
- **sigurojë tolerancë zero ndaj intimidimit** dhe zbatim efektiv në rastet e sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë ndjekjen gjyqësore; të sigurojë rritjen e kapaciteteve të organeve të zbatimit të ligjit për trajtimin e rasteve të dhunës, përfshirë protestat, si edhe të çështjeve

të tjera penale që përfshijnë gazetarë, veçanërisht duke garantuar një përputhje të lartë me të drejtat e njeriut në trajtimin e incidenteve që përfshijnë gazetarë, përmes udhëzimeve detyruese, mbledhjes së të dhënave dhe masave për ngritjen e kapaciteteve;

- **përmirësojë kushtet e punës së gazetarëve në Shqipëri**, veçanërisht duke forcuar mbrojtjen e punësimit dhe të të drejtave sociale të gazetarëve dhe duke siguruar që Kodi i Punës të zbatohet në mënyrë të qëndrueshme.

Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në përafrimin me *acquis të BE-së* në fushën e drejtësisë, lirisë dhe sigurisë dhe ka bërë **përparim të mirë** në këtë fushë. Kapaciteti dhe efektiviteti i Strukturës së Specializuar Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK) për të shkatërruar grupet e krimit të organizuar është rritur dhe përdorimi i hetimeve financiare është përmirësuar. Edhe pse funksionaliteti i tyre i plotë ende duhet të dwshmohet, Zyra për Rikuperimin e Aseteve dhe Sistemi Kombëtar i Paralajmërimit të Hershëm për zbulimin e substancave të reja psikoaktive u ngritën brenda Policisë së Shtetit Shqiptar . Observatori Kombëtar për Drogat është krijuar brenda Ministrisë së Shëndetësisë, megjithëse ende nuk është funksional. Shqipëria vazhdoi të zbatojë strategjinë e saj të migracionit, e cila është në përputhje me prioritetet e BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të garantuar akses efektiv në procedurat e azilit dhe për të harmonizuar plotësisht politikën kombëtare të vizave me atë të BE-së.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten, në masë të konsiderueshme, ende të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- zhvillojë më tej përdorimin sistematik të hetimeve financiare në trajtimin e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë trafikimin e paligjshëm, terrorizmin dhe pastrimin e parave;
- operacionalizojë Observatorin Kombëtar të Drogave dhe të rrisë funksionalitetin dhe produktivitetin analitik të Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm për identifikimin e substancave të reja psikoaktive, duke forcuar bashkëpunimin me Agjencinë e BE-së për Drogën;
- përmirësojë mekanizmin e referimit dhe aksesin efektiv në procedurat e azilit; të vazhdojë adresimin e kërkesave të pabazuara për azil të shtetasve shqiptarë në hapësirën Shengen dhe shtetet e shoqëruara; të sigurojë që rrugët ligjore për shtetasit e vendeve të treta në Shqipëri parandalojnë lëvizjet dytësore të parregullta drejt BE-së; dhe të harmonizojë më tej politikën kombëtare të vizave me listën e BE-së të vendeve të treta për të cilat kërkohet vizë.

Lufta kundër krimit të rëndë dhe të organizuar

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në luftën kundër krimit të organizuar. Është bërë **përparim i mirë** në përmbushjen e rekomandimeve të vitit të kaluar duke rritur kapacitetin e

SPAK-ut në hetimet financiare, duke forcuar luftën kundër pastrimit të parave dhe duke sekuestruar asetet e lidhura me krimin e organizuar. SPAK ka thelluar dhe konsoliduar bashkëpunimin me homologët ndërkombëtarë veçanërisht me shtetet anëtare dhe agjencitë e BE-së për hetimin dhe goditjen e grupeve kriminale me rrezik të lartë, duke dhënë rezultate të prekshme në fazën fillestare.

Shqipëria duhet të përshpejtojë punën për përafrimin e kuadrit të saj ligjor mbi krimin e organizuar me *acquis të BE-së*, të forcojë kapacitetin e zbatimit të ligjit dhe të përmirësojë efikasitetin e hetimeve, duke përfshirë edhe zhvillimin e aftësive të analizës kriminale dhe financiare.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- vazhdojë të forcojë historikun e saj të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në të gjitha fushat e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë trafikimin e drogës, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit; nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Shtetet Anëtare të BE-së dhe agjencitë e BE-së, si dhe duke rritur kapacitetin për të penguar krimin e organizuar; dhe duke siguruar përafrim të mëtijshëm me *acquis të BE-së*, veçanërisht në kriminalizimin e pastrimit të parave dhe në luftën kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve, si në internet ashtu edhe jashtë internetit.
- përmirësojë efikasitetin e sistemit të rikuperimit të aseteve, duke forcuar funksionimin e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve, përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale në kuadër të Policisë së Shtetit; veçanërisht të rrisë bashkëpunimin e saj operacional me zyrat e rikuperimit të aseteve në Shtetet Anëtare të BE-së; të përmirësojë zbatimin e instrumenteve të konfiskimit të të ardhurave nga krimi dhe të pasurisë që buron nga aktivitetet kriminale; si dhe të menaxhojë më mirë asetet e ngrira dhe të konfiskuara, në ripërdorimin social të tyre.
- përmirësojë kapacitetin e analizës kriminale dhe financiare, përmes bashkëpunimit të përforcuar ndëragjencor dhe zbatimit të metodologjive të avancuara për trajtimin e rasteve penale komplekse.

KRITERI EKONOMIK

Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Shqipëria ka një **nivel të mirë përgatitje** në zhvillimin e një ekonomie tregu funksionale dhe ka bërë **njëfarë përparimi** në këtë fushë. Ekonomia vijoi të ketë një rritje të fortë në vitin 2024 falë kërkesës së fortë të brendshme dhe turizmit. Inflacioni ra nën objektivin e bankës qendrore, ndërsa konsolidimi fiskal u përshpejtua dhe raporti i borxhit publik vazhdoi të binte. Pavarësisht rritjeve, të ardhurat qeveritare si pjesë e PBB-së mbeten të ulëta, ndërsa shpenzimet për investimet publike nuk janë realizuar edhe këtë vit. Situata e tregut të punës u përmirësua, por problemet strukturore vazhdojnë. Sektori bankar mbeti i qëndrueshëm, i mirë kapitalizuar dhe likuid, ndërsa kreditimi për sektorin privat u rrit. Mjedisi i biznesit mbetet i ndikuar nga një sundim i dobët i ligjit, qasje e kufizuar në financa dhe mangësi në mbikëqyrjen dhe qeverisjen e ndërmarrjeve shtetërore.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u trajtuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- zbatojë Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave dhe të përgatisë propozime për të ulur shpenzimet tatimore, duke i dhënë përparësi eliminimit të përjashtimeve që nuk kanë justifikim të shëndoshë të politikave;
- rrisë transparencën dhe llogaridhënien e ndërmarrjeve shtetërore, duke përfshirë edhe publikimin e raporteve të tyre vjetore të performancës financiare;
- përmirësojë operacionalizimin e kuadrit të menaxhimit të investimeve publike, duke përfshirë Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, dhe të sigurojë që projektet që hyjnë në Programin Buxhetor Afatmesëm të jenë të maturuara dhe me cilësi të mirë, me qëllim që të shmanget nën-ekzekutimi i investimeve publike.

Aftësia për të përballuar konkurrencën dhe forcat e tregut brenda BE-së

Shqipëria ka **njëfarë niveli përgatitje** për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së dhe ka bërë **përparim të kufizuar** në këtë fushë. Sistemi arsimor ende përballlet me sfida të shumta, hendeuku në aftësi vijon dhe shkalla e të rinjve jashtë arsimit, punësimit ose trajnimit (NEET) mbetet shqetësuese. Transporti dhe infrastruktura dixhitale janë përmirësuar, por boshllëqet në infrastrukturë mbeten. Shqipëria mbetet konkurruese si destinacion turistik, duke ofruar një gamë të zgjeruar të shërbimeve, por industria dhe bujqësia mbeten sektorë me produktivitet të ulët dhe që janë duke u tkurrur. Eksportet e prodhimit ranë për shkak të kërkesës së dobët, vlerësimit të kursit të këmbimit dhe çmimeve të ulëta të ofruara nga bizneset.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- vazhdojë të përmirësojë dhe promovojë më mirë sistemin e arsimit dhe trajnimit profesional (AFP) në mënyrë që të rrisë numrin e të diplomuarve nga shkollat AFP dhe të sigurojë që aftësitë e punës të përputhen me kërkesat e tregut të punës;
- përmirësojë cilësinë dhe përfshirjen e sistemit arsimor dhe të çojë përpara transformimin e tij dixhital;
- forcojë infrastrukturën, duke përfshirë ndërtimin e sigurisë kibernetike.

Kapitulli 5: Prokurimi publik

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në prokurimin publik. Është bërë progres i kufizuar në përafrimin e kuadrit ligjor për prokurimin publik.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti të:

- vazhdojë përpjekjet për të përmirësuar procedurat konkurruese të prokurimit;
- përafrojë më tej kuadrin ligjor me acquis të BE-së në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publik-private, dhe të fillojë puna për përafrimin e mëtejshëm me acquis të BE-së në fushën e prokurimit të mbrojtjes dhe sigurisë;
- sigurojë përputhshmërinë me acquis të BE-së dhe Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA) mbi marrëveshjet ndërqeveritare të lidhura me vendet e treta në fushën e prokurimit publik.

Kapitulli 18: Statistikat

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në mënyrë në fushën e statistikave.

Janë bërë disa përpertime në përmirësimin e përpilimit të statistikave makroekonomike në përputhje me Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA 2010), publikimin e të dhënave të detajuara të regjistrimit të popullsisë dhe banesave të vitit 2023, duke vazhduar përmirësimin e transmetimit të të dhënave në Eurostat.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- vazhdojë të rrisë prodhimin dhe shpërndarjen e të dhënave në kohë dhe me cilësi të lartë dhe t'i bëjë të dhënat e statistikave të financave qeveritare (SFQ) publike;
- përgatisë regjistrimin e për censin e bujqësisë të vitit 2026 në përputhje me acquis përkatëse të BE-së;
- sigurojë staf të mjaftueshëm në Institutin e Statistikave (INSTAT)

Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Shqipëria është **mesatarisht e përgatitur** në fushën e kontrollit financiar dhe pjesërisht e përafruar me acquis të BE-së. Pavarësisht miratimit të strategjisë kundër mashtrimit, është bërë **përparim i kufizuar** në këtë kapitull gjatë periudhës raportuese.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- përqendrohet në delegimin e më shumë përgjegjësiwe financiare dhe menaxheriale për të përmirësuar llogaridhënien menaxheriale;
- mbështetet në punën e bërë nga nënkomisioni parlamentar për auditimin, me një fokus të veçantë në sigurimin e mbikëqyrjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit nga ekzekutivi;
- forcojë kontrollet dhe të konsolidojë kapacitetet për të mbrojtur interesat financiare të BE-së, të sigurojë raportimin e duhur të parregullsive dhe të zbatojë strategjinë kundër

mashttrimit.

GRUPKAPITULLI 2: TREGU I BRENDSHËM

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Shqipëria është midis **njëfarë niveli përgatitjeje dhe një niveli mesatar përgatitjeje** në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave. Nuk ka përparim në lidhje me përafrimin me *acquis* të BE-së gjatë periudhës raportuese.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- përfundojë përafrimin e legjislacionit të saj me *acquis* përkatëse të BE-së mbi infrastrukturën e cilësisë, d.m.th. mbi akreditimin, vlerësimin e konformitetit dhe mbikëqyrjen e tregut;
- forcojë kapacitetin zbatues të inspektoratit të mbikëqyrjes së tregut;
- përfundojë dhe miratojë një plan veprimi në përputhje me nenet 34-36 të Traktatit për Funksonimin e Bashkimit Evropian (TFBE), duke mbuluar plotësisht fushën e pa harmonizuar, duke parashikuar edhe afatet kohore për shqyrtimin e të gjithë legjislacionit dhe praktikave si dhe futjen e klauzolave të njohjes reciproke ose shfuqizimin dhe/ose ndryshimin e legjislacionit dhe praktikave sipas nevojës.

Kapitulli 2: Lëvizja e lirë e punëtorëve

Shqipëria është midis **njëfarë niveli përgatitjeje dhe një niveli mesatar përgatitjeje** në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve. Njëfarë progresi është arritur duke lidhur marrëveshje dypalëshe të sigurimeve shoqërore me shtetet anëtare të BE-së dhe duke përparuar më tej me përgatitjet për lidhjen e Sistemit të Shërbimeve të Punësimit të Shqipërisë me Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Punësimit (EURES).

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- vazhdojë zhvillimin e sistemit të IT-së të Shërbimeve të Punësimit për të mundësuar lidhjen e saj me EURES pas anëtarësimit;
- forcojë zbatimin e Ligjit për të huajt sipas Strategjisë Kombëtare të Migracionit 2024 - 2026;
- vazhdojë negociatat dhe lidhjen e marrëveshjeve të reja dypalëshe mbi sigurimet shoqërore, veçanërisht me shtetet anëtare të BE-së, dhe të zhvillojë infrastrukturën e IT-së për qëllime të Kartës Evropiane të Sigurimit Shëndetësor (EHIC) dhe Shkëmbimit Elektronik të Informacionit të Sigurimeve Shoqërore (EESSI), si dhe kapacitetet

administrative për t'u bashkuar me rrjetin EESSI.

Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Shqipëria është në nivel mesatar përgatitjeje në fushën e të drejtës së vendosjes dhe lirisë për të ofruar shërbime. Nuk është arritur asnjë përparim në periudhën raportuese.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk janë zbatuar dhe mbeten të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- fillojë ndryshimin e legjislacionit për të adresuar barrierat ndaj lirisë së vendosjes dhe lëvizjes së lirë të shërbimeve, të cilat janë identifikuar gjatë procesit të vetë-shqyrtimit ushtrimor (self-screening exercise) në vitin 2023.
- vazhdojë përpjekjet për të përafruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së dhe të sigurojë kapacitetin e duhur institucional në fushën e njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale.

Kapitulli 4: Lëvizja e Lirë e Kapitaleve

Shqipëria është midis një niveli mesatar përgatitjeje dhe një niveli të mirë përgatitjeje në fushën e lëvizjes së lirë të kapitalit. Është bërë njëfarë përparimi drejt përafrimit më tej me *acquis* të BE-së për pagesat, gjë që i mundësoi Shqipërisë të bashkohej me fushëveprimin gjeografik të skemave të Zonës së Vetme të Pagesave në Euro (SEPA) në nëntor 2024, e cila hyri në fuqi në tetor 2025.

Shqipëria ka vijuar me masat kundër pastrimit të parave, në veçanti me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- sigurojë trajtim të barabartë të qytetarëve të BE-së dhe qytetarëve shqiptarë në blerjen e tokës, në përputhje me detyrimin e Shqipërisë nën MSA-së;
- ndërmarrë veprime për të siguruar që dispozitat e *acquis* të BE-së mbi Rregulloren ndërkufitare, Rregulloren SEPA, Rregulloren e Pagesave të Menjëhershme dhe tarifat e shkëmbimit të zbatohen;
- vazhdojë zbatimin e Strategjisë kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2024-2030 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për Vlerësimin e Rrezikut 2024-2027.

Kapitulli 6: Legjislacioni për shoqëritë tregtare

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e të drejtës së shoqërive tregtare. Është bërë përparim i kufizuar gjatë periudhës së raportimit përmes miratimit të Ligjit për auditimin dhe kontabilitetin, me synim përafrimin e mëtejshëm me *acquis* të BE-së.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht të:

- bëjë përparim në përafrimin me *acquis* të BE-së, duke përfshirë miratimin e ndryshimeve që lidhen me përdorimin e mjeteve digjitale, konvertimet ndërkufitare, bashkimet dhe

ndarjet, si dhe me nxitjen e angazhimit afatgjatë të aksionarëve;

- vazhdojë zbatimin e Ligjit të ndryshuar për auditimin dhe të vijojë përpjekjet për të përafruar më tej kuadrin ligjor për kontabilitetin dhe auditimin me *acquis* më të fundit të BE-së në këto fusha.

Kapitulli 7: Pronësia Intelektuale

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në fushën e të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR). Është bërë njëfarë përparimi me miratimin e ligjeve të reja për markat tregtare dhe patentat. Projektligji i ri për të drejtën e autorit është përgatitur dhe është dorëzuar për konsultim dhe miratim.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- sigurojë përputhshmërinë me *acquis* përkatëse të BE-së për IPR-në dhe të fillojë të zbatojë ligjet e reja për të drejtën e autorit, markat tregtare dhe patentat;
- vazhdojë të përmirësojë funksionimin e OMK-ve (organizatat e menaxhimit kolektiv), veçanërisht në aspektin e zbatimit dhe mbledhjes së të drejtave të autorit dhe pagesave për mbajtësit e të drejtave; të forcojë zbatimin e të gjitha aspekteve të sistemit të IPR-së përmes monitorimit, buxhetimit, rritjes së ndërgjegjësimit, forcimit të kapacitetit institucional dhe trajnimit.

Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Shqipëria është ndërmjet njëfarë niveli përgatitjeje dhe një niveli mesatar përgatitjeje në fushën e politikës së konkurrencës. Ka pasur përparim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit, duke përfshirë përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së në lidhje me referimet e rasteve që lidhen me përqendrimit.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar vetëm në një masë të kufizuar dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht të:

- sigurojë pavarësinë operacionale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore (KNSH) dhe të rrisë ndjeshëm kapacitetin administrativ të sekretariatit të tij;
- përafrojë më tej kuadrin ligjor në fushën e ndihmës shtetërore me *acquis* të BE-së;
- intensifikojë përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e gjyqësorit, ministrive përkatëse dhe autoriteteve rajonale e lokale mbi ligjin e konkurrencës dhe rregullat e ndihmës shtetërore, për të siguruar që KNSH të njoftohet paraprakisht për masat e ndihmës dhe për të forcuar zbatimin e rregullave të konkurrencës dhe të ndihmës shtetërore.

Kapitulli 9: Shërbimet Financiare

Shqipëria është midis një niveli mesatar përgatitje dhe një niveli të mirë përgatitjeje në fushën e shërbimeve financiare. Është bërë njëfarë përparimi në përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit të vendit me *acquis* të BE-së mbi fondet private të pensione.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar u zbatuan pjesërisht dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- vazhdojë të punojë drejt përafrimit të plotë të Rregullores Bankare të Shqipërisë me versionet e ndryshuara të Direktivës së Kërkesave për Kapital CRD/Rregullores (CRR), Direktivës për Rimëkëmbjen dhe Zgjidhjen e Bankave (BRRD) dhe Direktivës së Skemave të Garancisë së Depozitave (DGS) dhe *acquis* të BE-së mbi tregjet e kapitalit, duke përfshirë tregjet e letrave me vlerë, fondet e investimeve dhe infrastrukturën e tregjeve financiare.
- përfundojë përafrimi i *acquis*-së të sigurimeve, duke përfshirë Direktivën Solvency 2.
- sigurojë që Banka Kombëtare e Zhvillimit të jetë e mirë rregulluar dhe e mbikëqyrur, duke përfshirë aktivitetet e saj të pranimit të depozitave.

Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Përgatitjet janë në një fazë të hershme në fushën e mbrojtjes së konsumatorit dhe shëndetit. Nuk pati përparim në përafrimin me *acquis* të BE-së në këtë fushë.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar nuk u zbatuan dhe mbeten të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet veçanërisht të:

- bëjë përparim në përafrimin e legjislacionit të konsumatorit me *acquis* më të fundit të BE-së për të adresuar zhvillimet në këtë fushë;
- përfundojë përafrimin me *acquis* të BE-së në lidhje me produktet mjekësore për përdorim njerëzor dhe veterinar, pajisjet mjekësore dhe kontrollin e duhanit;
- rrisë burimet financiare dhe njerëzore në sektorin e shëndetësisë, në veçanti në kujdesin parësor shëndetësor dhe gatishmërinë për emergjencë shëndetësore të çdo lloji, si dhe të garantojë akses të barabartë në shërbime shëndetësore cilësore për popullatat vulnerabël, në veçanti për gratë dhe vajzat që i përkasin këtyre grupeve.

GRUPKAPITULLI 3: KONKURRUESHMËRIA DHE RRIJTJA GJITHËPËRFSHIRËSE

Kapitulli 10: Transformimi digjital dhe media

Shqipëria është e përgatitur midis një niveli të moderuar dhe të mirë të përgatitjes në fushën e transformimit digjital dhe mediave, dhe ka bërë progres/përparim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit. Ligji aktual për sigurinë kibernetike ka mundësuar një përputhje më të madhe me Udhëzimin e BE-së për masat për një nivel të lartë të përbashkët të sigurisë kibernetike në

Bashkimi Evropian (Direktiva NIS 2). Në qershor 2025, Shqipëria miratoi një listë të përditësuar të Operatorëve të Infrastrukturës Kritike dhe të Rëndësishëm të Informacionit.

Po ashtu, është miratuar Strategjia e re për Sigurinë Kibernetike 2025-2030 dhe Plani i saj I Veprimit për vitet 2025-2027.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti të:

- miratojë vendimin për të zgjeruar shtrirjen e numrit emergjent 112 në të gjithë vendin;
- finalizojë legjislacionin zbatues për Ligjin për komunikimet elektronike dhe Ligjin për sigurinë kibernetike;
- përmirësojë qasjen në përdorimin e shërbimeve elektronike, të zhvillojë këtë kapacitet dhe të intensifikojë mbledhjen e të dhënave statistikore mbi performancën digjitale dhe konkurrueshmërinë digjitale sipas Indeksit të Ekonomisë dhe Shoqërisë Digjitale (DESI).

Kapitulli 16 “Tatimet”

Shqipëria është e përgatitur mesatarisht e përgatitur në fushën e taksimit. Gjatë periudhës raportuese është bërë njëfarë progresi, kryesisht përmes miratimit të Strategjisë Afatmesme të të Ardhurave dhe raportit mbi vlerësimin e përjashtimeve tatimore, duke hapur rrugën për masa të përmirësuara të politikës tatimore dhe reforma të mëtejshme në vitet e ardhshme.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- zvogëlojë numrin e përjashtimeve tatimore, në përputhje me Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave të miratuar, dhe të ndjekë përafrimin gradual të legjislacionit të TVSH-së dhe akcizave me acquis të BE-së;
- thjeshtojë sistemin tatimor për të inkurajuar pajtueshmërinë tatimore dhe të përmirësojë përdorimin e të dhënave të palëve të treta në luftën kundër mashtrimit dhe evazionit tatimor;
- vazhdojë përgatitjet drejt arritjes së ndërlidhjes dhe ndërveprimit me sistemet e përbashkëta të IT-së të taksimit të BE-së.

Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

Shqipëria është përgatitur midis një niveli të moderuar dhe të mirë të përgatitjes në fushën e politikës ekonomike dhe monetare dhe ka bërë njëfarë përparimi/progresi, sepse Banka e Shqipërisë ka ruajtur stabilitet të çmimeve.

Shqipëria ka vazhduar konsolidimin fiskal dhe ka respektuar rregullat fiskale.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti të:

- harmonizojë plotësisht Ligji për Bankën e Shqipërisë me *acquis*-në e BE-së;
- miratojë ligjin për krijimin e një institucioni fiskal të pavarur;
- harmonizojë legjislacionin dhe praktikën buxhetore të Shqipërisë me kërkesat e *acquis*-së së BE-së.

Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi

Shqipëria është e përgatitur në një nivel të moderuar në fushën e politikës sociale dhe punësimit dhe ka bërë progress/përparim të kufizuar gjatë periudhës së raportimit. Nuk ekzistojnë masa për krijimin dhe zbatimin e një mekanizmi indeksimi për përfitimet e ndihmës ekonomike. Kërkohet punë më e madhe në lidhje me përsheptimin në harmonizimin e legjislacionit me Ligjin e Punës të BE-së dhe *acquis*-në për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe me *acquis*-në e BE-së në fushën e mosdiskriminimit dhe barazisë, përfshirë edhe barazinë gjinore.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet të:

- krijojë Këshillin Ndërmintor për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe sekretariatit e tij, duke përfshirë hartimin e rregullave/procedurave përkatëse dhe zhvillimin e kapacitetit të anëtarëve të tij, të rrisë dhe forcojë koordinimin ndërsektorial dhe ngritjen e kapacitetetve dhe të stafit të komunave;
- zbatojë Garancinë për të Rinjtë dhe Planin e saj të zbatimit në më shumë rajone, duke marrë parasysh mësimet e nxjerra nga faza pilot;
- rrisë më tej buxhetin, ofrimin e shërbimeve sociale dhe monitorimin e Fondit Social, të forcojë kapacitetet e qeverisjes lokale për të siguruar financim të mjaftueshëm dhe të zhvillojë një sistem të koordinuar referimi të shërbimeve sociale, i zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në nivel lokal.

Kapitulli 20: Politika e ndërmarrjeve dhe industriale

Shqipëria është e përgatitur në një nivel mesatar deri në të mirë në fushën e politikës së ndërmarrjeve dhe industriale dhe ka bërë disa përparime, veçanërisht përmes rishikimit të **Strategjisë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve (BIDS)**.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Gjatë vitit të ardhshëm, Shqipëria duhet, në veçanti të:

- përsheptojë adresimin e sfidave kryesore në mjedisin e biznesit duke përmirësuar parashikueshmërinë e masave rregullatore dhe të përmirësojë zbatimin e BIDS, veçanërisht duke siguruar financimin e nevojshëm për veprimet e parashikuara;
- shpejtojë përafrimin e plotë me Direktivën e BE-së për pagesat e vonuara;

- hartojë dhe miratojë një ligj të unifikuar për investimet, i cili të adresojë sfidat aktuale me të cilat përballen investitorët dhe të sigurojë tituj pronësie të saktë/plotë ligjërisht.

Kapitulli 25 “Shkenca dhe kërkimi Shkencor”

Shqipëria është e përgatitur një nivel të pjesshëm dhe mesatar përgatitjeje në fushën e shkencës dhe kërkimit. Është bërë njëfarë progresi, veçanërisht me miratimin e Strategjisë së Specializimit Inteligjent dhe Ligjit për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor, i cili është i përafëruar me acquis përkatëse të BE-së, si dhe me thirrjen e parë të suksesshme të menaxhuar nga Agjencia Shqiptare e Start-Up-eve.

Megjithatë, Shqipëria ende duhet të miratojë aktet nënligjore të nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030.

Rekomandimet e Komisionit nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- rrisë investimet në kërkim shkencor, në përputhje me angazhimet e veta dhe me prioritetet e reja të Zonës Evropiane të Kërkimit, me synim arrijtjen e nivelit prej 1% të PBB-së deri në vitin 2030;
- zbatojë Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Specializimin Inteligjent;
- prodhojë statistika dhe të dhëna të besueshme mbi inovacionin, shkencën dhe teknologjinë, me qëllim përmirësimin e klasifikimit të Shqipërisë në tabelën evropiane të inovacionit.

Kapitulli 26 “Arsimi dhe Kultura”

Shqipëria është e përgatitur një nivel mesatar deri të mirë përgatitjeje në fushën e arsimit dhe kulturës. Është arritur njëfarë progresi përmes zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe miratimit të akteve ligjore që synojnë reformimin e arsimit të lartë.

Megjithatë, Shqipëria duhet të forcojë më tej cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e sistemit arsimor. Gjithashtu, aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeumet ende nuk janë finalizuar.

Rekomandimet e Komisionit Evropian nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten kryesisht të vlefshme. Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- optimizojë më tej sistemin e arsimit dhe formimit profesional (AFP), në përputhje me nevojat e tregut të punës;
- përmirësojë më tej zhvillimin profesional dhe formimin e mësuesve dhe trajnerëve, me fokus në:
 - (i) aftësitë pedagogjike për zbatimin e qasjeve gjithëpërfshirëse të bazuara në kompetenca, dhe

- (ii) digjitalizimin në të gjitha nivelet arsimore – nga parashkollorja deri në arsimin e lartë, duke përfshirë edhe arsimin dhe formimin profesional (AFP);
- miratojë aktet nënligjore për zbatimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzeumet, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Kapitulli 29 “Shërbimet Doganore”

Shqipëria është e përgatitur midis një niveli të moderuar dhe një niveli të mirë përgatitjeje në fushën e Bashkimit Doganor. Është bërë njëfarë progresi me ndryshimet në dispozitat ligjore për kodin doganor, zhvillimin e sistemit të ri të kompjuterizuar të tranzitit (NCTS) dhe dixhitalizimin e më shumë shërbimeve doganore.

Rekomandimet e Komisionit Evropian nga viti i kaluar janë zbatuar pjesërisht dhe mbeten të vlefshme.

Në vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet në veçanti të:

- miratojë dhe zbatojë dispozitat ligjore që rregullojnë procedurën e përbashkët të tranzitit në nivel kombëtar, si dhe të finalizojë zhvillimin e komponentit kombëtar të sistemit NCTS;
- vazhdojë përgatitjet për ndërlidhjen dhe ndërveprimin e sistemeve të saj kombëtare të teknologjisë së informacionit (IT) doganore me mjedisin elektronik doganor të Bashkimit Evropian;
Shqipëria është palë në konventat kryesore ndërkombëtare për drogën, por duhet të sigurojë përafrim të plotë me këto konventa në lidhje me kriminalizimin e trafikimit të substancave të paligjshme dhe transmetimin e mostrave të substancave të kontrolluara. Shqipëria duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me *acquis* të BE-së mbi veprat penale dhe dënimet në lidhje me trafikimin e drogës, duke përfshirë substancat e reja psikoaktive.

Në korrik 2025, Shqipëria krijoi zyrtarisht një observator kombëtar për drogën, i cili ende nuk është funksional, ndërsa funksionimi dhe rezultati i sistemit kombëtar të paralajmërimit të hershëm për zbulimin e substancave të reja psikoaktive të ngritura brenda Policisë së Shtetit Shqiptar duhet të rritet. Ndryshime të mëtejshme në Ligjin për drogat narkotike dhe substancat psikotrope u miratuan në dhjetor 2024.

Për kultivimin e ligjshëm të kanabisit për qëllime mjekësore dhe industriale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Kanabisit është aktive dhe Shqipëria ka miratuar 21 akte nënligjore, përfshirë dispozita që lidhen me sigurinë. Masat e forta mbrojtëse janë thelbësore për të parandaluar devijimin e kanabisit drejt përdorimeve të paautorizuara dhe, nëse kultivimi nis në periudhën e ardhshme, ato duhet të zhvillohen më tej dhe të zbatohen rreptësisht.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca.

Bashkëpunimi ndërkombëtar policor dhe gjyqësor është i mirëkonsoliduar. Shqipëria është e angazhuar në mënyrë aktive në prioritetet e EMPACT në fushën e narkotikëve. Shumica e ekipeve të përbashkëta hetimore në të cilat merr pjesë Shqipëria janë në fushën e narkotikëve, duke konfirmuar trendin e vitit të kaluar. Bashkëpunimi operacional që synon adresimin e prodhimit dhe trafikimit të drogës nëpërmjet Shqipërisë dhe grupeve të krimit të organizuar shqiptare duhet të përmirësohet më tej.



Nevojiten përpjekje të mëtejshme ndaj hetimeve financiare për të sekuestruar dhe konfiskuar asetet kriminale të trafikantëve të drogës dhe për të rritur identifikimin dhe shpërbërjen e grupeve kriminale shqiptare.

Zbatimi i marrëveshjeve të punës me Agjencinë e BE-së për Drogën kërkon një angazhim më proaktiv, koordinim më të mirë ndërinstitucional dhe shkëmbim të rregullt

informacioni.

Ka pasur një rritje të konsiderueshme në shkatërrimin e drogës në vitin 2024, pothuajse ekskluzivisht për shkak të shkatërrimit të kanabisit. Numri i rasteve të prodhimit dhe trafikimit të drogës mbeti përgjithësisht i qëndrueshëm në vitin 2024 (krahasuar me vitin 2023), por me një rritje të konsiderueshme në numrin e individëve dhe personave juridikë që morën një vendim gjyqësor të formës së prerë në vitin 2024.

Lufta kundër terrorizmit dhe parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Kuadri ligjor për luftën kundër terrorizmit dhe për luftimin e ekstremizmit të dhunshëm është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Lufta kundër terrorizmit dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm është në përgjithësi i kënaqshëm.

Kuadri ligjor për mbrojtjen e infrastrukturës kritike nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së. Mbrojtja e infrastrukturës kritike duhet të përmirësohet.

Kuadri ligjor, strategjik dhe institucional

Kuadri ligjor i Shqipërisë në fushën e terrorizmit është pjesërisht i përafëruar me *acquis* të BE-së. Ajo duhet të përafrohet legjislationin e saj mbi prekursorët e lëndëve plasëse me *acquis* të BE-së. Një strategji ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe kundër terrorizmit 2023-2025 dhe planet e veprimit përkatëse, si dhe një strategji kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030 dhe planet e veprimit përkatëse janë në fuqi.

Shqipëria ka një koordinator kombëtar për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, i cili kryeson Qendrën e Koordinimit për Luftimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, të krijuar në vitin 2017.

Niveli i përgatitjes për mbrojtjen e infrastrukturës kritike mbeti i ulët gjatë periudhës së raportimit. Ligji për mbrojtjen e infrastrukturës kritike ende nuk është miratuar dhe duhet të përafrohet me Direktivën e BE-së për qëndrueshmërinë e entiteteve kritike. Mbrojtja e infrastrukturës kritike në fushën e sigurisë kibernetike parashikohet nga Ligji për sigurinë kibernetike i vitit 2024. Një listë e përditësuar e operatorëve të infrastrukturës kritike dhe të rëndësishme të informacionit u miratua nga qeveria në korrik 2025.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Niveli i përgjithshëm i kërcënimit nga terrorizmi në Shqipëri vlerësohet i ulët. Institucionet e zbatimit të ligjit dhe të drejtësisë, përgjegjëse për luftën kundër terrorizmit, ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe efektive. Shqipëria ka bërë përparim në zbatimin e Strategjisë 2023–2025 për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, por qeveria duhet të ndajë burime të mjaftueshme për zbatimin e kësaj strategjie dhe planit përkatës të veprimit. Policia e Shtetit ka referuar të paktën gjashtë raste veprash penale me qëllim terrorist pranë Zyrës së Prokurorit të Posaçëm dhe prokurorive të rretheve gjatë viteve 2024 dhe 2025. Kapacitetet hetimore dhe prokurore duhet të forcohen, veçanërisht në nivel vendor.


Rehabilitimi dhe riintegrimi i 38 luftëtarëve të huaj terroristë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, të kthyer zyrtarisht nga Siria/Iraku përmes proceseve të riatdhesimit, po trajtohet në mënyrë efektive. Autoritetet duhet të kenë buxhet të mjaftueshëm për këtë punë në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria afatmesme dhe ajo afatgjatë. Qeveria po vazhdon përpjekjet e saj për të riatdhesuar ata që mbeten në kampet Al-Hol dhe Al-Roj në Siri. Me shumë mundësi, mbi 70 qytetarë shqiptarë ende qëndrojnë në kampe.

Dimensioni lokal i parandalimit të radikalizimit, si edhe koordinimi ndërmjet nivelit kombëtar dhe atij vendor, janë forcuar falë krijimit të keshillave rajonale të sigurisë, të cilët kryesohen nga prefektët.

Radikalizimi online, radikalizimi në burgje dhe përmbajtja terroriste online mbeten sfida të mëdha. Monitorimi i përmbajtjes online paraqet vështirësi pasi kapacitetet dhe burimet institucionale janë të kufizuara. Shqipëria gjithashtu duhet të përmirësojë aftësinë e saj për të monitoruar dhe luftuar financimin e terrorizmit, duke zbatuar kuadrin ligjor ekzistues dhe duke marrë parasysh ndikimin e teknologjive të reja (p.sh. kriptovalutat).

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale

Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe penale me Shtetet Anëtare të BE-së, Zyrën e




Prokurorit Publik Evropian (EPPO) dhe Eurojust mbetet në përgjithësi i kënaqshëm. Në vitin 2024, EPPO i ka dërguar autoriteteve shqiptare tre kërkesa për ndihmë të ndërsjellë juridike. Shqipëria është përfshirë në 152 çështje të reja pranë Eurojust, që lidhen kryesisht me krimin e organizuar, trafikun e drogës dhe pastrimin e parave, shumica prej të cilave (89) janë hapur me kërkesë të

Prokurorit Lidhës.

Numri i ekipeve të përbashkëta hetimore të mbështetura nga Eurojust, në të cilat ka marrë pjesë Shqipëria, është 25 për periudhën nga 1 mars 2024 deri më 31 korrik 2025. Shumica e këtyre ekipeve (16) vazhdojnë të punojnë në fushën e narkotikëve.

Kuadri ligjor për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile dhe penale është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së, në masën që përafrimi është aktualisht i mundur. Më 13 shkurt 2025, Shqipëria ratifikoi Konventën e Hagës të datës 2 korrik 2019 “Për njohjen dhe zbatimin e vendimeve të huaja gjyqësore në çështjet civile ose tregtare” (Konventa e Vendimeve 2019), e cila do të hyjë në fuqi për Shqipërinë më 1 mars 2026. Kjo Konventë do të forcojë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare të BE-së dhe Shqipërisë, do të sigurojë siguri dhe parashikueshmëri juridike për palët e përfshira në transaksione ndërkufitare dhe do të përmirësojë aksesin në drejtësi.



Migracioni i rregullt dhe i parregullt

Kuadri ligjor për migracionin është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së. Menaxhimi i migracionit të rregullt dhe të parregullt vlerësohet përgjithësisht si i kënaqshëm.

Përafrimi ligjor, kuadri strategjik dhe institucional


Ligji i rishikuar “Për të huajt” u miratua në qershor 2025. Zbatimi i strategjisë kombëtare të migracionit (2024–2030), e miratuar në maj 2024, dhe i planit të saj të veprimit (2024–2026), është aktualisht në proces zbatimi. Kërkohej koordinim i vazhdueshëm me të gjitha shërbimet përkatëse përtej Ministrisë së Brendshme. Strategjia përfshin prioritetet dhe objektivat kryesore të përcaktuara në planin e veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, të paraqitur nga Komisioni në dhjetor 2022, dhe është e përafruar me strategjitë kombëtare përkatëse dhe angazhimet e ndërmarra në kuadër të Aleancës Globale të BE-së për Luftën kundër Kontrabandës së Emigrantëve.

Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në Aleancën Globale për Luftën kundër Kontrabandës së Emigrantëve dhe është ftuar të vazhdojë angazhimin e saj me rastin e konferencës së dytë të Aleancës Globale, e cila pritet të zhvillohet në fund të vitit 2025.

Shqipëria fitoi statusin e vëzhguesit në Rrjetin Evropian të Migracionit në qershor 2025.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Shqipëria bashkëpunoi me BE-në, me agjencitë e saj dhe me Shtetet Anëtare në zbatimin e planit të veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, çka ndihmoi në uljen e mëtejshme të numrit të migrantëve të parregullt të kapur në Shqipëri. Shumica e migrantëve të parregullt në vitin 2024 ishin sirianë, pakistanezë ose egjiptianë. Tendenca në rënie e mbërritjeve të parregullta ka vazhduar edhe në vitin 2025. Raportimi i rregullt dhe në kohë nga autoritetet shqiptare mbi flukset e migracionit të parregullt dhe mbi azilin ka vijuar.




Aktualisht, Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme pritëse me rreth 600 shtretër, përfshirë 220 shtretër në qendrën e pritjes për azilkërkuesit në Babrru. Ka nisur puna e shumëpritur për ngritjen e ambienteve të destinuara për pritjen dhe akomodimin e të miturve të pashoqëruar.

Fëmijët e pashoqëruar duhet të integrohen në një sistem kombëtar efektiv të mbrojtjes së fëmijës, ndërsa procedurat e paravlerësimit (pre-screening) për të gjithë migrantët, në të gjitha pikat e kalimit kufitar, duhet të standardizohen.

Puna për hartimin e planit Kombëtar të Kontigjencës të përditësuar për pritjen e një numri të konsiderueshëm migrantësh dhe azilkërkuesish u përshpejtua gjatë vitit 2025, me ndihmën e Agjencisë së BE-së për Azilin dhe Agjencisë Evropiane për Rojën Kufitare dhe Bregdetare (Frontex), si edhe të Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin dhe Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët. Plani i Kontigjencës ende duhet të miratohet, së bashku me buxhetin përkatës.

Aftësia e oficerëve kufitarë për të identifikuar aplikantët për azil, vulnerabël për mbrojtje ndërkombëtare dhe migrantë duhet të përmirësohet, si edhe koordinimi i tyre me njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe ato kundër trafikimit. Shqipëria duhet të rrisë aftësinë për të kryer kthimet e migrantëve që nuk kanë të drejtë ligjore qëndrimi në vend dhe të adresojë mangësitë e konstatuara në mekanizmin e kthimit.

Shqipëria ka një marrëveshje ri-pranimi me BE-në, e cila funksionon mirë, si dhe protokolle zbatimi që lehtësojnë më tej zbatimin e saj, të nënshkruara me 14



Shtete Anëtare. Sipas të dhënave të publikuara nga Shtetet Anëtare në EUROSTAT për vitin 2024, 15 125 shtetas shqiptarë janë urdhëruar të largohen nga BE-ja dhe 7 805 janë kthyer efektivisht. Sistemi elektronik i menaxhimit të rasteve të ri-pranimi (e-RCMS) me Belgjikën është instaluar, por ende nuk është vënë në funksion. Bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe Frontex për operacionet e kthimit është shumë i mirë.

Riintegrimi i personave të kthyer, veçanërisht i personave më vulnerabël, duhet të përmirësohet. Numri i shtetasve të vendeve jo-anëtare të BE-së që janë kthyer në mënyrë vullnetare nga Shqipëria në vendet e tyre të origjinës mbeti shumë i ulët: në vitin 2024 u regjistruan 24 kthime vullnetare të asistuara, krahasuar me 9 në 2023 (dhe 6 në 2022).

Shqipëria duhet të bëjë progres në vendosjen e bashkëpunimit për kthimet e shtetasve të vendeve jo-anëtare të BE-së me vendet e origjinës dhe të rrisë angazhimin e saj aktiv me këto vende.

Shqipëria duhet të sigurojë që mundësitë ligjore për hyrjen dhe qëndrimin e shtetasve të vendeve të treta në Shqipëri të parandalojnë, dhe jo të nxisin, lëvizjet e tyre të parregullta të mëtejshme drejt vendeve të BE-së.

Azili

Kuadri institucional dhe përafrimi ligjor

Kuadri ligjor dhe institucional është në fuqi, por menaxhimi i azilit duhet përmirësuar në praktikë.

Ligji “Për azilin” është në përputhje të gjerë me *acquis* të BE-së. Bashkëpunimi me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA) për zbatimin e tij vazhdon në kuadër të fazës së dytë të “Udhërrëfyesit të Bashkëpunimit Shqipëri–EUAA (2024–2027)”, e miratuar në tetor 2024.


Shqipëria ka institucionet e nevojshme për trajtimin e kërkesave për azil. Ligji për azilin dhe aktet nënligjore përkatëse ende duhet të zbatohen në mënyrë efektive. Kjo kërkon investime shtesë për kapacitetet administrative dhe zhvillimin e një sistemi funksional dhe efikas për trajtimin e kërkesave për azil.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Shqipëria mbetet kryesisht një vend transit. Numri i kërkesave për azil është ulur në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023, në përputhje me rënien e ndjeshme të mbërritjeve.

Nga të gjithë migrantët e ndaluar për herë të parë, 7.5% kanë paraqitur kërkesë për azil.

Sfidat vazhdojnë për sa i përket kapacitetit të Policisë së Kufirit dhe Migracionit për të identifikuar dhe referuar personat që mund të kenë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare tek shërbimet përkatëse. Drejtoria për Migracionin, Azilin, Luftën kundër Trafikimit dhe të Huajt ka nevojë për më shumë kapacitete teknike dhe burime njerëzore për të vlerësuar rastet e azilit dhe për të marrë vendime të informuara mirë.



Që prej vitit 2018, Shqipëria ka dhënë statusin e refugjatit vetëm për një person. Në vitin 2024, 16 persona kanë përfituar mbrojtje dytësore.

Politika e vizave

Politika e vizave e Shqipërisë ende nuk është plotësisht e përafruar me atë të BE-së, veçanërisht sa i përket listës së vendeve, shtetasit e të cilave kanë nevojë për vizë hyrjeje.

Progresi drejt përafrimit mbetet i ngadaltë.

Shqipëria vijon të zbatojë regjimin pa viza me njëmbëdhjetë vende që figurojnë në listën e BE-së të vendeve, shtetasve të të cilave u kërkohet vizë; nga këto, gjashtë gëzojnë përjashtim të përhershëm nga regjimi i vizave, ndërsa pesë përfitojnë nga përjashtimi i përkohshëm nga detyrimi për vizë, i cili zbatohet nga prilli në dhjetor (kjo praktikë nuk është në përputhje me *acquis*-në e BE-së).

Në prill 2025, Shqipëria hoqi Bjellorusinë nga lista e vendeve me regjim të përhershëm pa viza (me efekt nga tetori 2025), si edhe Bahreinin nga lista e vendeve që gëzonin regjim të përkohshëm pa viza.

Shqipëria është angazhuar për një përafrim të mëtejshëm me listën e BE-së të vendeve shtetasve të të cilave u kërkohet vizë. Në korrik 2025, Shqipëria propozoi një udhërrëfyes drejt përafrimit të plotë me politikën e vizave të BE-së, me afate të përcaktuara për përfundimin e secilit regjim pa viza, si atij të përhershëm, ashtu edhe sezonal, çka përbën një zhvillim pozitiv.

Raporti i Shtatë i Komisionit Evropian në kuadër të Mekanizmit të Pezullimit të Vizave, i datës 6 dhjetor 2024, arriti në përfundimin se Shqipëria kishte ndërmarrë veprime për të adresuar shumicën e rekomandimeve të mëparshme. Shqipëria pritet të vazhdojë përpjekjet për të reduktuar më tej kërkesat e pabazuara për azil nga shtetasit shqiptarë në Shtetet Anëtare të BE-së, përveç angazhimit të përafrimit të plotë të politikës së saj të vizave me atë të BE-së dhe forcimit të kontrollit ndaj shtetasve të vendeve joanëtare të BE-së që hyjnë pa viza në Shqipëri.

Menaxhimi Schengen dhe kufijtë e jashtëm

Kuadri ligjor dhe strategjik për menaxhimin e kufijve të jashtëm është pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së.

Menaxhimi i kufijve është në përgjithësi i kënaqshëm. Megjithatë, Shqipëria pritet të avancojë procesin drejt miratimit të një Plan Veprimi Schengen, me qëllim krijimin e një sistemi të konsoliduar kombëtar në lidhje me Schengen.

Përafrimi ligjor, kuadri strategjik dhe institucional

Ligji i rishikuar “Për kontrollin kufitar” u miratua në qershor 2025. Rregullat mbi informacionin e avancuar të pasagjerëve (API) dhe të dhënat e emrit të pasagjerit (PNR) tashmë janë pjesë e një ligji të veçantë, gjithashtu të miratuar në qershor 2025.

Zbatimi i *acquis* Schengen duhet të forcohet më tej përmes zhvillimit të një sistemi të menaxhimit Schengen, të mbështetur nga një Plan Veprimi gjithëpërfshirës dhe me vizion afatgjatë, i cili është aktualisht në përgatitje. Shqipëria është ftuar të zhvillojë një analizë të plotë të nevojave për ngritjen e një kuadri kombëtar të menaxhimit, në funksion të miratimit dhe zbatimit të Planit të Veprimit Schengen. Kjo do të garantonte një zbatim efikas dhe të integruar të detyrimeve Schengen, përfshirë investimet e mëtejshme në infrastrukturë, pajisje, staf dhe trajnime.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Zbatimi i Marrëveshjes së përditësuar të Statusit me Frontex të qershorit 2024 po ecën mirë. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021–2027 është në vijim. Personeli i Policisë Kufitare u shtua ndjeshëm në vitin 2024. Po në vitin 2024, Shqipëria zhvilloi 1 063 patrulla të përbashkëta në përputhje me protokollet përkatëse me Italinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën*, 6% më pak se në vitin 2023.

Pas miratimit zyrtar të krijimit të Qendrës Kombëtare të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit në dhjetor 2024, Shqipëria inkurajohet të sigurojë që ajo të bëhet plotësisht funksionale sa më shpejt të jetë e mundur.

Sistemi total i menaxhimit të informacionit (TIMS) ende ka dobësi në sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave, të cilat duhet të adresohen urgjentisht.

Falsifikimi i euros (aspekti penal)

Kuadri ligjor i përkatës është në përgjithësi është i përafëruar me *acquis*-në e BE-së në fushën e luftës kundër falsifikimit të monedhës.

Të gjitha aspektet e bashkëpunimit doganor mbulohen në *Kapitullin 29 – Bashkimi Doganor*.

2.3. KRITERI EKONOMIK

<i>Table 19</i>	2016-21	2022	2023	2024
Albania - Key economic figures	average			
GDP per capita (% of EU-27 in PPS) ¹⁾	30	34	36	37
Real GDP growth	3.2	4.8	4.0	4.0
Activity rate of the population aged 15-64 (%) , total	68.2	73.2	75.4	75.7
<i>female</i>	60.0	66.8	69.8	69.3
<i>male</i>	76.5	80.0	81.0	82.3
Unemployment rate of the population aged 15-64 (%) , total	13.1	11.3	10.1	9.4
<i>female</i>	12.7	11.7	10.3	10.0
<i>male</i>	13.4	10.9	9.9	8.9
Employment of the population aged 15-64 (annual growth %)	1.8	4.8	1.6	-1.6
Nominal wages (annual growth %)	3.0	8.2	14.0	9.8
Consumer price index (annual growth %)	1.7	6.7	4.8	2.2
Exchange rate against EUR	128.0	119.0	108.8	100.7
Current account balance (% of GDP)	-7.6	-5.9	-1.2	-2.4
Net foreign direct investment, FDI (% of GDP)	7.6	6.6	5.8	5.4
General government balance (% of GDP)	-3.1	-3.6	-1.3	-0.7
General government debt (% of GDP)	70.7	64.1	57.6	54.2
<i>Notes :</i>				
1) Eurostat				
<i>Sources: INSTAT, Central Bank of Albania, Ministry of Finance and Eurostat</i>				

2.3.1. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionale

Qeverisja ekonomike

Qeveria mbeti e përkushtuar në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe në nxitjen e rritjes ekonomike. Në vitin 2024, rezultati fiskal u përmirësua krahasuar me vitet e mëparshme dhe tejkaloi objektivat buxhetore, por kjo pjesërisht erdhi si pasojë e mosrealizimit të plotë të shpenzimeve kapitale. Praktika e ndryshimit të buxhetit përmes akteve normative, në vend të


përdorimit të procesit të rregullt legjislativ, vazhdoi (me tre rishikime të buxhetit në vitin 2024 dhe dy të tjera deri në korrik 2025).

Strategjia Afatmesme e të Ardhurave 2024–2027, e miratuar nga Këshilli i Ministrave në dhjetor 2024, synon të rrisë të ardhurat publike (me 64.8 miliardë lekë ose rreth 2.6% të PBB-së së vitit 2024), kryesisht përmes përmirësimit të administratës tatimore dhe doganore (85% e rritjes së pritshme të të ardhurave), dhe jo përmes ndryshimeve të politikave tatimore. Shqipëria dorëzoi në kohë Programin e Reformave Ekonomike (PRE) 2025–2027 në Komisionin Evropian në mesin e janarit 2025. PRE nënvizoi angazhimin e qeverisë për të ruajtur stabilitetin makroekonomik, për të arritur suficit në bilancin primar dhe për të respektuar rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit. Shqipëria gjithashtu u angazhua për reforma socio-ekonomike dhe themelore për të përshpejtuar rritjen dhe konvergjencën me BE-në.

Zbatimi i udhëzimeve të politikave të përcaktuara në Konkluzionet e Dialogut Ekonomik dhe Financiar të majit 2024 ka qenë i pjesshëm. Shqipëria ka respektuar rregullat fiskale mbi bilancin buxhetor dhe borxhin publik dhe ka përshpejtuar ritmin e konsolidimit fiskal falë performancës më të mirë se parashikimi të ekonomisë dhe të ardhurave. Detyrimet e prapambetura vazhduan rritjen gjatë vitit 2024 dhe, megjithëse objektivi vjetor për reduktimin e tyre u arrit, mbështetja në shlyerjen e mëvonshme përmes rialokimeve buxhetore duhet të zëvendësohet gradualisht.

Të ardhurat tatimore si pjesë e PBB-së u rritën në 2024 dhe është hartuar një deklaratë e veçantë mbi rreziqet fiskale, e cila ende nuk është publikuar. Transparenca dhe llogaridhënia e ndërmarrjeve shtetërore mbetet për t'u përmirësuar. Autoritetet kanë punuar për ligjin mbi partneritetet publik-privat (PPP), por projektligji është ende në pritje të miratimit nga Kuvendi. PPP-të nuk janë ende të integruara në Listën Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare.

Stabiliteti makroekonomik



Ekonomia ruajti një moment të fortë rritjeje. Pas një rritjeje të PBB-së prej 4% në vitin 2023, zgjerimi ekonomik mbeti i fortë edhe në vitin 2024 me 4%, i nxitur nga kërkesa e brendshme e fuqishme, performanca e mirë e turizmit dhe aktiviteti i qëndrueshëm i ndërtimit.

Rritja e konsumit të familjeve u mbështet nga rritja e pagave reale, në një periudhë ngadalësimi të


inflacionit, si dhe nga zgjerimi i kreditimit. Konsumi publik u rrit për shkak të fazës së dytë të

reformës së pagave në sektorin publik. Krijimi i vendeve të reja të punës në sektorin e shërbimeve kontribuoi në rritjen e punësimit.

Eksportet e shërbimeve u zgjeruan, por eksportet e mallrave ranë ndjeshëm për shkak të mbiçmimit të lekut dhe mjedisit të pafavorshëm të jashtëm. Si rezultat, kontributi neto i eksporteve në rritjen e PBB-së ishte negativ.


Shumica e sektorëve ekonomikë shënuan rritje pozitive të prodhimit, por bujqësia dhe industria u tkurrën. Aktiviteti ekonomik vazhdoi të zgjerohej edhe në vitin 2025, me PBB-në që regjistroi një normë vjetore rritjeje prej 3.4% në tremujorin e parë. PBB-ja për frymë e Shqipërisë në standardet e fuqisë blerëse arriti në 37% të mesatares së BE-27 në vitin 2024, krahasuar me 30% në vitin 2019.

Deficiti i llogarisë korente mbeti në nivele të moderuara. Ai u rrit në 2.4% të PBB-së në vitin 2024, pas një niveli historikisht të ulët prej 1.2% të PBB-së në vitin 2023. Zgjerimi i deficitit në 2024 u shkaktua kryesisht nga rritja e deficitit tregtar të mallrave, për shkak të rënies së eksporteve dhe rritjes së vazhdueshme të importeve të nxitura nga zgjerimi i shpejtë i kërkesës së brendshme.



Bilanci i shërbimeve mbeti në një suficit të fortë, i nxitur nga turizmi. Suficiti i bilancit të të ardhurave dytësore ra, me remitancat që ranë nga 4.3% e PBB-së në vitin 2023 në 4.2% në vitin 2024 (pavarësisht rritjes së tyre nominale). Bilanci i të ardhurave parësore ishte paksa negativ në 0.8% të PBB-së. Në tremujorin e parë të vitit 2025, deficiti i llogarisë rrjedhëse u ngushtua, me totalin e tij të 4 tremujorëve që arriti në 2.1% të PBB-së (kryesisht për shkak të një rritjeje të eksporteve të mallrave dhe shërbimeve). Hyrjet neto të investimeve të huaja direkte (IHD) mbetën burimi kryesor i financimit të deficitit të llogarisë rrjedhëse në vitin 2024. Ato u rritën me 7% nga viti në vit në vitin 2024, por pjesa e tyre në PBB ra në 5.4%, nga 5.8% një vit më parë. Sektori i pasurive të paluajtshme mbeti përfituesi më i madh i flukseve të IHD-ve. Rezervat ndërkombëtare u rritën në 6.2 miliardë euro në dhjetor 2024, duke mbuluar shtatë muaj importesh mallrash dhe shërbimesh. Raporti i borxhit të jashtëm ndaj PBB-së ka qenë në një trend në rënie dhe ka rënë me 0.7 pikë përqindjeje në 46.8% në vitin 2024.

Inflacioni ra nën objektivin prej 3% të bankës qendrore. Inflacioni vjetor mesatarisht ishte 2.2% në vitin 2024, nga 4.8% në vitin 2023 dhe një nivel i lartë prej 6.7% në vitin 2022. Ky dezinflacion i vazhdueshëm është nxitur nga çmimet më të ulëta të ushqimeve dhe mallrave dhe një monedhë vendase në rritje. Inflacioni i importuar arriti nivele historikisht të ulëta në vitin 2024 për shkak të mbiçmimit të kursit të këmbimit. Nga ana tjetër, presionet inflacioniste vendase janë moderuar më gradualisht për shkak të kërkesës së fortë dhe një tregu të ngushtë pune. Inflacioni bazë ra gjithashtu në vitin 2024. Banka e Shqipërisë zbatoi dy ulje të normës bazë të interesit të politikës monetare në vitin 2024, duke e ulur atë nga 3.25% në 2.75%, dhe një ulje të mëtejshme në korrik 2025, në 2.5%. Në dy muajt e parë të vitit 2025, inflacioni shënoi një rënie të lehtë në 1.9% dhe më pas u rrit në 2.5% në korrik 2025.



Konsolidimi fiskal u përshpejtua në vitin 2024, por deficit i buxhetor pritet të rritet ndjeshëm në vitin 2025. Deficiti buxhetor ra nga 1.3% e PBB-së në vitin 2023 në 0.7% të PBB-së në vitin 2024, duke tejkaluar ndjeshëm objektivin e deficitit prej 2.3% të PBB-së. Ndërsa të ardhurat patën një performancë të mirë, ky rezultat fiskal ishte pjesërisht rezultat i nën-ekzekutimit të investimeve

publike. Suficiti i bilancit primar ishte 1.4% e PBB-së (nga 0.7% e PBB-së në vitin 2023), duke mbështetur rënien e raportit të borxhit publik, i cili ra me 3.4 pikë përqindjeje në 54.2% të PBB-së në vitin 2024⁵. Megjithatë, nevojat bruto të financimit mbeten të larta. Buxheti i vitit 2025, i miratuar në dhjetor 2024, parashikon që deficitin të rritet në 2.6% të PBB-së. Në tetë muajt e parë të vitit 2025, zbatimi i buxhetit tregoi një suficit fiskal prej 1.6% të PBB-së. Shpenzimet tatimore, të vlerësuara në 4-5% të PBB-së,⁶ dhe nivelet e larta të informalitetit ende kufizojnë bazën e të ardhurave. Si pjesë e zbatimit të MTRS, në qershor 2025 qeveria finalizoi një raport mbi përjashtimet ekzistuese nga taksat, por vlerësimi nuk është bërë publik dhe propozime konkrete për të eliminuar ato përjashtime që nuk janë të justifikueshme mirë nuk janë zhvilluar ende. Në vitin 2025, Shqipëria ndryshoi ligjin e tatimit mbi të ardhurat dhe zgjeroi stimujt e saj të rëndësishëm tatimorë për hotelet luksoze⁷, gjë që bie ndesh me angazhimin e Shqipërisë për të ulur shpenzimet tatimore. Një raport më i lartë i të ardhurave publike ndaj PBB-së është thelbësor për të mbështetur investimet si në kapitalin fizik ashtu edhe në atë njerëzor, duke ankoruar fort trendin në rënie të borxhit publik.

Korniza rregullatore për menaxhimin e investimeve publike është përmirësuar vitet e fundit, por sfidat mbeten. Në shkurt të vitit 2024, qeveria përditësoi udhëzimet e PIM-it ku u prezantuan shpjegime, duke përfshirë rolin e Ministrisë së Financave në situata të caktuara, dhe atë të Agjencisë për Planifikimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës së Huaj (SASPAC). Ndryshime në kuadrin ligjor u bënë gjithashtu në mars të vitit 2025, kur qeveria miratoi ndryshimet në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 887/2022 mbi procedurat e menaxhimit të investimeve publike, duke përfshirë përditësimet tremujore të Listës Unike të Projekteve të Rëndësishme Kombëtare (NSPP) dhe fleksibilitetin e shtuar për studimet e fizibilitetit. Megjithatë, planifikimi dhe ekzekutimi i projekteve të investimeve publike vazhdon të përballet me pengesa të konsiderueshme në formën e kufizimeve të kapaciteteve,

⁵ Në shkurt të vitit 2025, Shqipëria emtoi eurobondin e saj të shtatë, me vlerë 650 milionë euro, me një maturim dhjetëvjeçar dhe një normë kupon prej 4.75%. Në mars të vitit 2025, S&P e përmirësoi vlerësimin e borxhit sovran të Shqipërisë nga BB- në BB. Raporti i borxhit publik ndaj PBB-së vazhdoi të binte në gjysmën e parë të vitit 2025.

⁶ Sipas burimeve kombëtare, siç është MTRS, e cila i referohet raportit 'Shpenzimet Tatimore 2021-2022'.

⁷ Sipas ligjit të ndryshuar së fundmi për tatimin mbi të ardhurat, institucionet me katër dhe pesë yje përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat e korporatave për një periudhë 10-vjeçare, me kusht që të përmbushin pragje specifike investimi dhe të marrin një status të veçantë siç përcaktohet në Ligjin për turizmin. Këto hotele përfitojnë gjithashtu nga përjashtimet nga tatimi mbi pronën dhe tatimi mbi ndikimin në infrastrukturë dhe gëzojnë një normë të reduktuar të TVSH-së prej 6% për të gjitha shërbimet e ofruara. Parlamenti e zgjati afatin e fundit për periudhën e aplikimit për këto lehtësime tatimore nga viti 2024 në vitin 2026.

propozimeve të paplota të projekteve, vonesave dhe tejkalimeve të kostove, si dhe një mungesë të herëpashershme të respektimit të procedurave. Nën-ekzekutimi i përsëritur në shpenzimet kapitale është një tregues i qartë se ekzistojnë mangësi në funksionalizimin e kuadrit të ri ligjor dhe të NSPP-së.

Shqipëria zbatoi një miks të përgjithshëm të përshtatshëm politikash makroekonomike.

Kjo ndihmoi në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik dhe mbështeti rritjen ekonomike. Nga ana fiskale, deficitet buxhetor u ngushtua, suficiti në bilancin primar u rrit, ndërsa raporti i borxhit publik vazhdoi rrugën e tij në rënie. Ndërsa dezinflacioni u përshpejtua, me inflacionin që ra nën objektivin e bankës qendrore, politika monetare u lehtësua. Në të njëjtën kohë, mbikëqyrja bankare ka qenë e kujdesshme, me shtesën kundërciklike të kapitalit të rritur dy herë mes zgjerimit të fortë të kreditit.

Funksionimi i tregjeve të produkteve

Mjedisi i biznesit

Mjedisi i biznesit mbetet sfidues. Bizneset mirëpresin faktin se ka pasur disa përparime në reformën në drejtësi dhe çështjet kundër korrupsionit, por procedurat e gjata gjyqësore vazhdojnë (shih Kapitullin 23 - *Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore*). Mjedisi i biznesit gjithashtu mbetet i prekur nga dobësitë në sundimin e ligjit, informaliteti dhe qasja e kufizuar në financë për NVM-të, veçanërisht fermerët. Burokracia dhe procedurat e gjata të licencimit, të kombinuara me problemet e qëndrueshmërisë në jurisprudencë, krijojnë barrë për bizneset. Politikat e qarta që inkurajojnë pajtueshmërinë efektive tatimore dhe zvogëlojnë evazionin fiskal do të ndihmonin në formalizimin e më shumë bizneseve dhe zgjerimin e bazës tatimore. Dhënia e statusit të investitorit strategjik dhe kontratat PPP/koncesionare shpesh konsiderohen jo transparente nga bizneset. Vendi gjithashtu përballet me regjistrimin e paplotë dhe të paqëndrueshëm të titujve të pronësisë, duke çuar në pasiguri dhe mosmarrëveshje mbi pronësinë, të cilat pengojnë investimet.⁸ Edhe pse Shqipëria ka bërë përpjekje për të modernizuar sistemin e saj të pronave përmes digjitalizimit të kadastrës, progresi ka qenë i ngadaltë dhe i pabarabartë. Pavarësisht përpjekjeve për derregullim dhe lehtësim të shërbimeve të lidhura me biznesin, reagimi i institucioneve publike për të ofruar shërbime efikase është i ngadaltë, ndërsa ofrimi i shërbimeve mbetet shumë i centralizuar në Tiranë, duke lënë rajonet rurale të pashërbyera. Efektiviteti i proceseve të konsultimit publik vazhdon të tregojë hapësirë për përmirësim.

Ndikimi i shtetit në tregjet e produkteve

Miratimi i një ligji të unifikuar për investimet është shtyrë më tej, ndërsa Ligji për investimet strategjike është zgjatur deri në vitin 2026. Puna për krijimin e një kuadri ligjor të harmonizuar për investimet filloi vite më parë, por progresi ka ngecur. Kjo iniciativë synon të zëvendësojë Ligjin ekzistues për investimet strategjike, duke ofruar një mjedis ligjor më koheziv dhe transparent si për investitorët vendas ashtu edhe për ata të huaj. Ndërkohë, në shkurt 2025, Parlamenti ndryshoi Ligjin për investimet strategjike, duke i zgjatur efektet e tij deri në vitin 2026, dhe përfshiu në kategorinë e investitorëve strategjikë investime me vlerë 50 milionë euro ose më shumë, pavarësisht nga sektori, me kusht që ato të merrnin miratimin paraprak nga Ministria e linjës. Ndërkohë që këto masa janë hartuar për të nxitur aktivitetin

⁸ Sipas Agjendës së Reformës, Shqipëria u zotua të analizojë kuadrin aktual ligjor për Investimet e Huaja Direkte (FDI) dhe të hartojë e miratojë një ligj të unifikuar për investimet deri në dhjetor 2026.

ekonomik,⁹ ato kanë ngritur gjithashtu shqetësime në lidhje me transparencën dhe aksesin e barabartë, favorizimin dhe mungesën e proceseve konkurruese.

Banka e Shqipërisë prezantoi një program financimi për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Në fillim të vitit 2025, në bashkëpunim me qeverinë, banka qendrore nisi një skemë financimi për të përmirësuar aksesin në kredi për NVM-të, veçanërisht në bujqësi, i cili është një sektor që përbën vetëm 2% të kredive për bizneset. Banka e Shqipërisë synonte të financonte programin me 250 milionë euro, duke ofruar kredi përmes bankave tregtare. Ai gjithashtu përfshinte një garanci sovranë që mbulonte deri në 70% të principalëve të kredisë. Normat e interesit janë të kufizuara në 3.5% ose të ulura në 2% nëse zbatohet garancia sovranë. Afati i fundit për aplikime është fundi i vitit 2025.

Privatizimi dhe ristrukturimi

Rregullorja që lejon privatizimin e aseteve publike, tokës ose aseteve të luajtshme, është ndryshuar. Shqipëria prezantoi disa ndryshime në rregulloren që parashikon privatizimin e aseteve publike. Sipas rregullave të rishikuara, subjektet që kanë siguruar kontrata qiraje afatgjata për asetet publike me çmime simbolike (p.sh. 1 euro) dhe kanë përdorur asetet/tokën shtetërore për më shumë se një dekadë mund t'i blejnë ato asete në kushte të caktuara. Zbatimi i kësaj iniciative duhet të sigurojë trajtim të barabartë të investitorëve. Qeveria gjithashtu miratoi rregullore për të lehtësuar transferimin e aseteve publike në Korporatën Shqiptare të Investimeve për programe të mëtejshme zhvillimi dhe rivitalizimi në partneritet me investitorë privatë. Në mars të vitit 2025, Parlamenti miratoi legjislacionin e 'Paketës së Maleve'. Kjo iniciativë synon të stimulojë rritjen ekonomike në rajonet malore të Shqipërisë duke promovuar investimet në sektorë si turizmi dhe bujqësia, duke ofruar stimuj fiskalë dhe duke ofruar disa përfitime për blerjen e tokës për ata që investojnë në këto zona. Është thelbësore të mbrohen vlerat ekologjike dhe të biodiversitetit të Shqipërisë dhe të sigurohet transparencë e plotë gjatë gjithë procesit.

NSH-të paraqesin rreziqe fiskale dhe qeverisja e tyre ende duhet të përmirësohet. Ndërmarrjet shtetërore, veçanërisht kompanitë e energjisë në pronësi të shtetit, marrin kredi nga qeveria qendrore, por shlyerja është e paparashikueshme, ndërsa qëndrueshmëria financiare e disa prej këtyre kompanive është e dobët. Për shkak të rreziqeve që i kanosen buxhetit, monitorimi i ndërmarrjeve shtetërore është thelbësor. Njësia e Riskut Fiskal e Ministrisë së Financave e zgjeroi numrin e ndërmarrjeve shtetërore të monitoruara në 12. Ndiqma teknike është gjithashtu e vazhdueshme për të përmirësuar praktikatat e raportimit financiar të ndërmarrjeve shtetërore dhe monitorimin e performancës së tyre financiare. Publikimi i raporteve vjetore të performancës financiare nga ndërmarrjet shtetërore duhet të bëhet praktikë standarde, ndërsa forcimi i mbikëqyrjes së ndërmarrjeve shtetërore mbetet thelbësor. Qeverisja e dobët e ndërmarrjeve shtetërore kontribuon në shtrembërimet e tregut dhe kushtet e padrejta të konkurrencës.¹⁰

Funksionimi i tregut financiar.


⁹ The measures also strengthen the role of the Albanian Investment Development Agency in scrutinising and vetting investors.

¹⁰ Më shumë detaje mbi çështjet dhe zhvillimet kryesore të ndërmarrjeve shtetërore mund të gjenden në Perspektivën e Konkurrueshmërisë së Ballkanit Perëndimor 2024: Shqipëria të OECD-së.

Sektori bankar mbeti i mirë kapitalizuar dhe fitimprurës, ndërsa raporti i kredive me probleme u ul. Në nivel të përgjithshëm, bankat kishin një raport të mjaftueshmërisë së kapitalit prej 19.8% në dhjetor 2024, që është shumë mbi kërkesën minimale të Shqipërisë prej 12%. Pas një performance shumë të mirë në vitin 2023, fitimi i bankave vazhdoi të përmirësohej në vitin 2024, i mbështetur nga rritja e të ardhurave neto nga interesi, të ardhurat më të larta nga tarifat dhe komisionet dhe ulja e provizioneve për humbjet nga kreditë. Raporti i kredive me probleme ishte 4% në korrik 2025, nga 4.7% një vit më parë. I nxitur nga kërkesa më e lartë dhe kushtet e favorshme të financimit, kredia për sektorin privat u përshpejtua në vitin 2024. Megjithatë, niveli i ndërmjetësimit financiar mbeti i ulët - pjesa e kredive të sektorit privat në PBB ishte 33% në gjysmën e parë të vitit 2025. Pjesa e lartë e letrave me vlerë të qeverisë midis aseteve të bankave vazhdon t'i ekspozojë ato ndaj rrezikut sovran. Është bërë përpërim i mirë në mbledhjen e të dhënave mbi ekspozimin e bankave ndaj sektorit të pasurive të paluajtshme dhe në monitorimin e standardeve të kredisë për kreditë e pasurive të paluajtshme. Banka e Shqipërisë ndërmori masa të reja makroprudenciale të bazuara në huamarrje për të adresuar rreziqet e mundshme në sektorin e pasurive të paluajtshme. Ajo gjithashtu ka rritur shtesën kundërciklike të kapitalit në 0.5% (në fuqi nga dhjetori 2025). Përpjekjet për të forcuar mbikëqyrjen e institucioneve financiare jobankare duhet të vazhdojnë.

Në mars 2025, u miratua ligji që themeloi Bankën Shqiptare të Zhvillimit si një institucion që pranon depozita. Ligji ngre shqetësime të mëdha në lidhje me pajtueshmërinë me rregullat e konkurrencës dhe ndihmës shtetërore të BE-së në fushën e bankave. Banka e zhvillimit duhet të ketë një kuadër operativ që zbut rreziqet morale dhe rreziqet fiskale nga garancitë shtetërore, dhe përputhet me praktikën më të mira në aspektin e qeverisjes, si dhe mbikëqyrjen dhe rregullimin e duhur që zbatohet për institucionet e tjera që pranojnë depozita, për të siguruar transparencë, praktika të shëndosha huadhënieje, mbrojtje të mjaftueshme të depozitave dhe kushte të barabarta loje në sektorin bankar.

Funksionimi i tregut të punës



Tregu i punës regjistroi zhvillime pozitive, por përballet me probleme strukturore. Tregu i punës në Shqipëri shfaqti përmirësime të dukshme në vitin 2024, me një rritje të shkallës së punësimit (një rritje prej 1.5 pikësh përqindjeje nga viti në vit në 68.3% në tremujorin e katërt të vitit 2024) dhe paga më të larta, së bashku me një rënie të shkallës së papunësisë (një rënie prej 0.6 pikësh përqindjeje nga viti në vit në 9.6% në tremujorin

e katërt të vitit 2024). Shkalla e papunësisë tek të rinjtë u përmirësua gjithashtu krahasuar me një vit më parë, duke rënë nga 21.2% në 19.1%, por mbetet e lartë. Skema pilot e Garancisë Rinore në tre bashki u zgjat deri në vitin 2027. Punësimi informal mbetet një problem, me shumë punëtorë që nuk kanë kontrata formale, sigurime shoqërore dhe mbrojtje ligjore, ndërsa nën-raportimi i pagave është i përhapur, duke gërryer pensionet. Emigrimi, veçanërisht i punëtorëve të kualifikuar, përkeqëson mungesat e fuqisë punëtore në sektorët kyç, duke kontribuar në një ikje të trurit. Politikat e pamjaftueshme aktive të tregut të punës pengojnë

përshtatshmërinë e fuqisë punëtore dhe kufizojnë mundësitë për punësim me cilësi më të lartë. Mbulimi i sistemit të ndihmës sociale të Shqipërisë mbetet i pamjaftueshëm. Bashkëpunimi trepalësh midis Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Sociale, sindikatave dhe organizatave të punëdhënësve mbetet i dobët. Shqipëria miratoi në qershor 2025 një dokument politikash mbi plakjen dhe një plan veprimi për vitet 2025-2030.

2.3.2. Kapaciteti për t'u përballur me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda BE-së.

Arsimi dhe inovacioni

Sistemi arsimor përballlet me sfida, të cilat pengojnë ndërtimin e një fuqie punëtore të kualifikuar dhe konkurruese. Shqipëria vazhdoi të zbatojë Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, e cila synon të përmirësojë cilësinë e arsimit dhe aksesin dhe përshtatjen në tregun e punës. Megjithatë, sistemi arsimor përballlet me arritje të ulëta arsimore dhe shkallë të lartë braktisjeje të shkollës, veçanërisht në zonat rurale dhe midis komuniteteve të marginalizuara. Shkalla e të rinjve jashtë arsimit, punësimit ose trajnimit (NEET) në Shqipëri për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është afërsisht 24% në vitin 2023, dukshëm më e lartë se mesatarja e BE-së. Cilësia e arsimit shpesh pengohet nga kurrikula të vjetruara, trajnimi i pamjaftueshëm i mësuesve dhe infrastruktura e vjetruar. Për më tepër, ka qasje të kufizuara në arsimin e hershëm të fëmijëve. Sistemi arsimor gjithashtu lufton me përfshirjen, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe për ata fëmijë që vijnë nga mjedise të pafavorizuara. Mungesa e arsimit dhe trajnimit profesional efektiv (AFP) pengon përshtatshmërinë e fuqisë punëtore dhe kufizon mundësitë për punësim me cilësi më të lartë. Megjithatë, u bënë përpjekje për të adresuar disa dobësi, nëpërmjet përditësimit të kurrikulave, përfshirjes së programeve të trajnimit dhe pilotimit të një programi praktik (mësim i bazuar në punë) (Shih Kapitullin 26 - Arsimi).

Shpenzimet publike për kërkimin dhe zhvillimin (R&D) janë të kufizuara. Shqipëria synon të shpenzojë 1% të PBB-së për R&D në vitin 2030, por aktualisht shifrat janë shumë më poshtë objektivit zyrtar. Në dhjetor 2024, Shqipëria miratoi Strategjinë për Sipërmarrjen Inovative. Përveç rritjes së shpenzimeve publike për R&D, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të nxitur bizneset që të rrisin shpenzimet e tyre për R&D dhe për të inkurajuar bashkëpunimin midis sektorit privat dhe universiteteve.

Kapitali fizik dhe cilësia e infrastrukturës

Zhvillimi i infrastrukturës së transportit po përparon. Shqipëria vazhdoi investimet e saj publike në infrastrukturë, kryesisht rrugë, por edhe hekurudha. Është bërë përparim në autostradat kryesore si Autostrada Adriatiko-Joniane dhe Korridori VIII, të cilat janë pjesë e rrjetit trans-evropian të transportit (TEN-T). Ndërtimi i hekurudhës Tiranë-Durrës dhe lidhja hekurudhore me aeroportin është në vazhdim (rreth 80% e përfunduar), ndërsa ndërtimi i aeroportit të ri në Vlorë përmes një kontrate koncesionare është në fazën e tij përfundimtare. Sipas autoriteteve, të gjitha projektet e infrastrukturës së transportit që janë pjesë e TEN-T për të gjitha mënyrat e transportit janë përfshirë në NSPP-në e Shqipërisë. Ndërsa projektet e infrastrukturës po përparojnë, mbeten boshllëqe dhe çështja e përsëritur e nën-ekzekutimit të investimeve publike po ngadalëson ndërtimin e stokut të kapitalit.

Investimet në infrastrukturën digjitale përparuan në vitin 2024. Shqipëria përfundoi procesin e autorizimit për shërbimet 5G, duke u dhënë licenca dy operatorëve celularë. Numri i abonentëve të internetit me brez të gjerë u rrit me 10% krahasuar me vitin 2023, dhe shkalla e depërtimit të internetit me brez të gjerë celular u rrit me 15.4%. Disa operatorë thuhet se përmirësuan rrjetet e tyre për të ofruar shërbime më të shpejta interneti, kryesisht përmes


infrastrukturës së përparuar me fibra optike të aftë për të mbështetur transmetimin e të dhënave me shpejtësi të lartë dhe shumë të lartë.

Janë ndërmarrë hapa për të përmirësuar efikasitetin e energjisë. Në qershor 2025, Parlamenti miratoi një Ligj për performancën energjetike të ndërtesave. Shqipëria miratoi gjithashtu një strategji afatgjatë rinovimi që përqendrohet në përmirësimin e efikasitetit të energjisë në ndërtesa dhe dekarbonizimin e sektorit të energjisë, duke përfshirë edhe masat për të ulur emetimet e gazrave serrë, për të integruar energjinë e rinovueshme dhe për të përmirësuar sigurinë energjetike (shih Kapitullin 15 - *Energjia*).

Struktura sektoriale dhe e ndërmarrjeve

Struktura e ekonomisë mbetet e ngjashme me vitin e kaluar. Sondazhi strukturor i ndërmarrjeve tregon se, në vitin 2023, ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dominuan ekonominë e Shqipërisë, duke përbërë 99.9% të të gjitha ndërmarrjeve. Këto biznese punësuan 82.5% të fuqisë punëtore totale dhe kontribuan 78.2% të vlerës totale të shtuar nga sektorët jo-bujqësorë. Sipas të dhënave të vitit 2023 mbi tregtinë e mallrave sipas karakteristikave të ndërmarrjeve, NVM-të përbënin 65% të eksporteve totale të mallrave, duke shënuar një rënie prej 8.9% krahasuar me vitin 2022. Numri i kompanive të huaja të regjistruara rishtazi (me 100% pronësi të huaj) arriti në 1 423 në vitin 2024, duke reflektuar një rritje prej 11% krahasuar me vitin e kaluar.

Integrimi ekonomik me BE-në dhe konkurrueshmëria e çmimeve



BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar dhe i investimeve të Shqipërisë. Hapja tregtare (shuma e totalit të eksporteve dhe importeve si pjesë e PBB-së) ra nga 82.4% në vitin 2023 në 79.5% të PBB-së në vitin 2024, ndërsa eksportet e mallrave ranë. BE-ja mbeti partneri kryesor tregtar i Shqipërisë. Në vitin 2024, BE-ja përbënte 57.4% të tregtisë së mallrave të Shqipërisë, duke thithur 71.7% të eksporteve të mallrave të Shqipërisë dhe duke siguruar 51.5% të importeve të mallrave të saj. Italia (43.7%), Kosova (9.9%), Greqia (6.3%) dhe Gjermania (5.9%) ishin destinacionet kryesore të eksportit. Partnerët kryesorë të importit të vendit ishin Italia (21.1%), Kina (10.9%), Turqia (10.8%) dhe Greqia (7.6%). BE-ja mbetet gjithashtu burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve, ndërsa pjesa e BE-së në stokun e IHD-ve ishte 54.1% (nga 54.4% në vitin 2023). Konkurrueshmëria e çmimeve të Shqipërisë u përkeqësua, siç reflektohet në mbiçmimin e kursit real efektiv të këmbimit, rritjen e pagave nominale dhe uljen e eksporteve të mallrave. Eksportet e prodhimit janë të ndjeshme ndaj mbiçmimit të kursit të këmbimit, për shkak të vlerës së tyre të ulët të shtuar dhe fuqisë së ulët të çmimeve të bizneseve. Ato mbivlerësohen nga eksportet e shërbimeve (në veçanti shërbimet e udhëtimit, të cilat u

dyfishuan në vlerë midis viteve 2019 dhe 2024), të cilat ofrojnë rreth 80% të totalit të eksporteve të Shqipërisë. Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) përbënin 69% të totalit të eksporteve të mallrave, duke shënuar një rënie prej 10.3% krahasuar me vitin 2023.

2.4. PROKURIMI PUBLIK, STATISTIKAT, KONTROLLI FINANCIAR

Kapitulli 5: Prokurimi publik

Rregullat e BE-së sigurojnë që prokurimi publik i mallrave, shërbimeve dhe punëve në çdo Shtet Anëtar të jetë transparent dhe i hapur për të gjitha kompanitë e BE-së në bazë të parimit të mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Kuadri ligjor për prokurimin publik është kryesisht në përputhje me Direktivën e BE-së të vitit 2014 për prokurimin publik dhe prokurimin e shërbimeve. Një numër aktesh nënligjore u miratuan në shtator 2024 për të zbatuar Ligjin e ndryshuar për prokurimin publik (LPP).

Dispozita kalimtare në LPP-në e ri që autorizon institucionet e qeverisë qendrore të negociojnë dhe të lidhin marrëveshje konsulence ndërkombëtare në "fushat me interes strategjik", duke i përjashtuar ato kështu nga hapja e konkurrencës, vazhdon të ngrejë shqetësime në lidhje me përputhshmërinë e saj me *acquis* të BE-së dhe me Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit.

Ligji për koncesionet dhe partneritetin publik-privat (PPP) është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. Puna për një rishikim thelbësor të ligjit të PPP-së me qëllim përafrimin e tij me *acquis* të BE-së nuk është përfunduar ende.

Kapaciteti i zbatimit dhe performanca

Tregu i prokurimit publik në Shqipëri përfaqësonte 16.5% të PBB-së në vitin 2024 (krahasuar me 6.7% të PBB-së në vitin 2023). Përdorimi i procedurave të negociuara pa shpallje paraprake u zvogëluar në vitin 2024, si në numër procedurash (2.3% e të gjitha procedurave nga 2.9% në vitin 2023) ashtu edhe në vlerë përkatëse (0.4% e vlerës totale nga 2% në vitin 2023). Pati një rritje të konsiderueshme të marrëveshjeve të reja kuadër; si në numër (1 601 në vitin 2024, nga 767 në vitin 2023) ashtu edhe në aspektin e vlerës. Kjo i atribuohet pjesërisht fillimit të funksionimit të Operatorit Qendror të Blerjeve të sapokrijuar. Zbatimi i kriterit për tendera ekonomikisht më të favorshëm (MEAT) për dhënien e kontratave të prokurimit publik u rrit në vitin 2024, si në aspektin e tenderave të dhënë në të cilët u përdor (4.8% në vitin 2024 krahasuar me 3.6% në vitin 2023), ashtu edhe veçanërisht në aspektin e vlerës së kontratave të lidhura (41% në vitin 2024 krahasuar me 20.3% në vitin 2023).

APP-ja ka publikuar udhëzime të reja mbi përdorimin e MEAT në shtator 2024 dhe ka rritur trajnimet përkatëse.

Përdorimi i PPP-ve dhe i koncesioneve të reja vijon të jetë në nivele shumë të ulëta: gjatë vitit 2024 u iniciua vetëm një procedurë dhe asnjë kontratë nuk u lidh.

Autoritetet kontraktore duhet të vazhdojnë të rrisin kapacitetet për të menaxhuar proceset e prokurimit publik. Ka filluar puna për përgatitjen e specifikimeve teknike për përmirësimin e sistemit elektronik të prokurimit. Trajnimi i vazhdueshëm vazhdoi me 3 139 pjesëmarrës (247

në 2023) të regjistruar nga 443 (98 në 2023) institucione qendrore, lokale dhe të pavarura dhe subjekte private në vitin 2024.

Lidhur me parandalimin e korrupsionit në prokurimin publik, Shqipëria duhet të përqendrohet në forcimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit të përgjithshëm për të rritur konkurrencën, pajtueshmërinë dhe profesionalizimin.

Sistemi efikas i mjeteve juridike

Kushtetuta dhe LPP përmbajnë dispozita mbi të drejtën për mjetet juridike që janë kryesisht në përputhje me direktivat e BE mbi mjetet juridike. Kapaciteti i Komisionit Shtetëror të Ankesave (KSHA) duhet të forcohet më tej duke pasur parasysh numrin e konsiderueshëm të ankesave që merr (1 151 në 2024, 1 019 në 2023). Në vitin 2024, Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) mori 1050 vendime, 42 prej të cilave u kundërshtuan në gjykatë.

Kapitulli 18: Statistikat

Statistikat evropiane zhvillohen, prodhohen dhe shpërndahen nga Shtetet Anëtare të BE-së, të bazuara mbi parimet dhe kriteret e cilësisë të përcaktuara në Rregulloren mbi statistikën evropiane, të tilla si pavarësia profesionale, paanshmëria, besueshmëria, aksesueshmëria dhe konfidencialiteti statistikor. Janë parashikuar rregulla të përbashkëta për metodologjinë, prodhimin dhe shpërndarjen e informacionit statistikor, të cilat specifikohen më tej në legjislacionin sektorial që përbën *acquis* të BE-së mbi statistikën.

Lidhur me **infrastrukturën statistikore**, kuadri ligjor i Shqipërisë është në përputhje me standardet evropiane dhe respekton parimet e Kodit të Praktikës së Statistikave Evropiane, dhe shumica e klasifikimeve janë në përputhje me standardet e BE-së. Pozicionet e personelit janë rritur në 260 (+24) dhe rekrutimi është duke vazhduar, por INSTAT vazhdon të përballë me kufizime në kapacitete dhe fluktuacion të stafit. INSTAT duhet të vazhdojë të investojë në infrastrukturën e IT-së, veçanërisht në lidhje me sigurinë kibernetike.

Për **statistikat makroekonomike**, Shqipëria finalizoi rishikimin bazë të llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore që nga viti 1995, si dhe rishikoi statistikën e financave të qeverisë (GFS) për serinë kohore 2010-2023. Kërkohej progres i mëtejshëm për të hartuar dhe transmetuar të dhëna plotësisht në përputhje me ESA 2010. Nevojiten përpjekje të veçanta për të hartuar dhe transmetuar të dhëna për procedurën e tepicës së deficitit (EDP) dhe GFS në përputhje me ESA 2010 dhe për të adresuar anomalitë e konstatuara mbi të dhënat e raportuara. Përveç kësaj, etiketimi i të dhënave GFS të dërguara në Eurostat si “jo të publikueshme” vazhdon të ngrejë shqetësime të forta lidhur me transparencën. Mungesë të dhënash vazhdojnë të ekzistojnë në fushat e statistikave mbi kërkimin dhe zhvillimin (R&D), tregtinë ndërkombëtare të mallrave, investimet e huaja direkte dhe pozitën ndërkombëtare të investimeve.

Për **statistikat e biznesit**, statistikën afatshkurtra prodhohen, por disa grupe të dhënash ende nuk transmetohen në Eurostat.

Për **statistikat sociale**, rezultatet përfundimtare të regjistrimit të popullsisë në nivele të ndryshme të territorit u publikuan në vitin 2024. Analiza tematike e të dhënave të regjistrimit duhet të vazhdojë. Metodologjia e Anketës së Fuqisë Punëtore të BE-së 2021 duhet të zbatohet

dhe transmetimi i rregullt i të dhënave në Eurostat të rivendoset. Statistikat e krimit publikohen çdo vit.

Statistikat bujqësore janë pjesërisht të përafruara me *acquis* të BE-së.

Regjistrimi bujqësor është shtyrë për në vitin 2026 dhe puna duhet të vazhdojë për përditësimin e planit të punës dhe buxhetit, sigurimin e miratimit të ligjit për regjistrimin bujqësor, finalizimin e pyetësorit, si dhe garantimin e organizimit të logjistikës së regjistrimit.

Statistikat mjedisore janë pjesërisht të përafruara me *acquis* të BE-së. Me gjithë disa përmirësime në këtë fushë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmbushur kërkesat e *acquis*. Shqipëria duhet të nisë hartimin e Llogarive të Sektorit të Mallrave dhe Shërbimeve Mjedisore si dhe të Llogarive të Shpenzimeve për Mbrojtjen e Mjedisit. Statistikat e energjisë janë pjesërisht të përafruara, dhe kërkohet punë e mëtejshme për të arritur përafrimin e plotë me *acquis* të BE-së. Duhet të bëhen përpjekje të konsiderueshme për statistikën e transportit, përfshirë organizimin e anketës së plotë për transportin rrugor të mallrave në vitin 2026.

Kapitulli 32: Kontrolli financiar

Bashkimi Evropian promovon reformën e sistemeve kombëtare të qeverisjes për të përmirësuar përgjegjshmërinë menaxheriale, menaxhimin e kujdesshëm financiar të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe auditimin e jashtëm të fondeve publike. Rregullat e kontrollit financiar mbrojnë më tej interesat financiare të BE-së kundër mashtrimeve në menaxhimin e fondeve të BE-së dhe euron kundër falsifikimit

Kontrolli i brendshëm financiar publik (PIFC)

Një **kuadër strategjik** specifik për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik (KBFP) është në fuqi. Raportet KBFP vazhduan të përgatiten çdo vit. Sistemi i **kontrollit të brendshëm** mbetet pjesërisht efektiv dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të avancuar zbatimin e reformave të KBFP. Menaxhimi i rreziqeve mbetet në një fazë të hershme.

Përgjegjshmëria menaxheriale është e përfshirë në legjislacion. Megjithatë, numri i vendimeve administrative të deleguara në nivele më të ulëta mbetet shumë i kufizuar në praktikë.

Kuadri ligjor mbi **auditimin e brendshëm** është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Zbatimi i sistemit të ri për certifikimin e avancuar të auditorëve ka vazhduar. Në vitin 2024, **Njësia Qendrore e Harmonizimit** vlerësoi përputhshmërinë e aktiviteteve të auditimit të brendshëm të 20 njësive të auditimit të brendshëm me manualët dhe udhëzimet përkatëse. Ajo konstatoi se 37% e tyre ishin pjesërisht ose plotësisht në përputhje, ngjashëm me vitin 2023.

Auditimi i jashtëm

Kuadri ligjor i Shqipërisë garanton pavarësinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH). **Kapaciteti institucional** i këtij institucioni ishte 216 punonjës nga 243 të parashikuar, pothuajse i njëjtë me vitin 2023. **Cilësia e punës së auditimit** vazhdoi të jetë në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). **Ndikimi i punës së auditimit** ka shënuar përparim: 99% e rekomandimeve të dhëna në auditimet e vitit 2024 u pranuan, nga të cilat 47% u zbatuan plotësisht ose pjesërisht. Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e rekomandimeve të auditimit të jashtëm.

Nënkomisioni parlamentar për auditimin ka zhvilluar disa seanca dëgjimore gjatë periudhës së raportimit dhe ka miratuar rezoluta në lidhje me një sërë auditimesh të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH), çka përbën një prirje pozitive.

Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

Shqipëria ka një nivel të caktuar **përafrimi me *acquis* të BE-së** në këtë fushë. Megjithatë, mbetet i nevojshëm harmonizimi i plotë i legjislacionit kombëtar me Direktivën e BE-së për luftën kundër mashtrimit që prek interesat financiare të BE-së përmes së drejtës penale.

Një **Strategji Kombëtare Kundër Mashtrimit** u miratua në maj 2025. **Rrjeti kombëtar i shërbimit të koordinimit kundër mashtrimit (AFCOS)** është mbledhur rregullisht. Megjithatë, mbetet i nevojshëm qartësimi i rolit të autoriteteve të rrjetit AFCOS në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Shqipëria duhet të bëjë përpjekje të mëtejshme për të zhvilluar një historik të qëndrueshëm bashkëpunimi me Komisionin Evropian në hetime dhe raportimin e parregullsive, si edhe për të siguruar ndihmë operative efektive për Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Në vitin 2024, Shqipëria raportoi 60 raste parregullsish përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive.

Mbrojtja e euros nga falsifikimi

Nuk u raportuan zhvillime lidhur me **përafrimin me *acquis* të BE-së** mbi përcaktimin e kartëmonedhave dhe monedhave të falsifikuara, si dhe për procedurat e mbledhjes, ruajtjes dhe tërheqjes së tyre nga qarkullimi.

Në vitin 2024, Shqipëria tërhoqi nga qarkullimi 573 monedha euro dhe 214 kartëmonedha euro, që përfaqësojnë 82% të të gjitha valutave të falsifikuara të sekuestruara.

3. Marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal

Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal përbëjnë një pjesë thelbësore të procesit të integritetit evropian të Shqipërisë. Ato kontribuojnë në stabilitetin, pajtimin dhe krijimin e një klime të përshtatshme për adresimin e çështjeve dypalëshe të hapura dhe të trashëgimisë së kaluarës.

Shqipëria vazhdoi të angazhohet në mënyrë aktive në një sërë **nismash rajonale** të bashkëpunimit, si Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), Komuniteti i Energjisë, Komuniteti i Transportit, Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECP) dhe Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Shqipëria mbajti presidencën e radhës të SEECP për periudhën 2024-2025, e cila u përmbyll me një Samit në Tiranë më 16 qershor 2025. Doganat shqiptare kryesuan nënkomitetin e CEFTA-s për doganat dhe rregullat dhe organizuan në qershor, në Tiranë, Konferencën e Dytë të Nivelit të Lartë të Drejtorëve të Përgjithshëm të Doganave të Ballkanit Perëndimor dhe Shteteve Anëtare të BE-së, duke riafirmuar angazhimin për Integrim Ekonomik më të Thellë dhe Bashkëpunim Doganor.

Shqipëria është angazhuar në mënyrë aktive edhe në dimensionin rajonal të **Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**, duke marrë pjesë në takimet ministrore dhe ato të nivelit të lartë, si dhe duke pritur në Tiranë takimin e liderëve në shkurt 2025. Mikpritja e Samitit të Komunitetit Politik Evropian më 16 maj 2025 përbën një tjetër dëshmi të qartë të angazhimit të Shqipërisë ndaj bashkëpunimit rajonal.

Në **Samitin e Procesit të Berlinit** të mbajtur në Londër në tetor 2025, liderët e rajonit miratuan një plan veprimi të rishikuar dhe të përmirësuar për zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, miratuan një Hartë Rrugore për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike në Ballkanin Perëndimor dhe u angazhuan për të bërë përparim në nxitjen e lëvizshmërisë rajonale dhe zbatimin e marrëveshjeve rajonale përkatëse dhe vendimeve të CEFTA-s.

Shqipëria nënshkroi marrëveshjen e pestë për lëvizshmëri, që ka të bëjë me aksesin në arsimin e lartë dhe pranimin në studime në Ballkanin Perëndimor, si dhe miratoi **planin e veprimit** të CRM për periudhën 2025-2028. Shqipëria ka ratifikuar të pesë marrëveshjet rajonale për lëvizshmëri. Udhërrefyesi midis Ballkanit Perëndimor dhe BE-së hyri në fazën e parë të zbatimit. Në tetor 2024, Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s miratoi dymbëdhjetë vendime të rëndësishme, pas një marrëveshjeje mes anëtarëve të CEFTA-s që mundësoi zgjidhjen e bllokimit në procesin vendimmarrës të organizatës. U mor gjithashtu një vendim për emërimin e një drejtori të CEFTA-s, pas dy vjetësh e gjysmë vakance në këtë post. Mungesa e drejtuesit pati një ndikim negativ të ndjeshëm në punën e CEFTA-s, dhe për një periudhë të shkurtër Komisioni Evropian pezulloi mbështetjen e tij.

Shqipëria në përgjithësi ruan **marrëdhënie të mira dypalëshe** me vendete tjera të zgjerimit dhe shtetet anëtare fqinje të BE-së.

Marrëdhëniet me **Bosnjë dhe Hercegovinën** u përmirësuan pasi Shqipëria hapi një ambasadë në Sarajevë në maj 2025, ndërsa përfaqësuesit e të dy vendeve vazhdojnë vizitat e nivelit të lartë.

Marrëdhëniet me **Kosovën** mbetën të mira. Në dhjetor 2024, parlamentet e Shqipërisë dhe Kosovës zhvilluan një seancë të përbashkët plenare në Prishtinë, me pjesëmarrjen e të dy kryeministrave. Të dy parlamentet miratuan një deklaratë të përbashkët, në të cilën angazhohen, ndër të tjera, të harmonizojnë agjendat kombëtare me objektivat e anëtarësimit të Shqipërisë në BE dhe kërkojnë angazhim serioz për përparimin e dialogut Kosovë-Serbi, në bashkëpunim të ngushtë me BE-në dhe SHBA-të.

Në mars 2025, Shqipëria nënshkroi një deklaratë të përbashkët për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes me Kosovën dhe Kroacinë.

Marrëdhëniet me **Malin e Zi** mbetën të mira, me kontakte të vazhdueshme politike dhe të nivelit të lartë.

Marrëdhëniet me **Maqedoninë e Veriut** mbetën të mira. Ekzistojnë disa marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim në fusha të ndryshme, duke përfshirë sigurinë, mbrojtjen, infrastrukturën, energjinë, arsimin, shkencën dhe kulturën.

Marrëdhëniet me **Serbinë** mbetën përgjithësisht të mira, me kontakte të rregullta politike në nivel të lartë.

Marrëdhëniet me **Turqinë** u forcuan më tej, me vizitën e Presidentit të Turqisë në Shqipëri në tetor 2024. Gjatë kësaj vizite, u nënshkrua një deklaratë e përbashkët për thellimin e partneritetit strategjik. Turqia ofroi mbështetje të rregullt për modernizimin e forcave të armatosura shqiptare, përfshirë dhurime të dronëve ushtarakë. Në korrik 2025, Shqipëria dhe Turqia nënshkruan një protokoll të ri për bashkëpunim në fushën e mbrojtjes, duke forcuar kuadrin ekzistues të bashkëpunimit.

Turqia vazhdoi të ushtrojë presion ndaj Shqipërisë për shkatërrimin e strukturave të lëvizjes “Gylen” në vend. Gjatë vizitës së tij në Shqipëri, Presidenti turk inauguroi xhaminë “Namazgah” në qendër të Tiranës, e cila tashmë është xhamia më e madhe në rajonin e Ballkanit. Një delegacion i Komisionit për Punët e Jashtme të Kuvendit të Madh Kombëtar të Turqisë vizitoi Shqipërinë.

Marrëdhëniet me **Gjeorgjinë** mbetën të mira, me bashkëpunim aktiv në forumet ndërkombëtare. Shqipëria mbështet integritetin territorial dhe sovranitetin e Gjeorgjisë.

Marrëdhëniet me **Republikën e Moldavisë** mbetën të mira. Në maj 2025, Shqipëria dhe Moldavia nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për forcimin e bashkëpunimit në procesin e anëtarësimit në BE.

Marrëdhëniet me **Ukrainën** u intensifikuan më tej gjatë periudhës raportuese, me hapjen e Ambasadës së Shqipërisë në Kiev në fund të vitit 2024. Në shtator 2024, Shqipëria nënshkroi Deklaratën e Përbashkët të Mbështetjes për Rimëkëmbjen dhe Rindërtimin e Ukrainës së bashku me 30 vende të tjera. Një marrëveshje dypalëshe mbi bashkëpunimin në siguri dhe mbështetjen afatgjatë u nënshkrua në janar 2025. Shqipëria mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm Ukrainë-Evropë Juglindore që u zhvillua në Kiev në janar 2025 dhe në Samitin Ukrainë-Evropë Juglindore që u zhvillua në Odesa në qershor 2025. Zëvendëskryeministri i Ukrainës për Integrimin Evropian dhe Euro-Atlantik i Ukrainës, i cili shërben gjithashtu si Ministër i Drejtësisë dhe Kryenegociator, vizitoi Tiranën në korrik 2025. Në janar 2025, Shqipëria dhe Ukraina nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi për të forcuar bashkëpunimin në proceset e tyre të pranimit në BE.

Marrëdhëniet me **Greqinë** mbetën të mira në përgjithësi dhe kontaktet politike vazhduan.

Marrëdhëniet me **Italinë** mbetën shumë të mira, siç reflektohet edhe në shkëmbimin e vizitave të nivelit të lartë. Në shtator 2024, të dy vendet nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi dypalësh midis agjencive përkatëse kombëtare të sigurisë kibernetike. Gjatë periudhës së raportimit, vazhdoi zbatimi i protokollit mbi bashkëpunimin për migracionin midis Italisë dhe Shqipërisë të nëntorit 2023. U kryen katër operacione për transferimin e migrantëve në qendrat italiane në Shqipëri. Këto u kundërshtuan ligjërisht nga autoritetet gjyqësore kompetente italiane.

4. AFTËSIA PËR TË MARRË PËRSIPËR DETYRIMET E ANËTARËSIMIT

GRUPKAPITULLI 2: TREGU I BRENDSHËM

Ky grupkapitull mbulon: lëvizjen e lirë të mallrave (Kapitulli 1); lirinë e lëvizjes së punëtorëve (Kapitulli 2); të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime (Kapitulli 3); lëvizjen e lirë të kapitalit (Kapitulli 4); të drejtën e shoqërive tregtare (Kapitulli 6); të drejtën e pronësisë intelektuale (Kapitulli 7); politikën e konkurrencës (Kapitulli 8); shërbimet financiare (Kapitulli 9) dhe mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit (Kapitulli 28). Ky grup është çelësi për përgatitjet e Shqipërisë për kërkesat e tregut të brendshëm të BE-së dhe është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e Tregut të Përbashkët Rajonal.

Kapitulli 1: Lëvizja e lirë e mallrave

Lëvizja e lirë e mallrave siguron që shumë produkte të mund të tregtohen lirisht përgjatë BE-së në bazë të rregullave dhe procedurave të përbashkëta. Në rastet kur produktet rregullohen nga rregulla kombëtare, parimi i lëvizjes së lirë të mallrave i pengon këto rregulla duke krijuar pengesa të pajustifikueshme në tregti.

Parimet e përgjithshme

Shqipëria ka një Plan Veprimi kombëtar për përafrimin e *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, të ndarë në dy faza, Plan Veprimi për përafrimin ligjor dhe ndërtimin e kapaciteteve zbatuese në afat të mesëm (2023-2025) dhe afatgjatë (2026-2030), por ndërkohë duhet të duhet të intensifikojë përpjekjet për përafrimin e legjislacionit kombëtar shqiptar me *acquis* e BE-së në këtë kapitull.

Fusha e pabarmonizuar

Shqipëria ka zgjeruar fushëveprimin e punës së saj dhe po vijon punën për hartimin e një Plani Veprimi për shqyrtimin e rregulloreve kombëtare teknike për përputhshmërinë me **nenet 34-36 të Traktatit të Funksionimit të Bashkimit Evropian (TFBE)** në fushën e pabarmonizuar.

Fusha e harmonizuar: infrastruktura e cilësisë

Në janar 2025, në ministrinë përgjegjëse (Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI) për këtë kapitull, është rekrutuar staf shtesë në kuadër të forcimit të kapaciteteve. Lidhur me fushën e **mbikëqyrjes së tregut**, Shqipëria duhet të vijojë me masat për forcimin e kapaciteteve zbatuese të mbikëqyrjes së tregut. Ndërkohë, nga shtatori 2024 deri në korrik 2025, janë kryer 1 295 inspektime të mbikëqyrjes së tregut, duke rezultuar në 26 paralajmërime, 15 gjoba dhe një masë emergjente.

Për sa i përket legjislacionit kombëtar shqiptar lidhur me fushën e **akreditimit, mbikëqyrjes së tregut dhe vlerësimin e konformitetit** mbetet pjesërisht i përafruar me *acquis* të BE-së. Ndërkohë, Shqipëria ka një nivel të lartë përafrimi të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së në fushën e **standardizimit**. Gjithashtu, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit e Shqipërisë ka vijuar të adresojë çështjet e identifikuar nga *peer review* i Komitetit Evropian

për Standardizim (CEN) dhe Komitetit Evropian për Standardizim Elektroteknik (CENELEC) pas aplikimit të saj për t'u bërë anëtare e plotë e CEN/CENELEC. Për sa i përket fushës së standartizimit, Shqipëria ka miratuar standardet kombëtare në përputhje me standardet e BE-së. Në fushën e **akreditimit**, në Shqipëri janë akredituar 115 organe vlerësimi të konformitetit nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), krahasuar me 118 akredituar në vitin 2024, duke përfshirë 56 laboratorë testimi, një laborator kalibrimi dhe 24 organe inspektimi.

Ndërkohë, në fushën e metrologjisë, Drejtoria e Përgjithshme e **Metrologjisë** është aktualisht e pajisur me staf të plotë dhe operon në mënyrë funksionale. Megjithatë, Shqipëria ende nuk nisur punën për përafrimin me *acquis* së BE lidhur me **procedurat e notifikimit në legjislacionit kombëtar**.

Fusha e harmonizuar: legjislacioni sektorial

Në lidhje me **legjislacionin e produkteve me 'qasje të re dhe globale'**, nuk ka patur zhvillime lidhur me përafrimin e legjislacionit kombëtar shqiptar me *acquis* të BE-së.

Ndërkohë, lidhur me legjislacionin e produkteve me 'qasje të vjetër', nuk ka patur zhvillime lidhur me përafrimin e legjislacionit kombëtar shqiptar me *acquis* të BE-së, duke përfshirë regjistrimin, vlerësimin, autorizimin dhe kufizimin e kimikateve (REACH); klasifikimin, etiketimin dhe paketimin kimik, mbi automjetet, mbi shpërndarësit e aerosoleve dhe mbi detergjentët. Gjithashtu, legjislacioni kombëtar shqiptar mbetet pjesërisht i përafruar mbi prekursorët e drogës, megjithëse lista e substancave të kontrolluara tashmë është në përputhje me listat përkatëse të *acquis* të BE-së për prekursorët e drogës.

Lidhur me **masat procedurale**, Shqipëria ende nuk ka nisur procesin e përafrimit të legjislacionit kombëtar shqiptar me *acquis* të BE-së, duke përfshirë kthimin e **objekteve kulturore të nxjerra në mënyrë të paligjshme nga territori i një shteti anëtar të BE-së**.

Shqipëria zbaton masa antikorrupsion në fuqi mbi transparencën, akreditimin, vlerësimin e konformitetit, tarifat, aktet ligjore dhe aktivitetet e organeve publike. Gjithashtu, disa organe dhe struktura të administratës doganore që kryejnë mbikëqyrjen e tregut, kanë kuadër rregullator për parandalimin e korrupsionit mbi transparencën, etikën dhe konfliktet e interesit, si dhe janë subjekt i auditimit dhe i nënshtrohen procesit të auditimit. Megjithatë, nevojiten më shumë përpjekje në aspektin e zbatimit të kuadrit rregullator dhe masave antikorrupsion në fuqi.

Kapitulli 2: Liria e lëvizjes së punëtorëve

Shtetasit e një Shteti Anëtar kanë të drejtë të punojnë në një Shtet tjetër Anëtar të BE-së dhe duhet t'u ofrohen të njëjtat kushte pune dhe sociale si punëtorët e tjerë.

Në lidhje me **aksesin në tregun e punës**, në periudhën janar - dhjetor 2024, 1 314 qytetarë të BE-së kanë përfituar nga procedura e thjeshtuar për aksesimin në tregun e punës në Shqipëri. Aktualisht, punësimi në pozicione të shërbimit civil dhe në policinë e shtetit kërkon shtetësinë shqiptare.

Shqipëria tashmë ka një strategji kombëtare për migracionin për vitet 2024-2030 në fuqi, e shoqëruar nga një plan veprimi 2024-2026 për zbatimin e saj. Në vitin 2024, Shqipëria ka lëshuar gjithsej 11 224 leje pune, 1 314 prej të cilave janë pëfituar nga qytetarë të BE-së. Në kushtet e përgatitjes për t'u bashkuar me **rrjetin evropian të shërbimeve të punësimit** (EURES), Shqipëria ka ndërtuar një bazë të dhënash të integruar për shërbimet e saj të punësimit që, pas lidhjes së saj me EURES, mund të lehtësojë shkëmbimin e informacionit midis departamenteve të IT-së mbi gjendjen civile, sistemin tatimor, sistemin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe sistemin e ndihmës ekonomike. Ndërkohë, Lista Kombëtare e Profesioneve është përafuar me klasifikimin shumëgjuhësh të Aftësive, Kompetencave, Kualifikimeve dhe Profesioneve Evropiane (ESCO), duke lejuar transferimin e bazës së të dhënave dhe lidhjen me EURES, si dhe klasifikimi ESCO është zbatuar në sistemet IT të shërbimit të punësimit në Shqipëri. Për më tepër, ndërlidhja e hershme me EURES do ta ndihmonte Shqipërinë të ndërtonte infrastrukturën dhe ekspertizën e nevojshme për të mbështetur lëvizshmërinë e fuqisë punëtore.

Lidhur me **koordinimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore**, Shqipëria ka lidhur marrëveshje për koordinimin e sigurimeve shoqërore me 9 shtete anëtare të BE-së (Belgjikë, Luksemburg, Hungari, Republikën Çeke, Gjermani, Austri, Bullgari, Kroaci dhe Rumani) dhe 3 partnerë të zgjerimit: Maqedoninë e Veriut, Kosovën dhe Turqinë. Marrëveshje të reja janë nënshkruar nga Shqipëria përgjatë periudhës së raportimit. Specifikisht marrëveshja e sigurimeve shoqërore me Italinë (hyrë në fuqi që nga qershori 2025) dhe marrëveshja e sigurimeve shoqërore me Malin e Zi (hyrë në fuqi që nga korriku 2025).

Ndërkohë, marrëveshjet dypalëshe me Bullgarinë, Kroacinë dhe Malin e Zi të ratifikuara nga Shqipëria në periudhën e mëparshme të raportimit, nuk kanë hyrë ende në fuqi. Marrëveshjet me Serbinë dhe Poloninë janë finalizuar dhe janë gati për nënshkrim dhe ratifikim në Parlament.

Shqipëria ende nuk ka një sistem të unifikuar për shkëmbimin e të dhënave dhe nuk është bërë asnjë përparim në lidhje me krijimin e një sistemi elektronik për shkëmbimin e të dhënave me vendet e Bashkimit Evropian. Lidhur procesin e digjitalizimit Sqipëria ka përparuar për pjesëmarrjen e ardhshme në systemin e Shkëmbimit Elektronik të Informacionit të Sigurimeve Shoqërore. Megjithatë, ende nuk është bërë përparim lidhur me **Kartën Evropiane të Sigurimeve Shëndetësore** gjatë periudhës raportuese.

Kapitulli 3: E drejta e vendosjes dhe liria për të ofruar shërbime

Personat fizikë dhe juridikë të BE-së kanë të drejtën të vendosen sit ë tillë në çdo Shtet Anëtar për të ofruar shërbime ndërkufitare. Për profesione të caktuara të rregulluara, ekzistojnë rregulla për njohjen reciproke të kualifikimeve. Rregullat e BE-së për shërbimet postare përqendrohen në përmirësimin e cilësisë së shërbimit universal, liberalizimin gradual të tregut ndaj konkurrencës dhe krijimin e një kuadri rregullator të pavarur.

Lidhur me **të drejtën e vendosjes dhe lirinë për të ofruar shërbime ndërkufitare**, Shqipëria ka krijuar Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila funksionon si një qendër e vetme për regjistrimin e bizneseve dhe lëshimin e licencave, autorizimeve dhe lejeve. Portali E-Albania

shërben si një pikë e vetme kontakti për aksesin në shërbimet elektronike, mundëson ndërveprimet me disa baza të dhënash dhe ofron formularë aplikimi të para-plotësuar. Shqipëria ka vijuar punën përgatitore për të ndryshuar Ligjin për shërbimet me Direktivën e BE-së për Shërbimet. Në këtë aspekt, gjithashtu ka vijuar puna për miratimin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator, hartimin e ligjit, konsultimin me palët e interesuara dhe miratimin e një plani veprimi për shërbimet për të harmonizuar legjislacionin shqiptar me direktivat sektoriale të BE-së.

Në fushën e **shërbimeve postare**, legjislacioni shqiptar është në përputhje me *acquis* të BE-së si dhe vijon zbatimin e Strategjisë Postare 2021-2026 për zhvillimin e sektorit postar. Aktualisht, në Shqipëri operon një ofrues i shërbimit universal (Posta Shqiptare SH.A.) i caktuar deri në vitin 2025, si dhe 23 ofrues të tjerë të shërbimeve postare në treg. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) është autoriteti rregullator kombëtar i pavarur, i riafirmuar në Ligjin për Komunikimet Elektronike të vitit 2024, i cili ka hyrë në fuqi në dhjetor 2024.

Në fushën e **njohjes së ndërsjellë të kualifikimeve profesionale**, nuk është bërë ende përparim në përafrimin e *acquis* së BE-së. Shqipëria duhet të intensifikojë përpjekjet për të përafruar kornizën e saj rregullatore me Direktivën e Kualifikimeve Profesionale të BE-së. Në shkurt 2025, Shqipëria ka miratuar vendimin e CEFTA-s në lidhje me krijimin e një sistemi të përgjithshëm të njohjes së kualifikimeve profesionale. Gjithashtu, ka vijuar puna mbi hartimin e planit të veprimit për të përafruar legjislacionin shqiptar me Direktivën e BE-së për Kualifikimet Profesionale, kryesisht mbi shqyrtimin e neneve që lidhen me transparencën dhe proporcionalitetin.

Kapitulli 4: Lëvizja e lirë e kapitalit

Në BE, kapitali dhe investimet duhet të jenë në gjendje të lëvizin pa kufizime, me rregulla të përbashkëta për pagesat ndërkufitare. Bankat dhe operatorët e tjerë ekonomikë zbatojnë rregulla të caktuara për të mbështetur luftën kundër pastrimit të parasë.

Lidhur me lëvizjet e kapitalit dhe pagesat, Shqipëria ende nuk e ka përmbushur detyrimin e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit që u mundëson shtetasve dhe subjekteve të BE-së të blejnë tokë bujqësore. Si pjesë e negociatave të anëtarësimit, Shqipëria ka kërkuar një periudhë kalimtare prej shtatë vitesh nga koha e anëtarësimit në BE për zbatimin e këtij detyrimi. Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Ministrave ka ndryshuar rregulloren që lejon privatizimin e aseteve publike (tokë ose asete të luajtshme), duke përfshirë ata investitorë që kanë fituar kontrata afatgjata të qiradhënies së aseteve publike me 1 euro. Kjo situatë mund të ngrejë shqetësime në lidhje me çmimin e drejtë të shitjes për asetet e privatizuara.

Lidhur me sistemet e pagesave, transaksionet e para midis ofruesve të Shërbimit të Fillimit të Pagesave dhe bankave ndodhën gjatë tremujorit të parë të vitit 2025, si pjesë e funksionalizimit të bankave të hapura. Pagesat elektronike janë rritur me 24% në vit në gjysmën e parë të vitit 2025, të nxitura nga rritja e pagesave online dhe pagesave me karta. Përfundimi i harmonizimit të nevojshëm me *acquis* të BE-së i mundësoi Shqipërisë t'i bashkohej fushëveprimit gjeografik të skemave SEPA në nëntor 2024. Në janar 2025, Banka e Shqipërisë (BSH) nisi zhvillimin e Sistemit të Pagesave të Menjëhershme TARGET. BSH ka punuar për

futjen e standardeve ISO 20022 dhe SEPA për tregun e brendshëm, dhe për rritjen e efikasitetit të pagesave elektronike. Në shtator, BSH prezantoi ndryshime në rregulloret e sistemeve të pagesave: AIPS, AIPS EURO dhe AECH, si dhe në funksionimin e sistemit SWIFT, duke ulur ndjeshëm kostot e pagesave për qytetarët dhe bizneset, duke inkurajuar kështu përdorimin e kanaleve elektronike.

Në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Shqipëria vijoi të zbatojë rekomandimet e FATF përmes Moneyval. Shqipëria filloi punën për plotësimin e pyetësorit Moneyval-FATF për vlerësimin e raundit të gjashtë të Shqipërisë, i cili do të diskutohet nga Komiteti Moneyval në vitin 2026. Kanë vijuar përpjekjet e Shqipërisë për të përafruar legjislacionin kombëtar me Direktivat e katërt dhe të pestë kundër pastrimit të parave (AML), duke miratuar dy akte të legjislacionit dytësor të përcaktuara për subjektet e përfshira në aktivitete financiare dhe biznese e profesione jofinanciare. Për më tepër, BSH miratoi rregulloren mbi informacionin që shoqëron transferimin e fondeve dhe ngriti një zyrë të dedikuar për monitorimin e rrezikut të AML dhe Kundërshtimit të Financimit të Terrorizmit (CFT). Në shtator, BSH miratoi **rregulloren mbi licencimin, organizimin, aktivitetin dhe mbikëqyrjen e zyrave të këmbimit valutor**, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e Moneyval për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Skemat e debitit dhe kreditit SEPA u bënë funksionale më 7 tetor.

Shqipëria ka vijuar të zbatojë Strategjinë për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030, dhe planin e veprimit të vlerësimit kombëtar të rrezikut 2024-2026. Takimet monitoruese të grupit teknik të punës ndërinstitucionale u mbajtën rregullisht. Shqipëria ka legjislacion në fuqi për menaxhimin e riskut dhe kërkesat e licencimit për institucionet financiare, duke përfshirë institucionet financiare jobankare dhe zyrat e këmbimit valutor, në përputhje me rekomandimet e Moneyval. Regjistri i pronarëve përfitues është funksional. Njësia e Inteligjencës Financiare të Shqipërisë (NJIF) vijoi të forcojë kapacitetet e saj përmes trajnimeve të brendshme. Midis shtatorit 2024 dhe korrikut 2025 pati 1 537 raporte për aktivitete të dyshimta, dhe 209 u referuan nga NJIF tek agjencitë e zbatimit të ligjit. Në terma vjetorë, numri i përgjithshëm i raporteve të transaksioneve të dyshimta të paraqitura në NJIF në vitin 2024 ishte 1 632 ose 5% më i ulët se një vit më parë, dhe numri i rasteve të raportuara në agjencitë e zbatimit të ligjit ishte 234 ose 6% më i lartë krahasuar me një vit më parë. NJIF kreu 70 inspektime të subjekteve raportuese, duke u përqendruar në shqyrtimin e përputhshmërisë me ligjin AML/CFT. Gjatë vitit 2024, BSH inspektoi 50 zyra këmbimi valutor, duke u përqendruar në përmbushjen e kërkesave të legjislacionit kundër pastrimit të parave. Këto përpjekje rezultuan në 15 gjoba dhe tetë njoftime paralajmëruese, si dhe në revokimin e licencave për 14 FEO-të. Raportimet nga agjencitë e pasurive të paluajtshme të NJAF kanë parë një rritje në vitin 2024 (5 raste) krahasuar me vitin 2023 (1 rast), megjithëse nevojiten më shumë përpjekje. Organi i Mbikëqyrjes Publike ka krijuar një qasje të bazuar në risk për mbikëqyrjen e AML/CFT, si pjesë e procesit të kontrollit të cilësisë së inspektimeve të përputhshmërisë së auditorëve statutorë dhe kontabilistëve të certifikuar.

Kapitulli 6: Legjislacioni për shoqëritë tregtare

BE-ja ka rregulla të përbashkëta për formimin, regjistrimin dhe kërkesat e deklaramit të një shoqërie tregtare, me rregulla plotësuese për kontabilitetin dhe raportimin financiar, si dhe auditimin statutor.

Edhe pse ka njëfarë përafrimi me acquis të BE-së në një gamë të gjerë fushash **të legjislacionit për shoqëritë tregtare dhe qeverisjes korporative**, nuk pati përparim legjislativ gjatë periudhës së raportimit. Në shkurt 2025, Shqipëria miratoi Vlerësimin e Ndikimit Rregullator mbi përafrimin e legjislacionit me Direktivën e Kodifikimit të BE-së. Nevojitet përafrim i mëtejshëm me Direktivën mbi përdorimin e mjeteve digjitale dhe Direktivën mbi shndërrimin, bashkimin dhe ndarjen ndërkufitare, si dhe me rregullat mbi inkurajimin e angazhimit afatgjatë të aksionarëve (Direktiva II për të Drejtat e Aksionarëve) dhe me disa aspekte që lidhen me ofertat e blerjes. Mbetet ende për t'u krijuar një kod qeverisjeje korporative për shoqëritë e listuara në bursë, në përputhje me parimet e OECD-së.

Në **fushën e raportimit të shoqërive tregtare**, Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare është pjesërisht i përafruar me Direktivën e Kontabilitetit të vitit 2013 të BE-së, dhe duhet bërë përparim në lidhje me zbatimin e saj për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe subjektet me interes publik, si dhe për raportimin vend pas vendi. Përveç kësaj, Shqipëria duhet të vazhdojë të përafrohet me Direktivën e Raportimit të Qëndrueshmërisë së Korporatave dhe Direktivën e Raportimit Jo-Financiar, duke pasur parasysh zhvillimet e vazhdueshme në acquis të BE-së. **Lidhur me auditimin statutor**, në dhjetor 2024, Shqipëria miratoi Ligjin e ndryshuar për auditimin, organizimin e profesionit të auditusit dhe të kontabilistit të çertifikuar, duke synuar përafrim të mëtejshëm me direktivat përkatëse të BE-së për të siguruar mbikëqyrje më të fortë, pavarësi të shtuar të auditusit, siguri të shtuar të cilësisë dhe transparencë dhe nivel më të lartë të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Shqipëria duhet të forcojë kapacitetin e Bordit Mbikëqyrës të Auditimit Publik dhe të përafrojë më tej kornizën e tij me rregullat e auditimit statutor të BE-së.

Kapitulli 7: Ligji i pronësisë intelektuale

BE-ja ka harmonizuar në një masë të madhe rregullat për mbrojtjen ligjore dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (IPR), duke mbuluar veçanërisht patentat, shpikjet bioteknologjike dhe produktet farmaceutike, duke përfshirë certifikatat shitesë të mbrojtjes (SPC), markat tregtare, dizenjot, treguesit gjeografikë (GI), duke përfshirë GI-të artizanale dhe industriale, si dhe të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to.

Në **fushën e të drejtës së autorit** dhe të drejtave të lidhura me to, është hartuar një draft ligj i ri dhe aktualisht është duke u shqyrtuar.

Katër Organizata të Menaxhimit Kolektiv (OMK) u licencuan në shtator 2024 dhe së bashku formojnë një qendër të vetme shërbimi. Metodologjia për mbledhjen e shpërblimit për përdorimet e veprave të mbrojtura nga të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to u finalizua dhe është në fuqi.

Për të drejtat e pronësisë industriale, ligjet për markat tregtare dhe patentat u miratuan në korrik 2025 për t'u përafruar me acquis të BE-së në këto fusha. Në vitin 2024, sektori i

patentave dhe modeleve të shërbimeve ka regjistruar 742 aplikime për patentë, nga të cilat 12 ishin aplikime për patentë kombëtare me aplikantë shqiptarë dhe 730 u lëshuan nga Zyra Evropiane e Patentave që kërkonin mbrojtje në Shqipëri. Në të njëjtën periudhë, u regjistruan 4 252 aplikime për marka tregtare: 1 575 aplikime kombëtare dhe 2 677 aplikime ndërkombëtare.

Inspektorati Shtetëror për Mbikëqyrjen e Tregut është përgjegjës për monitorimin e zbatimit të të drejtave të pronësisë intelektuale. Në vitin 2024, divizioni i të drejtave të autorit i SIMS kreu 342 inspektime, që rezultuan në 40 sanksione administrative. Divizioni i pronësisë industriale kreu 407 inspektime, që rezultuan në 12 sanksione administrative.

Kapitulli 8: Politika e konkurrencës

Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Ato përfshijnë rregulla antitrust kundër marrëveshjeve kufizuese midis kompanive dhe abuzimit me një pozicion dominues, si dhe përfshijnë rregulla mbi përqendrimet midis kompanive të cilat do të pengonin ndjeshëm konkurrencën efektive. Rregullat e BE-së përcaktojnë gjithashtu një sistem kontrolli të ndihmës shtetërore. Qeveritë lejohen të japin ndihmë shtetërore vetëm nëse përmbushen kushte kufizuese, me qëllim parandalimin e shtrembërimit të konkurrencës.

Antitrust dhe bashkimet

Korniza legjislative e Shqipërisë është përgjithësisht në përputhje me acquis të BE-së dhe MSA-në.

Në shtator 2024, për të përafruar më tej legjislacionin e saj dytësor me acquis të BE-së, Komisioni i Konkurrencës miratoi udhëzimet për referimin e rasteve që lidhen me përqendrimet. **Korniza institucionale** bazohet në Autoritetin Shqiptar të Konkurrencës (AKK), i cili është një autoritet i pavarur nga ana operative. I raporton Parlamentit dhe gëzon kompetenca të mjaftueshme. Lidhur me kapacitetet zbatuese, AKSH-ja ka ruajtur numrin e përgjithshëm të stafit në 46. Lidhur me zbatimin, midis shtatorit 2024 dhe shtatorit 2025, AKSH-ja ka lëshuar 100 vendime, duke përfshirë katër për marrëveshje të ndaluara, 15 për abuzim me një pozicion dominues dhe 58 që autorizojnë përqendrime. AKSH-ja ka kryer procedura paraprake dhe të thelluara hetimore, duke rezultuar në gjoba të konsiderueshme për kompanitë që operojnë në sektorë kyç ekonomikë në Shqipëri, duke përfshirë ndërtimin dhe agro-biznesin. AKSH-ja duhet të vazhdojë të rrisë ndërgjegjësimin dhe të forcojë zbatimin e rregullave të konkurrencës.

Ndihma shtetërore

Lidhur me **kuadrin legjislativ**, Ligji kuadër për ndihmën shtetërore pasqyron kryesisht nenet 107 dhe 108 të TFBE-së, por legjislacioni zbatues mbetet pjesërisht i përafruar me acquis të BE-së vetëm në disa fusha, siç është Rregullorja e Përgjithshme për Përfjashtimin në Bllok.

Lidhur me **kuadrin institucional**, Komisioni i Ndihmës Shtetërore (KNSH) është përgjegjës për zbatimin e Ligjit për ndihmën shtetërore. Pavarësia e tij operationale, e cila kërkohej nga MSA-ja, ende nuk është garantuar, duke pasur parasysh se është një degë e Ministrisë së

Financave dhe Ekonomisë. Në këtë drejtim, u finalizua një vlerësim i ndikimit të politikave (PIA) i cili do të shërbejë si një plan teknik, duke ofruar mundësi për të siguruar pavarësinë operative të KNSH.

Kapaciteti zbatues të KNSH mbetet i pamjaftueshëm pasi stafi i sekretariatit të tij duhet të rritet ndjeshëm. **Në lidhje me zbatimin**, në periudhën raportuese, KNSH miratoi katër vendime mbi autorizimin e ndihmës shtetërore, duke përfshirë mbështetjen për bizneset e reja dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme inovative, duke u përqendruar në tranzicionin e gjelbër dhe digjital. KNSH mund të nxjerrë vendime mbi ndihmën e paligjshme dhe të papajtueshme dhe të urdhërojë rikuperimin, por deri më sot nuk e ka bërë këtë. Regjistri i zbatimit të kontrollit të ndihmës shtetërore duhet të përmirësohet ndjeshëm. Aktivitetet e ndërgjegjësimit midis dhënësve të ndihmës shtetërore duhet të intensifikohen për të siguruar njoftimin paraprak të masave të ndihmës.

Liberalizimi

Ligji për ndihmën shtetërore zbatohet për të gjithë personat juridikë dhe fizikë që kryejnë një aktivitet ekonomik. Nuk ka pasur hetime për ndihmën shtetërore për ndërmarrjet publike ose ndërmarrjet me të drejta të veçanta ose ekskluzive.

Kapitulli 9: Shërbimet financiare

Rregullat e BE-së synojnë të sigurojnë konkurrencë të drejtë midis institucioneve financiare dhe stabilitetin dhe integritetin e tregjeve financiare, përkatësisht në fushat e bankave, sigurimeve, pensioneve plotësuese, shërbimeve të investimit dhe letrave me vlerë. Ato përfshijnë rregulla mbi autorizimin, funksionimin dhe mbikëqyrjen e këtyre institucioneve.

Në fushën e konglomerateve bankare dhe financiare, ka vijuar puna teknike për përafrimin e mëtejshëm me Rregulloren e Kërkesave të Kapitalit dhe Direktivën e Kërkesave të Kapitalit. Gjithashtu, ka vijuar puna për hartimin e Ligjit për konglomeratet financiare në përputhje me acquis përkatës dhe kanë vijuar dhe konsultimet me palët e interesuara priten brenda vitit 2025. BSH përfundoi pyetësin e saj të parë të hapit në shkurt 2025 për këshilla teknike për Komisionin mbi vlerësimin e ekuivalencës të kryer nga Autoriteti Bankar Evropian dhe ka kaluar në pyetësin e hapit të dytë. Në nëntor 2024, BSH ndryshoi legjislacionin mbi raportimin sipas Sistemit të Unifikuar të Raportimit, duke paraqitur modele të reja raportimi dhe kërkesa në lidhje me treguesit e paralajmërimit të hershëm dhe regjistrin e ngjarjeve të rrezikut operacional. Ajo miratoi gjithashtu kërkesa të reja për subjektet raportuese për ofrimin e raportimit tremujor mbi strukturën e aksionarëve/partnerëve të kapitalit të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë. Agjencia e Sigurimit të Depozitave të Shqipërisë ka vijuar të punojë për ndryshimin e Ligjit ekzistues "Për sigurimin e depozitave" për ta përafruar atë me acquis të BE-së. Nuk ka pasur zhvillime në përafrimin e mëtejshëm me kuadrin ligjor të rimëkëmbjes dhe zgjidhjes së bankave të BE-së. Prandaj, përpjekjet për reforma për t'u përafruar me acquis të BE-së duhet të rriten.

Në dhjetor 2024, BSH-ja u komunikoi bankave kërkesën minimale të ndërmjetme për fondet e veta dhe detyrimet e pranueshme (MREL), që duhet të përmbushen gjatë vitit 2025 dhe

përfundoi e përditësoi planet e zgjidhjes për 11 bankat që operojnë në Shqipëri. Në shkurt 2025, BSH-ja vendosi të mbajë të pandryshuar politikën për Fondin e Zgjidhjes gjatë vitit. BSH-ja monitoron performancën e aseteve financiare të Fondit të Zgjidhjes çdo tremujor përmes Agjencisë së Sigurimit të Depozitave të Shqipërisë. Objektivi i përgjithshëm i nivelit të financimit për Fondin e Zgjidhjes për vitin 2027 është 0.5% e totalit të detyrimeve të sektorit bankar (i papërafruar ende me BRRD-në, sipas të cilës niveli i synuar i fondit të zgjidhjes duhet të jetë 1% e depozitave të mbuluara).

Shqipëria miratoi në mars të vitit 2025 Ligjin për themelimin e Bankës Kombëtare të Zhvillimit, nëpërmjet të cilit mbledhja e depozitave nuk do të trajtohet nga Banka, por nga një entitet i Shërbimit Postar pa kërkesa licencimi. Mbikëqyrja/marrëdhënia midis këtij entiteti, Bankës Kombëtare të Zhvillimit dhe Bankës Qendrore, duhet të përcaktohet pa vonesë.

Lidhur me infrastrukturën e tregut financiar, Shqipëria mbetet pjesërisht e përafruar me legjislacionin e infrastrukturës së tregjeve financiare. Nuk është bërë ndonjë përparim i veçantë gjatë periudhës së raportimit në këtë fushë, gjë që kërkon vëmendje të menjëhershme.

Në fushën e sigurimeve dhe pensioneve të punës, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë (AMF) ka nisur një plan veprimi tregues për përafrimin e legjislacionit me Direktivën e Solvency II. Ndryshimet në Ligjin për aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit u miratuan në dhjetor të vitit 2024 dhe u dërguan për miratim në Parlament, duke synuar përafrimin e mëtejshëm me Direktivën e Solvency II dhe Direktivën e Shpërndarjes së Sigurimeve. Përpjekjet për të zbatuar këto ndryshime duhet të intensifikohen. Në vitin 2025, bordi i AMF-së miratoi rregulloren për përcaktimin e faktorëve të rrezikut gjatë llogaritjes së primeve të sigurimit të detyrueshëm për sektorin e transportit dhe një rregullore që përcakton rregullat mbikëqyrëse për aktivitetet e sigurimit të jetës në lidhje me pjesëmarrjen në sipërmarrjet e investimeve kolektive me ofertë publike.

Për fondet e investimeve, Shqipëria ka filluar përgatitjet për hartimin e një rregulloreje mbi skemën e kompensimit të investitorëve pas një vlerësimi të praktikave më të mira të BE-së.

Për financat e qëndrueshme dhe digjitale, në janar 2025, BSH nënshkroi me Bankën Evropiane të Investimeve një marrëveshje bashkëpunimi që synon zhvillimin e financave të gjelbra, duke përfshirë zhvillimin e Taksonomisë së Gjelbër. BSH ka punuar mbi metodologjitë e testimit të stresit të rrezikut klimatik për të vlerësuar rreziqet e mundshme nga goditjet financiare të lidhura me klimën dhe po monitoron nga afër se si rreziqet klimaterike ndikojnë në stabilitetin financiar dhe ekonomik. Në nëntor 2024, BSH miratoi një rregullore mbi menaxhimin e rrezikut operacional nga bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, për të adresuar rrezikun operacional, kibernetik dhe TIK. Gjatë periudhës së raportimit, AMF ka kryer një analizë krahasuese të legjislacionit aktual me Rregulloren e Tregut të Kripto-Aseteve (MiCA) dhe në korrik u ngrit një grup ndërinstitutional pune për ndjekur procesin për përafrimin me acquis të BE-së. BSH dhe AMF kanë filluar punën për hartimin e rregulloreve përkatëse mbi qëndrueshmërinë operationale digjitale për përafrimin me kërkesat e Aktit të Rezistencës Operationale Digjitale (DORA) të BE-së.

Kapitulli 28: Mbrojtja e konsumatorit dhe shëndetit

Rregullat e BE-së mbrojnë interesat ekonomike të konsumatorëve dhe gjithashtu garantojnë sigurinë e produkteve, parandalojnë imitimet e rrezikshme dhe përcaktojnë përgjegjësinë për produktet me defekt. BE-ja gjithashtu garanton një nivel të lartë mbrojtjeje të shëndetit publik dhe në veçanti siguron standarde të larta të përbashkëta për kontrollin e duhanit, gjakun, indet, qelizat dhe organet, si dhe produktet medicinale për përdorim njerëzor dhe veterinar. BE-ja gjithashtu ka rregulla për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve në kujdesin shëndetësor ndërkufitar dhe në përgatitjen dhe reagimin ndaj kërcënimeve serioze shëndetësore ndërkufitare, duke përfshirë sëmundjet ngjitëse.

Mbrojtja e konsumatorit

Në aspektet horizontale, Shqipëria ka një Strategji ndërsektoriale 2023-2030 për mbrojtjen e konsumatorit dhe mbikëqyrjen e tregut. Gjatë periudhës raportuese, organi për Mbrojtjen e Konsumatorit (KMK) ka marrë ankesa, megjithatë, nuk ishte i disponueshëm informacioni se si KMK i ka trajtuar këto. **Nuk ka pasur zhvillime në lidhje me zbatimin dhe dëshmipërblimin. Lidhur me sigurinë e produkteve**, Shqipëria ende nuk është përafruar me acquis-in e ri të BE-së për Sigurinë e Përgjithshme të Produkteve. Shqipëria është përafruar vetëm pjesërisht me acquis-në për përgjegjësinë ndaj produktit dhe për mbrojtjen e konsumatorit. (Për informacion mbi mbikëqyrjen e tregut, shih Kapitullin 1 - Lëvizja e lirë e mallrave).

Tatimi i akcizës është pjesërisht i përafruar me acquis të BE-së në lidhje me akcizën për alkoolin dhe pijet alkoolike, duhanin, produktet e energjisë dhe rregullat e përgjithshme për prodhimin, mbajtjen, ruajtjen, lëvizjen dhe kontrollin e produkteve të akcizës. Përafrimi me minimumin e akcizës së BE-së për produktet e duhanit është duke vazhduar, përmes një rritjeje graduale dhe të planifikuar të normave të akcizës së cigareve nga viti 2025 deri në vitin 2033, e cila vazhdoi të zbatohet. Shqipëria ende duhet të kalojë në një strukturë të përzier të akcizës

(ad valorem dhe specifike) për cigaret. Legjislacioni kombëtar që parashikon një normë preferenciale tatimore për 'rakinë shqiptare' të prodhuar nga individë privatë nuk është i përafruar me legjislacionin e BE-së. Legjislacioni kombëtar është i përafruar me ligjin e BE-së për akcizën për produktet e energjisë, me përjashtim të energjisë elektrike dhe gazit natyror, të cilat nuk i nënshtrohen akcizës në Shqipëri. Norma e akcizës për disa produkte karburanti është ende nën minimumin sipas direktivave të BE-së. Sistemi i Lëvizjes dhe Kontrollit të Akcizës është ngritur në nivel kombëtar.

Lidhur me **Tatimet direkt**, ligji për tatimin mbi të ardhurat është pjesërisht i përafruar me acquis të BE-së. Analizimi i legjislacionit të BE-së për taksat direkte dhe transpozimi i tij në legjislacionin vendas ka filluar. Deri në dhjetor 2025, vlerësohet të bëhet hartimi i parë i përafrimit, dhe një përafrim i plotë është planifikuar deri në vitin 2027.

Shqipëria duhet të sigurojë që çdo ligj i ardhshëm vullnetar për pajtueshmërinë tatimore të jetë në përputhje me acquis të BE-së dhe standardet ndërkombëtare.

Shqipëria duhet të rishikojë legjislacionin kombëtar tatimor që vendos taksë mbi plastikën e importuar si mall/lëndë e parë, për të siguruar përafrimin me angazhimin e saj sipas MSA-së.

Lidhur me **bashkëpunimin administrativ dhe ndihmën e ndërsjellë**, Shqipëria ka marrëveshje për Tatimet e dyfishtë me 23 shtete anëtare dhe është zotuar të lidhë marrëveshje me katër shtetet e mbetura pezull - Danimarkën, Qipron, Portugalinë dhe Lituaninë.

Ligji për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare zbaton dispozitat e OECD-së dhe Shqipëria ka zgjeruar numrin e juridiksioneve me të cilat shkëmben informacion. Shqipëria ka shkëmbyer automatikisht informacion mbi llogaritë financiare me 80 juridiksione (përfshirë 26 shtete anëtare të BE-së) në vitin 2024 dhe ka marrë informacion nga 65 juridiksione (nga të cilat 22 shtete anëtare të BE-së) brenda kuadrit të standardit të përbashkët të raportimit të OECD-së. Një kuadër për raportimin vend pas vendi sipas BEPS të OECD-së (Erozioni i Bazës dhe Zhvendosja e Fitimit) është në vend, dhe shkëmbimi fillestar i raportimit vend pas vendi është në përgatitje për vitin 2026. Në mars të vitit 2025, Këshilli i Ministrave miratoi në parim instrumentin shumëpalësh të Subjektit të Rregullës së Taksave (STTR), duke lejuar fillimin e procedurës së nënshkrimit.

Sa i përket **kapacitetit operacional**, në fund të korrikut të vitit 2025 kishte 179 vende të lira pune në administratën tatimore (në vitin 2024, dhe deri më 31 korrik 2025 kishte 148 rekrutime, 97 të larguar ose të dhënë dorëheqjen dhe 15 shkarkime). **Digjitalizimi** i procesit të fiskalizimit konsiderohet plotësisht i përfunduar, megjithëse është e nevojshme punë e mëtejshme për përdorimin e të dhënave të gjeneruara, si dhe rritja e përdorimit të të dhënave të palëve të treta. Për më tepër, Shqipëria duhet të vazhdojë të përgatitet për arritjen e ndërlidhjes dhe ndërveprimit me sistemin e BE-së.

Kapitulli 17: Politika ekonomike dhe monetare

Rregullat e BE-së kërkojnë pavarësinë e bankave qendrore dhe i ndalojnë ato të financojnë drejtpërdrejt sektorin publik. Shtetet anëtare koordinojnë politikat e tyre ekonomike dhe i nënshtrohen mbikëqyrjes fiskale, ekonomike dhe financiare.

Sa i përket **politikës monetare**, Shqipëria ka një nivel të lartë përafrimi me acquis të BE-së mbi ndalimin e aksesit të privilegjuar të sektorit publik në institucionet financiare. Legjislacioni i Shqipërisë është pjesërisht i përafruar me acquis të BE-së mbi pavarësinë e bankës qendrore dhe mbi ndalimin e financimit monetar të sektorit publik. Në korrik u krijua një grup pune për të filluar punën për ndryshimin e ligjit të Bankës Qendrore për t'u përafruar me acquis. Shqipëria duhet të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të përafruar plotësisht kuadrin e saj ligjor me acquis të BE-së në lidhje me pavarësinë e plotë të BSH-së, ndalimin e financimit monetar të sektorit publik dhe ndalimin e aksesit të privilegjuar. Shqipëria gjithashtu duhet të sigurojë që legjislacioni kombëtar, duke përfshirë statutet e bankës së saj qendrore, të jetë në përputhje me Statutin e Sistemit Evropian të Bankave Qendrore dhe të Bankave Qendrore Evropiane.

Lidhur me **politikën ekonomike**, rregullat fiskale, duke përfshirë ato mbi bilancin primar dhe raportin e borxhit, u përmbushën në vitin 2024 (shih edhe Seksionin 2.3 - Kriteret ekonomike). Rishikimet e buxhetit vazhduan të miratohen përmes akteve normative në vitin 2024, ngjashëm me praktikën në vitet e mëparshme. Shqipëria nuk ka ende një këshill fiskal, por filloi puna përgatitore për ngritjen e një institucioni të tillë. Shqipëria po punon për rishikimin e skemës së pensioneve, një proces i cili do të duhej të adresonte boshllëkun në skemën e sigurimeve shoqërore, duke përfshirë forcimin e parashikimeve fiskale afatgjata dhe një rishikim të metodologjisë për përcaktimin e pensioneve minimale dhe maksimale. Shqipëria është pjesërisht në përputhje me kërkesat për koordinimin dhe mbikëqyrjen e politikave ekonomike të përcaktuara nga Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Pjesëmarrja e saj aktive në ushtrimin e **Programit të Reformës Ekonomike (ERP)**, përfshirë atë të fundit për vitet 2025-2027, ka kontribuar në zhvillimin e kapacitetit administrativ të vendit që lidhet me këtë Kapitull. ERP e Shqipërisë përshkroi politikat kryesore makroekonomike dhe fiskale të vendit. Udhëzimet politike të miratuara bashkërisht në Dialogun Ekonomik dhe Financiar 2024 janë zbatuar pjesërisht. ERP e Shqipërisë do të përfitonte nga përfshirja e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike dhe treguesve të produktivitetit, analiza e përmirësuar e masave kryesore fiskale dhe ndikimi i tyre buxhetor, rreziqet fiskale dhe një konsultim më efektiv publik.

Kapitulli 19: Politika sociale dhe punësimi

Rregullat e BE-së në fushën sociale përfshijnë standardet minimale për ligjin e punës, barazinë dhe mosdiskriminimin, shëndetin dhe sigurinë në punë. Ato gjithashtu promovojnë përfshirjen sociale dhe mbrojtjen sociale, si dhe dialogun social në nivel të BE-së. Për **shëndetin dhe sigurinë në punë**, Shqipëria ka miratuar Dokumentin e Politikave për Shëndetin dhe Sigurinë në Punë dhe Planin e saj të Veprimt 2025–2030, në përputhje me kuadrin strategjik të BE-së për shëndetin dhe sigurinë në punë 2021-2027. Ngritja e Këshillit Ndërmnistror të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë dhe sekretariatit të tij është ende në pritje. Ligji i rishikuar i punës është duke u zbatuar.

Për **aktivitetet e inspektimit të punës**, lançimi i matricave inteligjente të vlerësimit të riskut rezultoi në 75% të inspektimeve totale (9 860) të planifikuara mbi vlerësimin e bazuar në risk. Pavarësisht kapaciteteve shumë të kufizuara të inspektoratit të shërbimeve sociale, numri i inspektimeve u rrit në 126 në vitin 2024 (krahasuar me 108 në vitin 2023). Kapacitetet e inspektoratit të shërbimeve sociale duhet të forcohen. Në vitin 2024, 90% e aksidenteve të

lidhura me punën u raportuan nga punëdhënësit, një rritje prej 2.4% nga viti 2023, duke treguar një nivel të qëndrueshëm raportimi dhe hetimi. Ndërfaja midis Matricave Inteligjente të Vlerësimit të Riskut (MIRA) me platformën e-inspektimit do të rriste efikasitetin e punës së Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Sociale.

Lidhur me **dialogun social**, procesi i konsultimit trepalësh duhet të përmirësohet. Këshilli Kombëtar i Punës u mbledh vetëm dy herë në periudhën raportuese, ndërsa bashkëpunimi trepalësh mbeti i pamjaftueshëm. Ngritja e kapaciteteve për partnerët socialë duhet të vazhdojë.

Lidhur me **politikën e punësimit**, zbatimi i strategjisë kombëtare të punësimit dhe aftësive 2023-2030 vazhdoi. Pilotimi i Planit të Zbatimit të Garancisë Rinore është zgjatur deri në fund të vitit 2027. Ligji i ndryshuar për të rinjtë, i miratuar në prill 2025, përfshin dispozita kyçe për të rinjtë që nuk janë në punësim, arsim ose trajnim (NEET) dhe do t'i mundësojë Institutit të Statistikave të prodhojë raporte profili kombëtare dhe rajonale. Gjatë vitit 2024, 508 NEET (58% gra) të identifikuar me nevoja të hartuara, u referuan në oferta të përshtatshme, me një shkallë pozitive daljeje prej 66%. 13% e tyre i përkasnin grupeve vulnerabël (kryesisht romë/egjiptianë, të rinj me aftësi të kufizuara ose migrantë të kthyer). Progresi vazhdon në zbatimin e strategjisë së daljes për përfituesit e ndihmës ekonomike. Pilotimi dhe zbatimi i Programit të Nxitjes së Punësimit për Riintegrimin Social është planifikuar të fillojë deri në fund të vitit 2025. Programi synon përfshirjen në tregun e punës të punëkërkuarve të papunë afatgjatë.

Sa i përket **formimit profesional (AFP)**, 4 191 përfitues të ndihmës ekonomike u punësuan ose u regjistruan në vitin 2024, krahasuar me 4 158 në vitin 2023. Subvencionet për zhvillimin e aftësive digjitale dhe kodimin vazhduan në vitin 2024 me 845 pjesëmarrës (nga të cilët 53 ishin të papunë). Shkalla e punësimit u rrit në vitin 2024 në 68.3% (66.5% në vitin 2023).

Për **pjesëmarrjen në fuqinë punëtore dhe shkallën e papunësisë** shihni aneksin statistikor dhe seksionin mbi funksionimin e tregut të punës nën 2.3 Kriteret ekonomike.

Për **mbrojtjen dhe përfshirjen sociale**, Strategjia për Mbrojtjen Sociale është duke u zbatuar. Në prill 2025, qeveria organizoi një Event Rajonal mbi Përsheptimin e Reformave të Kujdesit për Fëmijët drejt Anëtarësimit në BE si pikënisje për Planin e Garancisë për Fëmijët, si pjesë e strategjisë. Shqipëria ka emëruar një Pikë Kontakti Kombëtare për Garancinë Evropiane për Fëmijët. Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës e publikuar në shkurt 2024 tregoi se 19.7% e popullsisë ishte në rrezik varfërie. Në periudhën raportuese, kjo përqindje mbeti e lartë për fëmijët, duke qëndruar në 26.5%, me vajzat më të prekura (27.3%). Masat e marra për të adresuar varfërinë kanë qenë të pamjaftueshme. Për vitin 2025, buxheti total për Fondin Social u rrit me 14%, financimi për 57 shërbime në nivel bashkiak dhe 19 Shërbime të Kujdesit të Specializuar në nivel rajonal. Ende nuk ka asnjë mekanizëm për krijimin dhe zbatimin e një mekanizmi indeksimi të përfitimeve të Ndihmës Ekonomike. Trafikimi i fëmijëve në familje, lypja e detyruar dhe puna e fëmijëve janë një shqetësim pavarësisht politikave që janë në përputhje me standardet ndërkombëtare.

U bë përparim në monitorimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Përfshirjen e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2025. Janë bërë përpjekje për të siguruar aksesin e personave me

aftësi të kufizuara në institucione të ndryshme, megjithëse shpesh kjo lidhet vetëm me aksesin fizik.

Lidhur me përfshirjen e **romëve dhe egjiptianëve**, nevojiten përpjekje të mëtijshme për të përmirësuar burimet njerëzore të alokuara brenda Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për koordinimin e politikave që lidhen me romët, si dhe për të rritur lëvizshmërinë e tregut të punës dhe për të luftuar diskriminimin. Regjistri Elektronik Kombëtar i Shërbimeve të Kujdesit Social nuk është plotësisht funksional. Këto përpjekje u lidhën gjithashtu me zbatimin dhe monitorimin e mbështetjes së ofruar përmes Fondit Social. Vazhdon të ketë sfida, duke përfshirë personelin, mungesat e pajisjeve dhe shqetësimet në lidhje me lehtësinë e përdorimit të softuerit. Në korrik 2025, Shqipëria emëroi një Zëvendësministër të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nga komuniteti rom, përgjegjës për përfshirjen sociale.

Lidhur me **mosdiskriminimin në punësim dhe politikat sociale**, ende duhet të përfundohet harmonizimi i plotë me legjislacionin e BE-së, veçanërisht me Direktivën për Barazi në Punësim dhe Direktivën për Barazi Raciale. Numri i personave me aftësi të kufizuara që regjistrohen si kërkues pune u rrit në 8 000 në vitin 2024 (2 656 në vitin 2023).

Lidhur me barazinë midis grave dhe burrave në punësim dhe politikat sociale, pabarazia gjinore në punësim mbetet, me hendekun e shkallës së punësimit midis burrave dhe grave që shtrihet në 13% në vitin 2024 (10.4% në vitin 2023). Shkalla e papunësisë për burrat ishte 8.0%, ndërsa për gratë ishte 9.6%. Shkalla NEET midis të rinjve mbetet e lartë me 2.1 pikë më të lartë për gratë (25.6%) sesa për burrat (23.5%). Hendeku gjinor në paga u ngushtua në 4.9% krahasuar me 6.2% në vitin e kaluar.


Shqipëria ende duhet të përafrojë legjislacionin e saj me acquis-in e barazisë gjinore në fushën e politikave sociale dhe punësimit, duke përfshirë ekuilibrin midis punës dhe jetës personale, transparencën e pagave dhe gratë në borde.

Kapitulli 20: Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale

Politika industriale e BE-së forcon konkurrueshmërinë, lehtëson ndryshimet strukturore dhe inkurajon një mjedis miqësor ndaj biznesit që stimulon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM).

Mbi **parimet e politikës së ndërmarrjeve dhe industrisë**, Shqipëria miratoi Strategjinë e Specializimit të Zgjuar në dhjetor 2024 (shih Kapitullin 25 - Shkenca dhe kërkimi shkencor) dhe në prill një raport monitorimi afatmesëm mbi zbatimin e Strategjisë së Investimeve dhe Zhvillimit të Biznesit (BIDS). Një vendim për ndryshimin e BIDS është miratuar në vitin 2025, i cili përqendrohet në ndërkombëtarizimin dhe aftësitë e NVM-ve, por vështirë se korrigjon progresin e dobët të raportuar të zbatimit. Në shkurt 2025, Parlamenti miratoi disa ndryshime në Ligjin për investimet strategjike, të cilat, ndër të tjera, i zgjatën efektet e tyre deri në fund të vitit 2026. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka përfunduar dhe ka vënë në internet platformën e Eksportit, duke synuar të mbështesë ndërkombëtarizimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Pavarësisht përmirësimeve të mëtejshme, shqetësimet mbeten midis përfaqësuesve të biznesit në nivelin e konsultimit publik nga qeveria dhe Parlamenti, veçanërisht në lidhje me integrimin në BE. Bizneset ankohen për barrë të panevojshme burokratike dhe kërkojnë procedura dhe afate më të qarta. Qartësia në zbatimin e akteve ligjore do të eliminonte "zonën gri" e cila mund të shërbejë si një zonë në të cilën biznese të caktuara mund të përfitojnë në shkëmbim të favoreve/veprimeve korruptive. Progresi në reformën në drejtësi dhe anti-korrupsionin janë të mirëpritura nga biznesi.



Lidhur me **instrumentet e politikave të ndërmarrjeve dhe industrisë**, koordinimi i mëtejshëm midis institucioneve shtetërore që ofrojnë stimuj financiarë për bizneset mbetet i nevojshëm, për të siguruar akses më të mirë në informacion për përfituesit dhe për të përqendruar përpjekjet e BIDS-it që lidhen me to, siç janë promovimi i investimeve AIDA, specializimi TEDA dhe mbështetja e furnizuesve të NVM-ve. Duhet të sigurohet përafrim i mëtejshëm me Direktivën e BE-së për pagesat e vonuara. Përkufizimi i NVM-ve në Shqipëri është pjesërisht në përputhje me Rekomandimin e BE-së, për numrin e të punësuarve, por kapaciteti kombëtar për të mbështetur NVM-të mbetet i kufizuar. Shqipëria u vlerësua pozitivisht në perspektivën e konkurrueshmërisë së OECD-së për vitin 2024, duke shënuar përparim në 14 nga 15 dimensionet, duke ngecur në një, ndërmarrjet shtetërore.

Lidhur me **politikat sektoriale**, Shqipëria zgjati deri në vitin 2026 periudhën e aplikimit për stimuj tatimorë për investitorët e përfshirë në ndërtimin/zhvillimin e hoteleve me 5 yje. Ajo prezantoi gjithashtu një 'paketë të maleve' për të rritur investimet në zonat malore, të cilat përfshijnë stimuj pa taksa, që do të kërkonin vëmendje të lartë në ruajtjen e vlerave ekologjike dhe të biodiversitetit të Shqipërisë. Në mars të vitit 2025, Shqipëria ishte Vendi zyrtar Pritës i Internationale Tourismus-Börse (ITB) Berlin, panairi kryesor i udhëtimeve në botë, duke

shënuar shfaqjen e saj të shpejtë si një nga destinacionet e udhëtimit me rritjen më të shpejtë në Evropë. Qeveria miratoi rregullore që do të lehtësonin zhvillimin e industrisë së mbrojtjes. Qeveria miratoi rregullore që do të lehtësonin transferimin e aseteve në Korporatën Shqiptare të Investimeve për programe të mëtejshme zhvillimi dhe rivitalizimi, si dhe rregullore për rritjen e privatizimit të aseteve shtetërore, përfshirë tokën.

Kapitulli 25: Shkenca dhe kërkimi shkencor

BE-ja ofron mbështetje të konsiderueshme për kërkimin dhe inovacionin. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së mund të marrin pjesë në programet e kërkimit dhe inovacionit të BE-së dhe të përfitojnë prej tyre, veçanërisht aty ku ka përsosmëri shkencore dhe investime të forta në kërkim dhe inovacion.

Sa i përket politikës së kërkimit dhe inovacionit, Shqipëria ende duhet të miratojë legjislacionin e nevojshëm për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030. Përveç kësaj, Shqipëria duhet të miratojë standardet për menaxhimin e të dhënave të kërkimit të përcaktuara nga organizatat ndërkombëtare.

Shqipëria rriti fondet për Kërkim dhe Zhvillim në vitin 2024 në 0.19% të PBB-së. Kjo mbetet nën objektivin kombëtar prej 1% të PBB-së që vendi synon të arrijë deri në vitin 2030. Nevojiten më shumë veprime për të rritur fondet publike të kërkimit dhe zhvillimit, stimuj për bizneset që të rrisin shpenzimet e tyre për Kërkim dhe Zhvillim dhe për të përmirësuar bashkëpunimin midis sektorit privat dhe universiteteve. Instituti i Statistikave (INSTAT) duhet të prodhojë një set të plotë të dhënash mbi kërkimin shkencor dhe inovacionin.

Agjencia Shqiptare e Bizneseve të Reja nisi thirrjen e saj të parë për biznese të reja inovative në dhjetor 2024, me një vlerë totale prej 3 milionë eurosh, me përparësi të dhënë bizneseve të reja të udhëhequra nga femrat, si dhe bizneseve të reja që përqendrohen në tranzicionin e gjelbër dhe/ose dixhitalizimin. **Strategjia e Specializimit të Zgjuar** u miratua në dhjetor të vitit 2024 dhe përfshin një plan veprimi me kosto të përcaktuar, i cili duhet të zbatohet. Shqipëria u përfshi për të tretin vit radhazi në Tabelën e Rezultateve të Inovacionit Evropian si një inovator në zhvillim me performancë nën mesataren e Inovatorëve në Zhvillim në BE dhe vendet fqinje. Rezultati i Shqipërisë ra pak nga 41.7% e mesatares së BE-së në vitin 2024 në 37.9% në vitin 2025.

Sa i përket programeve kornizë të BE-së, Shqipëria është plotësisht e lidhur me Horizon Europe. Pjesëmarrja e saj në program arriti në një total prej 46 kontratash të nënshkruara në dobi të Shqipërisë, me vlerë 7.3 milionë euro. Autoritetet duhet të inkurajojnë më tej pjesëmarrjen e sektorit privat në Horizon Europe. Përpjekjet kombëtare për inovacion duhet të jenë në përputhje me Axhendën e Re Evropiane të Inovacionit dhe Busullën e Konkurrueshmërisë. Shqipëria hapi pesë Qendra Evropiane të Inovacionit Dixhital dhe qendrën e parë komunitare të Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) që shërben si një portë hyrëse midis palëve të interesuara shqiptare dhe programeve komunitare të EIT. EIT ka ngritur një Qendër Rajonale të Inovacionit të Lëndëve të Para në Shqipëri.

Kapitulli 26: Arsimi dhe kultura

BE-ja mbështet bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe kulturës përmes programeve të financimit dhe përmes koordinimit të politikave të Shteteve Anëtare nën “metodën e hapur të koordinimit”. BE-ja dhe Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të parandalojnë diskriminimin dhe të sigurojnë arsim cilësor për fëmijët e punëtorëve migrantë, përfshirë ata nga prejardhje të pafavorizuara.

Shpenzimet publike të vlerësuara për arsimin në vitin 2024 përfaqësonin 2.6% të PBB-së krahasuar me 2.1% në vitin 2023, duke mbetur nën mesataren e BE-së prej 4.6%. Pas miratimit të Kornizës së përditësuar të Kurrikulës dhe planit të saj të veprimit në dhjetor 2024, procesi vazhdoi me një përditësim të kompetencave kryesore, duke përfshirë inovacione për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë. Është miratuar një kurrikulë e përditësuar mbi promovimin e diversitetit kulturor dhe përfshirjen e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane.

Në **arsimin parashkollor**, u regjistruan 65 914 fëmijë, 1.2% më pak krahasuar me vitin e kaluar shkollor (66 711). Në arsimin bazë, u regjistruan 250 617 nxënës, (48% vajza), 2.89% më pak se një vit më parë (258 072), nga të cilët 136 379 (54.42%) në arsimin fillor dhe 114 238 (45.58%) në arsimin e mesëm të ulët. 89 190 nxënës u regjistruan në arsimin e mesëm të lartë, duke treguar një rënie prej 2.80% (91 755). Në përgjithësi, sipas të dhënave të INSTAT për vitin akademik 2024-2025, 528 602 nxënës dhe studentë u regjistruan në arsimin formal, me një rënie prej 1% krahasuar me vitin e kaluar (533 711). Në të njëjtën periudhë, 405 989 nxënës u regjistruan në arsimin parauniversitar, duke shënuar një rënie prej 2.57% (416 717).

Shqipëria mori pjesë në Anketën Ndërkombëtare të Mësimdhënies dhe të Nxënësve. Shqipëria mori pjesë në PISA 2025, dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit zhvilloi një plan veprimi për të synuar nxënësit me rezultate të ulëta.

Gjatë periudhës së raportimit, sistemi i arsimit dhe trajnimit profesional (AFP) ka pësuar disa përmirësime dhe është ndryshuar në një program 3+1. Shqipëria ka përditësuar kuadrin e saj ligjor për të mbështetur një sistem të dyfishtë AFP që lejon përfshirjen e punëdhënësve privatë dhe publikë. Që nga shtatori 2024, programet e dyfishta AFP që përfshinin 203 nxënës të klasës së dymbëdhjetë (35 vajza/168 djem) u pilotuan në dhjetë shkolla AFP. Në vitin akademik 2024-2025, pjesa e nxënësve të regjistruar në shkollat publike AFP përfaqësonte 19% (16 976) të numrit të përgjithshëm të nxënësve të regjistruar në arsimin e mesëm të lartë, nga 17.90% në vitin e kaluar shkollor (2023-2024). Rritja përputhet me objektivin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për të pasur një të tretën e nxënësve në AFP. Shqipëria ende duhet të krijojë një bazë ligjore për njohjen e të nxënësve të mëparshëm joformal dhe informal dhe të pajisë plotësisht Agjencinë Kombëtare për AFP-në dhe Kualifikimet. Këto masa lejojnë zhvillimin e një kuadri të sigurimit të cilësisë në arsimin dhe trajnimin profesional, duke i përafëruar kurrikulat me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK).

Në arsimin e lartë, Shqipëria është anëtare e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (procesi i Bolonjës). Siç përcaktohet në Raportin e Zbatimit të Procesit të Bolonjës 2024, Shqipëria ende duhet të punojë për zbatimin e plotë të angazhimeve kryesore, veçanërisht në lidhje me njohjen automatike dhe sigurimin e cilësisë.

Në arsimin gjithëpërfshirës, po vihet re progres në përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse dhe të përqendruara te fëmija në parashkollor, si dhe në përafrimin me kuadrin e BE-së "Cilësia e Arsimit dhe Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme". 5 233 nxënës me nevoja të veçanta ndiqnin klasa gjithëpërfshirëse, 16% më shumë se në vitin 2023 (4 507). Vetëm 453 nxënës me nevoja të veçanta ndoqën shkolla speciale në vitet 2024-2025 (518 në vitin 2023). Përqindja e nxënësve me aftësi të kufizuara që ndjekin arsimin gjithëpërfshirës përfaqësonte 92% të nxënësve me nevoja të veçanta krahasuar me 8% të atyre që ndjekin arsimin special. Në periudhën raportuese, 2 266 mësues ndihmës (që është 14% më shumë krahasuar me vitin 2023) ishin të punësuar në sistemin publik të arsimit parauniversitar. Në periudhën raportuese, 13 130 fëmijë romë dhe egjiptianë u regjistruan në arsimin parauniversitar krahasuar me 12 508 në vitin 2023. Për të lehtësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis grupeve vulnerabël dhe shkollave, janë punësuar 13 ndërmjetës dhe 100 mësues të kualifikuar me prejardhje romë dhe egjiptiane.

Lidhur me **aftësitë digjitale dhe të gjelbra**, kurrikula e TIK-ut u zhvillua në përputhje me planin e transformimit digjital. Ky projekt përfshin instalimin e laboratorëve inteligjentë mbi 600 shkolla publike fillore dhe të mesme të larta.

Vendi përfiton nga dimensionin ndërkombëtar i **programit Erasmus+ 2021-2027**. U përzgjedhën 15 projekte për ndërtimin e kapaciteteve të arsimit të lartë për financim, nga të cilat 9 koordinohen nga Institucionet e Arsimit të Lartë Shqiptar. Projektet e përzgjedhura të lëvizshmërisë do të financojnë mbi 3 700 shkëmbime studentësh dhe stafi nga dhe për në Shqipëri. Shqipëria po merr pjesë në të gjitha grupet e punës të Zonës Evropiane të Arsimit 2021-2025.

Në vitin 2025, Shqipëria nuk merr pjesë në Javën Evropiane të Sportit. Ndryshimi i Ligjit për Rininë u miratua në prill 2025, ndërsa vazhdoi zbatimi i **Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029**.

Lidhur me kulturën, vazhdon zbatimi i strategjisë kombëtare 2019-2025. Autoritetet kanë miratuar dy akte nënligjore për Ligjin për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë, por ende nevojitet legjislacion shtesë zbatues për funksionim të plotë. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në programin e BE-së 2021-2027 "Evropa Krijuese" dhe është anëtarësuar në Konventën e UNESCO-s të vitit 2005 për Mbrojtjen dhe Promovimin e Diversitetit të Shprehjeve Kulturore.

Kapitulli 29: Bashkimi Doganor

Të gjitha Shtetet Anëtare janë pjesë e bashkimit doganor të BE-së dhe ndjekin të njëjtat rregulla dhe procedura doganore. Kjo kërkon harmonizim legjislativ, si dhe kapacitet të mjaftueshëm zbatimi, si dhe akses dhe ndërveprim me mjedisin elektronik doganor të BE-së.

Lidhur me **legjislacionin doganor**, kodi doganor i Shqipërisë është gjerësisht i harmonizuar me *acquis* të BE-së. Megjithatë, nevojiten përpjekje të konsiderueshme dhe ato janë duke u bërë në vazhdim për të qenë në hap me zhvillimet e mëtejshme në legjislacionin doganor të BE-së, në veçanti aktet që zbatojnë Kodin Doganor të Unionit. Vendosja e tarifave të skanimit për deklaratat doganore vazhdon të shkelë Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit, e cila ndalon detyrimet doganore ose tarifatat me efekt të barabartë në tregtinë midis BE-së dhe Shqipërisë

dhe nuk është në përputhje me Kodin Doganor të Unionit (UCC). Plani i Zbatimit 2024-2025 i Strategjisë së Biznesit (2023-27) të Administratës Doganore Shqiptare u miratua për të adresuar aktivitetet e Institucionit për periudhën 2025-2026, duke u përqendruar në dixhitalizimin, lehtësimin e tregtisë dhe mbrojtjen e interesave financiare.

Puna përgatitore për zhvillimin e një Sporteli të Vetëm Kombëtar dhe përgatitjet për t'u bashkuar me Konventën e Tranzitit të Përbashkët janë duke vazhduar. Është hartuar një ndryshim në legjislacion dhe është nënshkruar një kontratë për të punuar mbi zgjidhjet teknike për zbatimin e Sistemit të Ri të Kompjuterizuar të Tranzitit (NCTS) në nivel kombëtar. Kërkesa për të siguruar lidhjen CCN/CSI është bërë, e cila është kushti kryesor për t'u lidhur me domenin e përbashkët dhe aplikacionet qendrore të BE-së për NCTS.

Shqipëria po zbaton programin e saj të operatorit ekonomik të autorizuar (AEO), me 18 AEO deri në fund të vitit 2024 dhe aplikime të mëtejshme në shqyrtim. Aktivitetet e ndërgjegjësimit mbi përfitimet e programit vazhduan. Marrëveshjet e nënshkruara me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut mbi njohjen reciproke të AEOS (sigurisë dhe mbrojtjes) mund të zbatohen.

Si pjesë e përpjekjeve kundër mashtrimit, Shqipëria duhet të forcojë luftimin e mashtrimit doganor, në veçanti kontrabandën e produkteve të duhanit dhe duke bashkëpunuar me Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Vendi ende nuk është anëtarësuar në Konventën Kornizë të OBSH-së mbi protokollin e kontrollit të duhanit për të eliminuar tregtinë e paligjshme të produkteve të duhanit.

Procedurat e Menaxhimit të Riskut në fuqi janë në përputhje me UCC dhe përdorin teknika elektronike të përpunimit të të dhënave. Një modul i dedikuar i selektivitetit të riskut (dhe një mjedis i automatizuar që mundëson një selektivitet të bazuar në risk) është integruar me sistemin e zhdoganimit. Module të reja janë planifikuar të zbatohen/përmirësohen në Modulin e Selektivitetit. Përmirësimi i aktit të inspektimit ka përfunduar dhe puna është duke vazhduar në modulin e informacionit para mbërritjes. Rregullat kombëtare për paratë e gatshme dhe mallrat e transportuara në bagazhet e udhëtarëve ende ndryshojnë nga acquis e BE-së dhe duhet të harmonizohen. Administrata Doganore Shqiptare mund të vendosë sanksione për mosdeklarime ose deklarime të gabuara të parave të gatshme në kufi.

Lidhur me **kapacitetin administrativ dhe operacional**, Administrata Doganore Shqiptare (ADSH) raporton 973 punonjës dhe 101 vende të lira pune. Pas ratifikimit të Marrëveshjes për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Programin Doganor të BE-së në qershor 2025, doganat shqiptare mund të marrin pjesë në Program. Shqipëria gjithashtu merr pjesë në forume të ndryshme në Organizatën Botërore të Doganave. Disa aktivitete trajnimi, bazuar në kalendarin vjetor të trajnimit të miratuar, u zhvilluan në bashkëpunim me Qendrën e Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore. Shqipëria duhet të harmonizohet më tej në fushën e sistemeve të IT-së në funksion dhe lidhjen e tyre të ardhshme me mjedisin elektronik doganor të BE-së. Një numër investimesh në shkallë të gjerë janë duke u zhvilluar, planifikuar ose finalizuar, duke përfshirë NTCS dhe Single Window, sistemin e integruar të menaxhimit të tarifave dhe përmirësimet e sistemeve të menaxhimit dhe vlerësimit të riskut të doganave. Për të përballuar të gjitha investimet dhe për të përmirësuar, ekziston nevoja për të përmirësuar burimet njerëzore dhe kapacitetet. Një strategji dhe një plan veprimi i IT-së janë thelbësore. Po bëhen

gjithashtu përpjekje për të rritur aksesin dixhital në shërbimet doganore dhe ADSH raporton se 47 shërbime doganore janë të disponueshme përmes portalit e-Albania. Një sistem informacioni dhe menaxhimi laboratorik (LIMS) është në vend, por ka nevojë për fonde për përmirësime.

Për sa i përket **parandalimit të korrupsionit**, është ngritur një departament për antikorrupsionin dhe etikën, i ngarkuar me përpunimin e rasteve dhe ankesave të pranuar. Kodi i Etikës përcakton rregullat dhe parimet e sjelljes që duhet të ndjekin të gjithë punonjësit e administratës doganore. Administrata Doganore Shqiptare po përgatit aktualisht një plan veprimi që synon forcimin e integritetit dhe promovimin e standardeve të larta të etikës dhe transparencës brenda administratës doganore.

GRUPKAPITULLI 5 “BURIMET, BUJQËSIA DHE KOHEZIONI”

Ky grupkapitull përfshin: bujqësinë dhe zhvillimin rural (Kapitulli 11); sigurinë ushqimore, politikën veterinarë dhe fitosanitare (Kapitulli 12); peshkimin dhe akuakulturën (Kapitulli 13); politikën rajonale dhe koordinimin e instrumenteve strukturore (Kapitulli 22); si dhe dispozitat financiare dhe buxhetore (Kapitulli 33).

Kapitulli 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural

Politika e përbashkët bujqësore e BE-së mbështet fermerët dhe mundëson sigurinë ushqimore të Evropës. Ajo ndihmon në përbalimin e ndryshimeve klimatike dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve kombëtare; mirëmban zonat rurale dhe peizazhet në të gjithë BE-në; dhe mban gjallë ekonominë rurale duke promovuar vende pune në bujqësi, industri agro-ushqimore dhe në sektorë të tjerë në këtë fushë. Për këtë qëllim nevojiten sisteme të forta të menaxhimit dhe kontrollit. Gjithashtu ka rregulla të përbashkëta të BE-së për standardet e marketingut, politikën e cilësisë dhe bujqësinë organike.

Në lidhje me **çështjet horizontale**, Shqipëria duhet të përmirësojë kapacitetet e saj institucionale dhe të harmonizojë sistemet e saj të menaxhimit dhe kontrollit financiar me ato të politikës së përbashkët bujqësore (CAP). Gjatë periudhës së raportimit, nuk është bërë përparim në zhvillimin e sistemit të integruar të administrimit dhe kontrollit (IACS). Regjistri i fermave mbetet për tu përafruar plotësisht me *acquis* të BE-së. Duhet të krijohet sistemi i identifikimit të parcelave të tokës (LPIS). Nuk ka patur progres në futjen e kërkesave të kushtëzimit për pagesat direkte.

Krijimi i një rrjeti të të dhënave të qëndrueshmërinë së fermave (FSDN) duhet të avancojë, duke përfshirë të dhëna mjedisore dhe sociale në përputhje me *acquis* të BE-së. Zbatimi i planit strategjik të veprimit për reformën e sistemit këshillimor duhet të përshpejtohet pasi kapacitetet mbeten të ulëta.

Sa i përket **organizimit të përbashkët të tregut (CMO)**, në Nëntor 2024 u miratua legjislacioni zbatues për klasifikimin e varieteteve të rrushit të përdorur për prodhimin e verës dhe për përcaktimin e detyrave të institucioneve përgjegjëse, i cili është pjesërisht i përafruar me *acquis*. Nevojiten përpjekje të mëtejshme në këtë fushë për të forcuar kapacitetet e kufizuara institucionale për zbatim.

Sa i takon **zhvillimit rural**, nevojiten kapacitete të shtuara dhe mbikëqyrje për besimin e zbatimit të detyrave dhe për zbatimin efikas të *IPARD III*, në përputhje të plotë me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është bërë asnjë përparim në përafrimin e legjislacionit mbi **politikën e cilësisë** me *acquis* të BE-së.

Mbi **bujqësinë organike**, në Tetor 2024, u miratua legjislacioni për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre, duke u përafruar më tej me *acquis* të BE-së. Duhet të sigurohet zbatimi i duhur i tij.

Mbi **luftën kundër korrupsionit**, organet *IPARD* janë të detyruara të parandalojnë, zbulojnë dhe raportojnë parregullsitë.

Kapitulli 12: Politikat e sigurisë ushqimore, veterinare dhe fitosanitare

Legjislacioni i BE-së për ushqimin, përfshirë rregullat e higjienës për prodhimin e produkteve ushqimore, garanton një nivel të lartë të sigurisë së ushqimit dhe ushqimit për kafshë, si dhe një nivel të lartë mbrojtjeje të interesave të konsumatorëve. Shëndeti dhe mirëqenia e kafshëve dhe siguria e ushqimeve me origjinë shtazore mbikqyren së bashku me cilësinë e farërave, materialit riprodhues bimor, mbrojtjen nga organizmat e dëmshëm, ushqyerjen e kafshëve dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Në lidhje me **sigurinë ushqimore të përgjithshme**, kuadri ligjor mbetet pjesërisht i përafëruar me Rregulloren e Përgjithshme të BE-së për Ushqimin. Legjislacioni për kontrollet zyrtare ende duhet të përafërohet me Rregulloren për Kontrollet Zyrtare (OCR). Autoritetet kompetente duhet të shtojnë përpjekjet për zbatimin e legjislacionit dhe menaxhimin e riskut lidhur me vënien në treg të ushqimit/ushqimit për kafshë. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) duhet të forcojë fokusin mbi statistikën e inspektimeve, menaxhimin e të dhënave dhe transparencën. Parimi i transparencës duhet të aplikohet në sistemet e kontrolleve zyrtare në përputhje me OCR. Burime të mjaftueshme administrative dhe financiare mbeten të nevojshme për të mbështetur kryerjen e kontrolleve zyrtare, përfshirë mbledhjen transparente të tarifave. Shqipëria ende nuk ka përgatitur një plan kombëtar shumëvjeçar të kontrolleve.

Sa i përket rrjetit të laboratorëve zyrtarë, duhet të vendosen metoda shqyrtimi të validuara për të garantuar besueshmërinë e rezultateve për speciet dhe produktet përkatëse, dhe nevojiten përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar zhvillimin e kapaciteteve, akreditimin dhe validimin e metodave. Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme të dedikuara për kontrollet kufitare, që ato të kryhen në përputhje me standardet e BE-së.

Mbi **politikën veterinare**, Ligji për Shëndetin e Kafshëve u miratua në Qershor 2025, por zbatimi i tij do të nisë vetëm dy vjet pas miratimit. Shqipëria ka vendosur elementet kryesore për shërbimet veterinare bazuar në legjislacionin aktual kombëtar. Reforma e sektorit veterinar mbetet e papërfunduar, me mungesë të burimeve njerëzore në nivel qendror dhe vendor. Kërkohen përpjekje të konsiderueshme për ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për mbikqyrjen pasive dhe aktive.

Shqipëria nuk ka vijuar fushatat e vaksinimit kundër tërbimit. Duhet të merren masa të nevojshme për të harmonizuar veprimet me qasjen rajonale për kontrollin dhe çrrënjosjen e tërbimit. Shqipëria ka vazhduar zbatimin e programeve për monitorimin e brucelozës dhe tuberkulozit në tufat e bagëtive. Ndërkohë vazhdoi verifikimi dhe regjistrimi në gjithë vendin i numrit të kafshëve, kërkohet ende shumë punë për të përditësuar regjistrin e kafshëve me informacion shtesë për speciet e tjera, siç parashikohet në *acquis* të BE-së, për të siguruar vendosjen e sistemeve të plota të gjurmueshmërisë për produktet me origjinë shtazore.

Shqipëria u përafërua më tej me *acquis* të BE-së për mirëqenien e kafshëve, me miratimin e dy akteve nënligjore në Korrik 2025 për mbrojtjen e kafshëve në fermë, gjatë transportit dhe në momentin e therjes. Nevojiten përpjekje për të siguruar zbatimin e duhur të tyre, përfshirë kapacitete të mjaftueshme administrative për zbatimin si dhe vendosjen e certifikatave dhe miratimeve të kërkuara nga legjislacioni.

Sa i përket **hedhjes në treg të ushqimeve, ushqimit për kafshë dhe nënprodukteve shtazore**, Shqipëria ka një nivel të ulët përafërimi me *acquis* të BE-së. Shqipëria zbatoi planin kombëtar

të monitorimit të mbetjeve, por planet e referuara të monitorimit të mbetjeve nuk janë plotësisht gjithëpërfshirëse. Nuk ka pasur progress në bazën ligjore për nënproduktet shtazore (ABPs) dhe ende nuk është vendosur një sistem i përafuar me BE-në për mbledhjen, ruajtjen dhe përpunimin e tyre.

Mbi **rregullat e sigurisë ushqimore**, Shqipëria ka vazhduar përafrimin e pjesshëm me *acquis* për aditivët ushqimorë dhe përcaktimin e niveleve maksimale për disa kontaminantë në ushqime. Sa i përket mbetjeve të pesticideve, Shqipëria duhet të përmirësojë zbatimin e masave në rast të mosrespektimit dhe të rrisë transparencën. Nuk është bërë përparim në zhvillimin e një programi kombëtar për përmirësimin e cilësisë së qumështit. Sa i përket **rregullave specifike për ushqimin e kafshëve**, Shqipëria nuk ka bërë përparim në përafrimin e legjislacionit me *acquis* të BE-së.

Mbi **politikën fitosanitare**, Ligji për Shëndetin e Bimëve u miratua në Qershor 2025, por do të zbatohet vetëm dy vjet pas miratimit. Shqipëria miratoi planin shumëvjeçar të monitorimit të organizmave të dëmshëm 2025-2028. Veprime të tjera, veçanërisht ato që lidhen me zbulimin dhe çrrënjosjen e organizmave të dëmshëm, ende duhet të zbatohen.

Gjatë periudhës së raportimit nuk është bërë asnjë përparim mbi **organizmat e modifikuar gjenetikisht**.

Kapitulli 13: Peshkimi dhe akuakultura

Politika e përbashkët e peshkimit përcakton rregulla për menaxhimin e peshkimit, mbron gjallesat e detit dhe kufizon ndikimin mjedisor të peshkimit. Kjo përfshin përcaktimin e kuotave të kapjes, menaxhimin e kapaciteteve të flotës, rregullat për kontrollin dhe inspektimin, rregullat për tregjet dhe akuakulturën, si dhe mbështetjen për peshkimin dhe komunitetet bregdetare. Më tej, ajo promovon akuakulturën e qëndrueshme.

Sa i përket **menaxhimit të burimeve dhe flotës**, si dhe **masave strukturore**, regjistri i anijeve vazhdoi të përmirësohet, dhe të dhënat e prodhimit të peshkimit mirëmbahen dhe përditësohen rregullisht. Ekziston një nivel i avancuar i përafrimit me *acquis* të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për përafrimin në mbledhjen e të dhënave, veçanërisht sa i takon raportimit mbi peshkaqenët, ngjalën, mbledhjen e të dhënave biologjike, peshkimin rekreativ dhe planet e hedhjeve ('*discard plans*'). Shqipëria vazhdon të jetë në përputhje me rekomandimet e *GFCM* për shfrytëzimin e qëndrueshëm të stokut të peshkut. Nuk ka përparim në lidhje me peshkimin në shkallë të vogël.

Kapaciteti i **inspektimit dhe kontrollit** për të monitoruar aktivitetin e peshkimit 24/7, në mënyrë që të luftohet peshkimi i paligjshëm, i parregulluar dhe i paraportuar (*IUU*), është forcuar, bazuar në një sistem funksional dhe operativ të monitorimit të anijeve (*VSM*). Sistemi elektronik i inspektimit online siguron një procedurë transparente, regjistrim të sigurt të të dhënave dhe transmetimin e tyre te autoritetet përgjegjëse.

Kapaciteti për interpretimin dhe zbatimin e legjislacionit kombëtar në këtë fushë, ose të politikës së përbashkët të peshkimit të BE-së, dhe mbledhjen e të dhënave, duhet të përmirësohet më tej, veçanërisht sa i përket kapacitetit shkencor dhe menaxhimit të të dhënave.

Sa i përket **politikës së tregut**, legjislacioni që lidhet me planet e tregut mbetet për t'u përafuar plotësisht. Sa i takon **ndihmës shtetërore**, nuk është vënë në dispozicion asnjë mbështetje në

kuadër të skemës kombëtare të mbështetjes, si një masë e veçantë financimi për sektorin e peshkimit.

Sa i përket **akuakulturës**, u zbatua një procedurë konkurruese publike për Vlorën dhe Shëngjinin, bazuar në planet e miratuara për zonat e përcaktuara për akuakulturë (Shëngjin, Durrës, Sarandë dhe Vlorë).

Sa i përket **marrëveshjeve ndërkombëtare** për menaxhimin e peshkimit dhe akuakulturës, Shqipëria ka zbatuar plotësisht rekomandimet e *GFCM* për kontrollin e peshkimit dhe është konfirmuar në Kategorinë e Pajtushmërisë 1. Shqipëria duhet të vazhdojë të marrë pjesë aktivisht dhe të zbatojë rekomandimet e *GFCM*.

Sa i takon ekonomisë më të gjerë detare, Shqipëria inkurajohet të promovojë bashkëpunimin rajonal detar me vendet partnere në Detin Adriatik-Jon.

Mbi **planifikimin hapësinor detar**, një Vendim i Këshillit të Ministrave u rishikua në Nëntor 2024. Shqipëria duhet të vazhdojë të zhvillojë Planin e saj Kombëtar të Planifikimit Hapësinor Detar.

Mbi **luftën kundër korrupsionit**, Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit synon të sigurojë llogaridhënie dhe qeverisje etike, përfshirë sektorin e peshkimit. Shqipëria ka ndërmarrë hapa konkretë në luftën kundër korrupsionit në sektorin e peshkimit duke u fokusuar në transparencën, mjetet digjitale dhe etika. Kjo përfshin përdorimin e sistemeve online për licencat dhe inspektimet, zbatimin e Planeve të Integritetit në Drejtorinë e Peshkimit, dhe kryerjen e auditimeve të rregullta të brendshme dhe të jashtme.

Kapitulli 22: Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore

Politika rajonale është mjeti kryesor i BE-së për reduktimin e pabarazive rajonale dhe investimin në rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse socio-ekonomike. Ajo funksionon përmes “menaxhimit të përbashkët” ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare të BE-së. Zbatimi i programeve të politikës së kohezionit kërkon kapacitete të përshtatshme administrative në nivel programi dhe projekti, ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit financiar të shëndoshë dhe gjithashtu përmbushjen e elementeve të tjera të acquis të BE-së si legjislacioni mjedisor ose i prokurimit publik.

Sa i përket **kuadrit legjislativ**, Shqipëria ka arritur një përafrim të pjesshëm me legjislacionin dhe politikat e BE-së për zbatimin e duhur të politikës së kohezionit të BE-së. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për ndihmën shtetërore dhe legjislacionin mbi Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (*EIA*) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor (*SEA*), përfshirë përafrimin me *acquis* për ndihmën shtetërore, harmonizimin e plotë me direktivat *SEA* dhe *EIA* dhe përmirësimin e ndjeshëm të kapaciteteve të autoriteteve qendrore dhe lokale. Nevojitet progres i mëtejshëm në përafrimin me *acquis* mbi klasifikimin territorial dhe Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillimin Rajonal dhe Planin e Përgjithshëm Kombëtar Hapësinor pas 2030. Ligji për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Auditimit u ndryshua në Mars 2025 për të përafruar kërkesat e Marrëveshjes Kuadër të Partneritetit Financiar. Marrëveshjet për auditimin e vetëm (single audit) duhet të forcohen në sistemin ligjor dhe duhet të krijohen mekanizma për të siguruar bashkëfinancimin e programeve shumëvjeçare në fushën e planifikimit buxhetor. Këshilli i Ministrave duhet të miratojë një vendim për vendosjen e parimit të partneritetit në

përputhje me Kodin Evropian të Sjelljes për Partneritetin. Sa i përket kuadrit institucional, Ministri i Shtetit për Qeverisjen Vendore u emërua negociator për Kapitullin 22 në Dhjetor 2024, pas një periudhe disa mujore boshllëku. Performanca e autoriteteve menaxhuese përgjegjëse për Programet Operacionale (OP) dhe programet e bashkëpunimit Interreg mbetet e rrezikuar për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme administrative dhe teknike, angazhimit të kufizuar të palëve të interesuara, përvojës së kufizuar në zbatimin e programeve, menaxhimit financiar dhe kontrollit nën menaxhimin e përbashkët dhe menaxhimin indirekt nga vendi përfitues (IMBC), mungesës së sistemeve të duhura IT për monitorimin dhe raportimin e aktiviteteve si dhe nivelit të lartë të rotacionit të stafit. Përgjegjësitë në të gjitha nivelet operacionale duhet të përcaktohen qartë, duhet të garantohej ndarja e autorizimit, kontrollit dhe kontabilitetit për angazhimet dhe pagesat, si dhe ekzekutimi i pagesave, dhe funksionet ndërmjet Autoritetit(ve) Menaxhues, strukturave ndërmjetëse dhe Autoritetit të Auditimit duhet të jenë të ndara në mënyrë adekuate. Duhet ti kushtohet vëmendje e veçantë pavarësisë së Autoritetit të Auditimit. Grupi i Punës për Kapitullin 22 është mbledhur katër herë që nga Shtatori 2024.

Mbi **kapacitetet administrative**, forcimi i burimeve njerëzore mbetet një nevojë thelbësore së bashku me një politikë adekuate të mbajtjes së stafit. Mungesa e stafit në Agjencinë Shtetërore për Programimin Strategjik dhe Koordinimin e Ndihmës (SASPAC), si Autoriteti Kombëtar për Bashkëpunimin Ndërkufitar (CBC) dhe programet Interreg, kërkon vëmendje të menjëherëshme. Autoritetet menaxhuese dhe institucionet zbatuese duhet të adresojnë mungesën e stafit, politikën për mbajtjen e tij dhe kapacitetet për të siguruar zbatimin në kohë dhe efektiv të projekteve si dhe përputhshmërinë e duhur me ndarjen e kërkuar të funksioneve dhe detyrave. Nevojiten kapacitete të mtejshme institucionale si në nivel qendror ashtu edhe lokal që lidhen me përgatitjen e projekteve, vlerësimin dhe procesin e përzgjedhjes. Sa i përket **programimit**, procedurat e menaxhimit të investimeve publike janë forcuar përmes ndryshimeve të bëra në vitet 2024 dhe 2025. Lista Unike e Projekteve me Rëndësi Kombëtare (NSPP) përditësohet rregullisht dhe kategorizon projektet sipas nivelit të maturitetit të tyre, por nuk përfshin projektet e drejtuara nga bashkitë. Nevojiten kapacitete të mtejshme institucionale si në nivel qendror ashtu edhe lokal për përgatitjen e projekteve, vlerësimin dhe procesin e përzgjedhjes së tyre. Shqipëria duhet të zgjidhë çdo çështje që lidhet me sigurimin e bashkëfinancimit. Politika kombëtare për zhvillimin rajonal, e cila synon të mbështesë zhvillimin territorial dhe integrimin në politikat sektoriale kombëtare, duhet të finalizohet. Vonesat në miratimin e Marrëveshjes së Financimit për IPA 2024 dhe tre Programeve Operacionale rrezikojnë zbatimin e tyre në kohë. Procedurat e gjata për ndryshimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar (CBC) rrezikojnë të vonojnë bashkëpunimin me vendet fqinje dhe përdorimin efektiv të fondeve të BE-së. Nevojiten ndryshime në proceset e miratimit dhe nënshkrimit të marrëveshjeve dhe ndryshimeve për të përshpejtuar procesin. Shqipëria duhet të demonstrojë zbatim efikas të parimit të partneritetit.

Mbi **monitorimin dhe vlerësimin**, kapacitetet administrative janë përmirësuar, por kërkojnë forcim të mtejshëm. Komitetet e rregullta sektoriale dhe të monitorimit të IPA-s diskutojnë progresin e programeve të para-anëtarësimit të BE-së. Sistemet e monitorimit dhe vlerësimit kombëtar duhet të përmirësohen për t'u përafruar me kërkesat e politikës së kohezionit. Sa i përket bashkëpunimit territorial, roli monitorues i Autoritetit Kombëtar duhet të forcohet.

Sa i takon menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit, Ligji për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës, e akredituar nga BE-ja u ndryshua në Mars 2025 për të qartësuar përgjegjësitë e menaxhimit. Kapacitetet e menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm në kuadër të programeve operacionale (OP) të IPA III

duhet të forcohen. Shqipëria duhet të përmirësojë historikun e saj në ndjekjen e rekomandimeve të auditimit. Kapacitetet e stafit në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit janë përmirësuar, por kërkojnë forcim të mëtejshëm. Nevojitet bashkëpunim më i fortë ndërinstitucional për përgatitjen dhe zbatimin e reformave ligjore për fondet pas-anëtarësimit, në kuadër të strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike (PFM) 2023-2030 dhe planit të veprimit 2023-2026. Shqipëria duhet të miratojë ligjin për kontabilitetin publik në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik.

Mbi **luftën kundër korrupsionit**, masat kundër korrupsionit dhe mashtrimit duhet të zbatohen në mënyrë efektive, në përputhje me Strategjinë e re Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (ISAC) 2024-2030 dhe Strategjinë Kombëtare Kundër Mashtrimit 2025-2027. Kërkohej një koordinim më i ngushtë me Ministrin e Shtetit për Administratën Publike dhe Anti-Korrupsionin, Ministrinë e Financave dhe SASPAC.

Sa i përket **vizibilitetit, transparencës, dhe komunikimit**, faqja e vetme zyrtare për komunikimin mbi programet e mbështetura nga fondet e BE-së, nën Zyrën e Koordinatorit Kombëtar të IPA-s (NIPAC) dhe SASPAC është online që nga Shtatori 2025. Kërkohej një angazhim më aktiv i koordinatorit kombëtar të komunikimit në rrjetet InformEU dhe Interreg Communication Officers Network (ICON).

Kapitulli 33: Dispozitat financiare dhe buxhetore

Ky kapitull mbulon rregullat që drejtojnë financimet nga buxheti i BE-së ("burimet e veta"). Këto burime përbëhen kryesisht nga: (i) kontribute të bazuara në të ardhurat kombëtare bruto të çdo Shteti Anëtar; (ii) detyrime doganore; (iii) burimi nga plastika jo e ricikluar dhe (iv) një burim i bazuar në tatimin mbi vlerën e shtuar. Shtetet Anëtare duhet të kenë kapacitet të përshtatshëm administrativ për të koordinuar dhe siguruar llogaritjen, mbledhjen, pagesën dhe kontrollin e duhur të burimeve të veta.

Ka pasur disa përparime në fushat e politikave bazë që ndikojnë indirekt në sistemin e burimeve të veta (për përparimin në këto fusha, shih Kapitujt 16 – Tatimet, 17 – Politika ekonomike dhe monetare, 18 – Statistikat, 29 – Bashkimi doganor dhe 32 – Kontrolli financiar).

Mbi **burimet tradicionale të veta**, Shqipëria nisi zbatimin e Ligjit të ri për tatimin mbi të ardhurat, i cili hyri në fuqi në vitin 2024. Shqipëria ka në fuqi Strategjinë Afatmesme të të Ardhurave (MTRS) 2024-2027 dhe Strategjinë e menaxhimit të financave publike 2024-2027. Zbatimi i strategjisë MTRS përfshin masa reforme si në rishikimin e politikave fiskale ashtu edhe në rritjen e efikasitetit të administratave tatimore dhe doganore. Objektivi i MTRS është rritja shtesë e të ardhurave me 1.8% të PBB-së deri në fund të vitit 2027. Shqipëria përfundoi vlerësimin e të gjitha përjashtimeve tatimore në Qershor 2025. Kjo duhet të pasohet me veprime konkrete për fillimin e heqjes së disa përjashtimeve të identifikuara. Si rezultat i monitorimit gjatëmuor të zbatimit të MTRS-së, Shqipëria konstatoi përparime në fushën e faturimit elektronik dhe shkëmbimit të të dhënave me institucione të tjera për identifikimin e tatimpaguesve me rrezik të lartë.

Nuk ka zhvillime të reja ligjore drejt përafrimit të mëtejshëm me acquis të BE-së. Përjashtimet tatimore mbeten shqetësim për mobilizimin e të ardhurave në nivel qendror dhe lokal, përfshirë përjashtimet e fundit të dhëna për bizneset që investojnë në zonat malore dhe në hotelet me 5 yje. Ka pasur përparim të mirë në përsheptimin e rimbursimit të TVSH-së për bizneset.

Udhëzimet e reja për procedurat e rimbursimit të TVSH-së për OJF-të që operojnë me grantet e BE-së nën *IPA* kërkojnë zbatim efektiv.

Sa i përket **burimit të të ardhurave kombëtare bruto (GNI)**, Instituti i Statistikave (INSTAT) vazhdoi transmetimin e rregullt të të dhënave *GNI* dhe *PBB* në Eurostat, sipas programit të transmetimit *ESA* 2010. INSTAT publikoi setin e parë të plotë të llogarive vjetore sektoriale të Shqipërisë për vitet 2018-2023 në Mars 2025, i zgjeroi ato edhe për vitet 2013-2017 dhe vazhdoi përpjekjet për përmirësimin e raportimit të statistikave financiare të qeverisë (GFS) dhe procedurës së deficitit të tepruar (*EDP*). Janë nisur përgatitjet për hartimin e inventarit të *GNI* të Shqipërisë në përputhje me udhëzuesin e inventarit të *GNI*.

Mbi **infrastrukturën administrative**, nevojitet përparim në krijimin e institucioneve përkatëse të përfshira në sistemin e burimeve të veta dhe organit koordinues, si dhe në zbatimin e rregullave, në përputhje me *acquis* të BE-së.

Dispozitat ligjore që përcaktojnë kriteret për nisjen e inspektimeve financiare publike në rastet e parregullsive apo keqmenaxhimit serioz financiar janë në fuqi. Drejtoria e përgjithshme e tatimeve dhe drejtoria e përgjithshme e doganave vazhduan punën për identifikimin e evazionit tatimor dhe mashtrimit. (Shih gjithashtu Kapitujt 1, 16, 29 dhe 32 për veprimet kundër korrupsionit). Nevojiten përpjekje të vazhdueshme për të formalizuar ekonominë e gjerë informale, për të përmirësuar plotësinë e llogarive kombëtare dhe llogaritjet e *PBB/GNI* dhe për të luftuar evazionin fiskal dhe mashtrimin me detyrimet doganore.

GRUPKAPITULLI 6: MARRËDHËNIET ME JASHTË

Në këtë grupkapitull ka dy kapituj: marrëdhëniet me jashtë (Kapitulli 30) dhe politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes (Kapitulli 31).

Kapitulli 30: Marrëdhëniet me jashtë

BE-ja ka një politikë të përbashkët tregtare ndaj vendeve jo-anëtare të BE-së, e bazuar në marrëveshje shumëpalëshe dhe dypalëshe, si dhe masat autonome. Ekzistojnë gjithashtu rregulla të BE-së në fushën e ndihmës humanitare dhe politikës së zhvillimit.

Sa i takon **politikës së përbashkët tregtare**, Shqipëria ka vijuar të koordinojë qëndrimet e saj dhe të përafrojë politikat e saj ngushtësisht me ato të BE-së, përfshirë edhe me Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT) dhe me Organin e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve. Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria intensifikoi përgatitjet për anëtarësim në Marrëveshjen për Prokurimet Publike (GPA) të OBT-së dhe në Dhjetor 2024 paraqiti pranë organit përkatës ofertën ekonomike për mbulimin e tregut të prokurimeve.

Në fushën e bashkëpunimit rajonal, Shqipëria vazhdoi rolin e saj konstruktiv në negociatat për çështjet e CEFTA-s sipas protokolleve gjashtë dhe shtatë dhe punoi për zbatimin e planit të veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal. Në janar 2025 Shqipëria miratoi parimisht protokollin shtatë të CEFTA-s për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në Shkurt 2025, Shqipëria ratifikoi vendimin e komitetit të përbashkët të Konventës Pan-Euro-Mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës lidhur me përdorimin e certifikatave elektronike.

Në fushën e **mallrave me përdorim të dyfishtë**, kontrolli i eksporteve të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve me përdorim të dyfishtë zbatohet në përputhje me Ligjin e vitit 2018, i cili aktualisht po ndryshohet. Pavarësisht ndryshimeve, Shqipëria ende nuk ka arritur përafrim të plotë me *legjislacionin* përkatës të BE-së. Shqipëria gjithashtu nuk është përafruar ende me legjislacionin e BE-së për shqyrtimin e investimeve të huaja direkte (FDI). Në këtë drejtim, Ligji për investimet e huaja u ndryshua në Korrik, duke i mundësuar qeverisë të punojë për dispozita që do të garantonin mekanizmat e shqyrtimit të FDI-ve.

Që nga Qershori 2025, Shqipëria është konfirmuar si pjesëmarrëse e njëanshme në Grupin Australian. Në lidhje me **marrëveshjet dypalëshe me vendet e treta**, Shqipëria ka 40 traktate dypalëshe investimesh në fuqi, 22 prej të cilave me Shtete Anëtare të BE-së. Vendi ka gjithashtu pesë marrëveshje të tregtisë së lirë në fuqi (me BE-në, MSA, CEFTA-n, EFTA-n, me Turqinë dhe me Mbretërinë e Bashkuar). Në Qershor 2024 hyri në fuqi marrëveshja dypalëshe e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Shqipërisë dhe Azerbajxhanit.

Korniza rregullatore për bashkëpunimin ndërkombëtar në **politikën e zhvillimit dhe ndihmën humanitare** mbetet për t'u zhvilluar.

Kapitulli 31: Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes

Shtetet anëtare duhet të jenë në gjendje të zhvillojnë dialog politik nën politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes të BE-së, të jenë në linjë me deklaratat e BE-së, të marrin pjesë në veprimet e BE-së dhe të zbatojnë sanksionet dhe masat kufizuese të dakorduara.

Shqipëria ka vijuar të angazhohet në mënyrë aktive në **dialogun politik** me BE-në mbi çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë. Në Dhjetor 2024, Shqipëria nënshkroi një Marrëveshje Partneriteti për Sigurinë dhe Mbrojtjen me BE-në, duke krijuar një platformë për dialog të zgjeruar mbi sigurinë dhe mbrojtjen. Në Prill 2025, u mbajt në Tiranë seanca e parë e Dialogut për Sigurinë dhe Mbrojtjen BE-Shqipëri. Në Prill 2025, Shqipëria mori pjesë në takimin e njëmbëdhjetë të Drejtorëve Politikë të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor mbi politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Korniza institucionale që mundëson pjesëmarrjen e Shqipërisë në **politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së** është në vend dhe funksionale. Shqipëria ka vazhduar të ruajë përputhshmërinë e plotë me deklaratat e Përfaqësuesit të Lartë në emër të BE-së dhe Vendimet e Këshillit mbi sanksionet, duke përfshirë të gjitha masat kufizuese të BE-së kundër Rusisë dhe Bjellorusisë në lidhje me luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës. Në Shkurt 2025, Shqipëria votoi në favor të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së “Përparimi drejt një paqeje gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe të qëndrueshme në Ukrainë”, duke shënuar trevjetorin e pushtimit në shkallë të gjerë të Ukrainës nga Rusia.

Shqipëria ka të vendosura rregullime ligjore dhe institucionale për të trajtuar zbatimin e **masave kufizuese** të BE-së me të cilat është përafruar. Megjithatë, kapaciteti i Shqipërisë për zbatimin teknik dhe për forcimin e masave komplekse kufizuese të BE-së duhet të forcohet më tej.

Bashkëpunimi aktiv i Shqipërisë me **organizatat ndërkombëtare** ka vijuar. Shqipëria është anëtare e Këshillit të Drejtave të Njeriut të OKB-së për periudhën 2024-2026 dhe mbajti kryesimin për periudhën 2024-2025 të Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECp). Vendi organizoi samitin e Komunitetit Politik Evropian në Maj 2025 dhe do të organizojë Samitin e NATO-s 2027. Shqipëria gjithashtu ka miratuar Planin e saj të dytë Kombëtar të Veprimit 2023-2027 për Gratë, Paqen dhe Sigurinë.

Një marrëveshje dypalëshe për imunitetin midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara mbetet në fuqi, duke i dhënë qytetarëve amerikanë përjashtime nga juridiksioni i **Gjykatës Ndërkombëtare Penale**. Duke vepruar kështu, ajo nuk përputhet me qëndrimet e përbashkëta të BE-së për integritetin e Statutit të Romës ose me parimet udhëzuese të BE-së mbi marrëveshjet dypalëshe për imunitetin. Kërkohet harmonizimi me pozicionin e BE-së.

Në **parandalimin e konflikteve**, Shqipëria ka vazhduar të mbështesë masat dhe dokumentet e BE-së, përfshirë kontributin në misionet e BE-së si dhe në misionet e OKB-së dhe NATO-s.

Në fushën e **mos-përhapjes**, Shqipëria ka vazhduar të zbatojë strategjinë e saj kombëtare për armët e vogla dhe armët e lehta (SALW) dhe planin përkatës të veprimit 2022-2024, si dhe Udhërrëfyesin Rajonal 2018 dhe format e tjera të bashkëpunimit rajonal për armët e zjarrit. Vendi duhet të përafrojë strategjinë kombëtare SALW me Udhërrëfyesin e Ri Rajonal për Kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta (SALW) 2025-2030 dhe planin e veprimit të BE-së 2020-2025 për trafikun e armëve.

Zbatimi i strategjisë kombëtare 2020 kundër përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë (WMD) dhe planit të saj të veprimit gjithashtu vazhdoi. Një draft i ri i strategjisë kombëtare është përgatitur nga Ministria e Mbrojtjes dhe u dërgua për konsultim me palët e interesuara. Shqipëria është anëtare e Këshillit Ekzekutiv të Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike (WONAK) për periudhën 2024-2026. Në Qershor 2025, Shqipëria dorëzoi një aplikim formal

për t'u bashkuar me Marrëveshjen e Wassenaar-it, megjithatë përfundimi i procesit të anëtarësimit është bllokuar nga një nga shtetet pjesëmarrëse.

Në aspektin e **masave të sigurisë**, Shqipëria vendosi procedurat e nevojshme për të bërë funksional marrëveshjen e sigurisë së informacionit me BE-në.

Shqipëria rriti pjesëmarrjen e saj në misionet dhe operacionet ushtarake të menaxhimit të krizave të BE-së nën **politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes**. Vendi vendosi një togë shtesë në Batalionin Shumëkombësh të *EUFOR Althea* në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe shfaqti gatishmërinë për të kontribuar në Operacionin e Forcës Detare të *ASPIDES* të Bashkimit Evropian për sigurinë detare në Detin e Kuq, Oqeanin Indian dhe Gjirin. Vendi vazhdon të marrë pjesë me një njësi të madhësisë së një kompanie të lehtë në Kuadrin e Grupit Luftarak të BE-së. Për më tepër, Shqipëria kontribuon në bashkëpunimin rajonal në mjekësinë ushtarake përmes Task Forcës Mjekësore Ballkanike.

Në lidhje me **kërcënimet hibride**, Shqipëria ka një strategji kombëtare sigurie, me fokus të fortë në avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve për mbrojtje nga kërcënimet hibride. Një Strategji e re Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2025-2030 dhe plani i saj i veprimit 2025-2027 janë miratuar (shih Kapitulli 10 – Transformimi digjital dhe mediat). Në Qershor 2024, Shqipëria iu bashkua Qendrës Evropiane të Ekselencës për Kundërveprim ndaj Kërcënimeve Hibride (*Hybrid CoE*) me bazë në Helsinki. Shqipëria është përafruar me deklaratën e BE-së të Korrikut 2025 që dënon fushatat hibride të Rusisë kundër BE-së dhe partnerëve të saj. Për më tepër, Shqipëria ka marrë pjesë aktivisht në negociatat në Grupin e Punës të Hapur të OKB-së mbi sigurinë dhe përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Në Korrik 2025, Parlamenti miratoi Strategjinë e parë Kombëtare kundër ndërhyrjeve të huaja dhe dezinformimit. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbyllur hapësirën për ndërhyrje të huaja dhe manipulim informacioni, duke përfshirë dezinformimin, për të ndërtuar rezistencë shoqërore ndaj këtij fenomeni dhe formave të tjera të kërcënimeve hibride.

ANEKSI I – MARRËDHËNIET NDËRMJET BE-SË DHE SHQIPËRISË

Shqipëria është vend kandidat që nga viti 2014. Konferenca e parë ndërqeveritare për **negociatat e anëtarësimit** u mbajt më 19 Korrik 2022, pas miratimit të kuadrit negociues nga Këshilli. Në të njëjtën ditë, Komisioni nisi shqyrtimin analitik të *acquis*-it – procesi i ‘*screening-ut*’ – për të cilin raporti i fundit iu dorëzua Këshillit në Mars 2025. Konferenca ndërqeveritare u thirr për të hapur negociatat e anëtarësimit mbi: grupkapitullin 1 – themeloret (Tetor 2024), grupkapitullin 6 – marrëdhëniet e jashtme (Dhjetor 2024), grupkapitullin 2 – tregu i brendshëm (Prill 2025), grupkapitullin 3 – konkurrueshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse (Maj 2025), dhe grupkapitullin 4 – agjenda e gjelbër dhe lidhja e qëndrueshme (Shtator 2025). Drafti i pozicionit negociues të BE-së për të hapur grupkapitullin 5 – burimet, bujqësia dhe kohezioni është në diskutim në Këshill.

Shqipëria ka marrë pjesë në **procesin e Stabilizimit dhe Asociimit** që nga viti 1999. **Marrëveshja e Stabilizimit dhe Asociimit (MSA)** midis Shqipërisë dhe BE-së hyri në fuqi në Prill 2009. Periudha tranzitore e *SAA*-së përfundoi më 31 Mars 2019, dhe që nga 1 Prilli 2019, Shqipëria është plotësisht e asociuar me BE-në. Gjatë periudhës së raportimit, Shqipëria vazhdoi të zbatojë, në përgjithësi, angazhimet e saj sipas *MSA*-së. Dialogu i rregullt politik dhe ekonomik ka vazhduar përmes organeve të përbashkëta përkatëse të *MSA*-së. Komiteti Parlamentar i Stabilizimit dhe Asociimit u mblodh në Tetor 2024 dhe në Qershor 2025. Takimi i parë i Komitetit Konsultativ të Përbashkët me Komitetin e Këshillit Ekonomik dhe Social Evropian u mbajt në Prill 2025.

MSA-ja dhe Marrëveshja e saj e Përkohshme, e aplikuar që nga viti 2006, kanë mundësuar liberalizim gradual të tregtisë dhe qasje reciproke pa doganw për shumicën e mallrave. Që nga viti 2000, Shqipëria ka përfituar gjithashtu nga “masat autonome tregtare”. BE-ja është partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, e ndjekur nga vendet e CEFTA-s. Integrimi tregtar me BE-në është i lartë. Në vitin 2024, BE-ja mbeti partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, duke përbërë 57.4% të tregtisë totale të mallrave të Shqipërisë (71.7% të eksporteve totale dhe 51.5% të importeve totale). Tregtia totale e Shqipërisë në vitin 2024 ishte me vlerë 12.6 miliardë euro. Deficiti tregtar i vendit me BE-në ishte 1.9 miliardë euro në vitin 2024. Tregtia e Shqipërisë me vendet e CEFTA-s përfaqësoi rreth 9.7% të tregtisë totale në vitin 2024, krahasuar me 10.3% në vitin 2023.

Liberalizimi i vizave për qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në zonën Schengen është në fuqi që nga Dhjetor 2010. Një marrëveshje rikthimi midis BE-së dhe Shqipërisë është në fuqi që nga viti 2006. Raporti i shtatë i Komisionit për vitin 2024 nën mekanizmin e pezullimit të vizave¹¹ arriti nw pwrfundimin se Shqipëria vazhdon të përmbushë kërkesat për liberalizimin e vizave.

Shqipëria ka vazhduar të përafrohet plotësisht me të gjitha qwndrimet dhe deklaratat e BE-së në kuadër të politikës së jashtme dhe të sigurisë gjatë periudhës së raportimit. Shqipëria rriti pjesëmarrjen e saj në misionet dhe operacionet e menaxhimit të krizave të BE-së nën politikën e përbashkët të sigurisë dhe mbrojtjes, veçanërisht *EUFOR Althea* në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Operacionin *ASPIDES* të Forcës Detare të BE-së (*EUNAVFOR*).

Një **Partneritet për Sigurinë dhe Mbrojtjen** midis Shqipërisë dhe BE-së u nënshkrua në Dhjetor 2024 dhe **Dialogu për Sigurinë dhe Mbrojtjen** BE-Shqipëri u lançua në Prill 2025 në Tiranë.

Shqipëria përfiton nga dy masa ndihme dypalwshe nën **Faciliteti Evropian për Paqen (EPF)**, të miratuara përkatësisht në Korrik 2024 dhe Korrik 2025, me një vlerë totale prej 28 milionë eurosh. Qëllimi i mbështetjes së është të forcojë efektivitetin operacional, lëvizshmërinë dhe mbrojtjen e Forcave të Armatosura Shqiptare¹². Njëkohësisht Task Forca Mjekësore Ballkanike , në të cilën Shqipëria merr pjesë, përfiton nga një masë mbështetëse e vitit 2022 nën *EPF*, me vlerë 6 milionë euro.

Nën **Instrumentin për Ndihmë Para-Anëtarësimit 2021 – 2027 (IPA III)**¹³, një vendim i katërt financiar prej 67.35 milionë eurosh për Planin Vjetor të Veprimt 2024 mbështet luftën kundër korrupsionit, qeverisjen lokale dhe zhvillimin ekonomik, sigurinë ushqimore, pyjet, si dhe punësimin dhe përfshirjen sociale. Për më tepër, vendimi i parë financiar prej 130 milionë eurosh për tre programe operative 2024-2027 mbështet përpjekjet në dixhitalizim, avancimin e agjendës së gjelbër të Shqipërisë dhe punësimin e të rinjve. Këto programe plotësohen nga një paketë e konsiderueshme programesh shumëkombëshe. Programi i zhvillimit rural *IPARD* III (kontributi i BE-së 112 milionë euro) nuk ka filluar ende, për shkak të vonesave në procesin e dhënies së kompetencës. Shqipëria gjithashtu merr pjesë në pesë programe bashkëpunimi ndërkufitar, programe bashkëpunimi transnacional dhe programe të BE-së.

Si pjesë e vendimit të ri financiar *IPA* III për vitet 2025-2027 për Ballkanin Perëndimor, të miratuar në Korrik 2025, 100 milionë euro janë alokuar për programe në Shqipëri mbi reformën

¹¹ COM/2024/571 përfundimtare.

¹² Vendimi Këshillit (CFSP) 2024/1979 dhe Vendimi Këshillit (CFSP) 2025/1562.

¹³ Fletorja Zyrtare L 330, 20.9.2021.

e sektorit të drejtësisë dhe të drejtave të njeriut, mbështetjen e sundimit të ligjit, demokracisë dhe qeverisjes së mirë, materialet kritike të papërpunuara dhe procesin e integritetit në BE.

Nën **Facilitetin për Reformë dhe Rritje**, Shqipëria mund të përfitojë nga një alokim indikativ prej 922.1 milionë eurosh, i mbështetur nga një Agjendë Reformash. Shpërndarja e mbështetjes së BE-së është e kushtëzuar nga përmbushja e parakushteve dhe realizimi i reformave të përcaktuara. Shqipërisë i është alokuar shuma prej 64.5 milionë eurosh për financim paraprak me hua nën Facilitetin për Reformë dhe Rritje.

Më 21 Mars 2025, Shqipëria mori 30 milionë euro nga 64.5 milionë eurot si parapagim i 7% të shumës totale të parashikuar nën Facilitetin për Reformë dhe Rritje. Ky financim paraprak u shpërnda në buxhetin e shtetit si mbështetje për zbatimin e reformave të parashikuara nga Agjenda e Reformave, ndërsa 34.4 milionë eurot e mbetura do të injektohen direkt në *WBIF* dhe do të përdoren për projekte infrastrukturore në vend.

Grupi i parë i reformave duhej të përfundonte në Dhjetor 2024, duke përfshirë gjashtëmbëdhjetë hapa, ndërsa afati i dytë ishte Qershor 2025, duke përfshirë njëzet hapa, në të gjitha fushat e politikave të Agjendës së Reformave. Shqipëria gjithashtu parashikoi pesë hapa që duhej të përfundonin në Dhjetor 2025. Në Tetor 2025, Komisioni përfundoi vlerësimin e tij dhe konsideroi 21 nga 41 hapat si të përmbushur. Kjo çoi në shpërndarjen e rreth 99.3 milionë eurove.

Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha agjencitë e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme të BE-së. Shqipëria merr pjesë në dy programe bashkëpunimi transnacionale. Shqipëria merr pjesë me mbështetje *IPA* në këto programe të BE-së: *Erasmus+*, *Creative Europe* (kulturë dhe media), *Horizon Europe* dhe Bashkëpunimi Evropian në Shkencë dhe Teknologji (*COST* – Agjenci e financuar nën *Horizon Europe*), *Customs 2020*, *Fiscalis 2020*, Programi i Tregut të Përbashkët, Programi i Drejtësisë, Programi për Qytetarët, Barazinë, të Drejtat dhe Vlerat (*CERIV*), Agjencia e të Drejtave Themelore e BE-së (*FRA*) (si vëzhgues), programi *Digital Europe*, Mekanizmi i Bashkëpunimit Civil të Unionit, Korpusi Evropian i Solidaritetit (komponenti rinor – vullnetarizëm). Për të përmirësuar qëndrueshmërinë e financave lokale dhe për të përforcuar zbatimin e praktikave efektive të buxhetimit të gjelbër, Shqipëria po merr pjesë si vëzhgues në një projekt pilot nën Instrumentin e Mbështetjes Teknike.

Që nga Maji 2025, **Kuadri i Investimeve për Ballkanin Perëndimor** (*WBIF*) ka mbështetur Shqipërinë me një shumë prej 476 milionë eurosh. Kjo është dhënë në formën e granteve *IPA* III për projekte kryesore në fushat e energjisë së pastër, mjedisit dhe klimës, së ardhmes dixhitale dhe transportit të qëndrueshëm. Shqipëria ka dorëzuar një listë projektsh *WBIF* për t'u financuar nën Facilitetin për Reformë dhe Rritje, duke përfshirë infrastrukturë në energji, transport të qëndrueshëm, zhvillim njerëzor dhe lidhje dixhitale.

BE-ja ofron mbështetje përmes *IPA* dhe Instrumentit të Politikës së Jashtme për të forcuar rezistencën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor ndaj kërcënimeve hibride, përfshirë sulmet kibernetike dhe manipulimin dhe ndërhyrjen e huaj në informacion.

Aneks II –
TË DHËNA STATISTIKORE (nga 11/09/2025)

Të dhëna bazë	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Popullsia (mijë)		2 903 i	2 846 i	2 830 i	2 794 i	2 762 i	2 391 i
Sipërfaqja totale e vendit (km ²)		:	:	28 791 e	28 791 e	28 791 e	28 791 e

Llogaritë kombëtare	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Prodhim i brendshëm bruto (PBB) (milio valutë kombëtare)		1 324 877	1 655 985	1 866 672	2 149 742	2 364 276	2 517 820 p
Prodhim i brendshëm bruto (PBB) (milion euro)		9 529	13 380	15 243	18 068	21 731	25 001 p
PBB për banor (euro)		3 290	4 710	5 420	6 500	7 887 piw	:
PBB për banor (në standarde të fuqisë blerëse – SFB)		7 727	9 270	10 287	12 189	:	:
PBB për banor (në SFB), në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		29.7	30.5 b	31.0	33.9	:	:
Norma reale e rritjes së PBB-së: ndryshimi nga viti i mëparshëm i volumit të PBB-së (%)		1.0	- 3.3	9.0	4.8	4.0	4.0 p
Rritja e punësimit (të dhëna të llogarive kombëtare), në raport me vitin e mëparshëm (%)		:	:	:	:	:	:
Rritja e produktivitetit të punës: rritja e PBB-së (në volum) për person të punësuar, në raport me vitin e mëparshëm (%)		:	:	:	:	:	:
Rritja e kostos njësi të punës, në raport me vitin e mëparshëm (%)		:	:	:	:	:	:
*Ndryshimi 3-vjeçar (T/T-3) në indeksin e rritjes së kostos nominale njësi të punës (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:

Produktiviteti i punës për person të punësuar: PBB (në PPS) për person të punësuar në raport me mesataren e BE-së (BE-27 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e shtuar bruto sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		20.3	21.4	20.8	19.7	18.7	17.9 p
Industria (%)		13.0	12.8	12.8	13.3	13.2	12.1 p
Ndërtimi (%)		16.4	13.8	13.4	13.4	13.4	13.8 p
Shërbimet (%)		50.3 i	51.9 i	52.9 i	53.6 i	54.8 i	56.2 pi
Shpenzimet finale të konsumit, si pjesë e PBB-së (%)		89.0	88.2	84.7	83.5	82.1	81.9 p
Formimi i qëndrueshëm i kapitalit, si pjesë e PBB-së (%)		28.6	25.2	27.2	25.7	24.3	24.4 p
Eksportet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		29.1	22.5	31.1	37.2	38.4	36.3 p
Importet e mallrave dhe shërbimeve, në raport me PBB-në (%)		47.9	37.0	44.5	47.5	43.9	43.2 p
Formimi i qëndrueshëm i kapitalit nga sektori i qeverisjes së përgjithshme, si përqindje e PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:

Biznesi	Shënim	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Indeksi i volumit të prodhimit industrial (2015 = 100)	1)	78.5 w	89.5 w	113.0 w	116.1 w	106.3 w	98.3 w
Numri i ndërmarrjeve aktive (numër)	2)	:	:	104 031	113 460	117 291	:
Shkalla e lindjes së ndërmarrjeve: numri i ndërmarrjeve të reja në periudhën referente (t) pjesëtuar me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		12.0 w	10.8 w	12.9 w	12.9 w	10.8 w	:
Shkalla e mbylljes së ndërmarrjeve: numri i ndërmarrjeve të mbyllura në periudhën referente (t) pjesëtua me numrin e ndërmarrjeve aktive në t (%)		:	:	1.0 w	0.6 w	0.7 w	:
Persona të punësuar në NVM si pjesë e totalit të personave të punësuar (brenda ekonomisë së biznesit jo-financiar) (%)	2) 3)	:	:	81.1	83.5	83.4	:

Vlera e shtuar nga NVM-të (në ekonominë e biznesit jo-financiar) (milion euro)	2)	:	:	4 125 i	5 599 i	6 877 i	:
Vlera totale e shtuar (në ekonominë e biznesit jo-financiar) (milion euro)	2) 3)	:	:	5 424	7 141	8 794	:

Norma e inflacionit dhe çmimet e banesave	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Indeksi i çmimeve të konsumit (IÇK), ndryshimi ndaj vitit të mëparshëm (%)		:	2.2 d	2.3 d	6.6 d	5.3 d	2.6 d

Bilanci i pagesave	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Bilanci i pagesave: llogaria korrente gjithsej (milion euro)		:	- 1 153.3	- 1 166.2	- 1 062.9	- 269.6	- 598.1
Llogaria korrente – bilanci tregtar (milion euro)		:	- 2 982.1	- 3 828.9	- 4 267.8	- 4 539.8	- 5 593.1
Llogaria korrente – bilanci neto i shërbimeve (milion euro)		:	1 056.2	1 795.8	2 400.4	3 351.7	3 875.4
Llogaria korrente – bilanci neto i të ardhurave primare (milion euro)		:	- 227.6	- 211.0	- 314.5	- 277.9	- 182.1
Llogaria korrente – bilanci neto i të ardhurave dytësore (milion euro)		:	997.1	1 077.9	1 118.9	1 196.4	1 301.7
Bilanci neto i të ardhurave primare dhe dytësore: nga të cilat transferime të qeverisë (milion euro)		:	58.2	48.6	31.4	20.3	19.1
*Mesatarja lëvizëse 3-vjeçare e bilancit të llogarisë korrente ndaj PBB-së (%)		:	- 7.7	- 8.0	- 7.4	- 4.9	- 3.2
*Ndryshimi 5-vjeçar në pjesën e eksporteve botërore të mallrave dhe shërbimeve (%)		:	5.5	21.8	24.9	53.8	56.7
Bilanci neto (hyrje – dalje) i investimeve të huaja direkte (IHD) (milion euro)		:	893.6 i	988.8 i	C	1 253.4 i	:

Investimet e huaja direkte (IHD) jashtë vendit (milion euro)		:	76.4	53.3	C	245.2	:
nga të cilat IHD të ekonomisë raportuese në vendet e BE-27 (milion euro)		:	28.5	27.3	C	98.9	:
Investimet e huaja direkte (IHD) në ekonominë raportuese (milion euro)		665.8 w	970.2 w	1 043.3 w	1 361.9 w	1 500.4 w	1 585.0 w
nga të cilat IHD të vendeve BE-27 në ekonominë raportuese (milion euro)		:	535.3	679.8	736.3	912.4	:
*Pozicioni neto i investimit ndërkombëtar, ndaj PBB-së (%)		:	- 53.5	- 50.2	- 47.3	- 42.0	- 40.6
Norma vjetore e ndryshimit të flukseve të bruto-dërgesave nga emigrantët (në monedhë kombëtare) (%)		:	5.0 i	5.0 i	4.6 i	4.3 i	:

Financat publike

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Deficiti / suficiti i qeverisjes së përgjithshme, ndaj PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:
Borxhi i përgjithshëm bruto i qeverisjes ndaj PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:
Të ardhurat totale të qeverisë, si përqindje e PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:
Shpenzimet totale të qeverisë, si përqindje e PBB-së (%)		:	:	:	:	:	:

Tregues financiarë

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, ndaj PBB-së (%)		57.9 iw	63.9 iw	64.0 iw	54.1 iw	46.4 iw	40.6 piw
Borxhi i jashtëm bruto i gjithë ekonomisë, ndaj eksporteve totale (%)		198.6 w	283.1 w	205.3 w	145.0 w	119.8 w	111.6 w
Masa monetare M1 (kartëmonedha, monedha, depozita për përdorim të menjëhershëm, milion euro)		2 022.7 w	5 149.2 w	5 727.5 w	6 184.6 w	7 436.6 w	8 616.2 w
Kredia totale nga institucionet monetare financiare për rezidentët (e konsoliduar) (milion euro)		:	10 696.1	12 220.4	13 659.5	:	:

*Ndryshimi vjetor në detyrimet e sektorit financiar (%)		:	7.5	11.6	- 3.4	:	:
*Borxhi privat, i konsoliduar, ndaj PBB-së (%)		:	58.3	54.8	49.0 p	:	:
Normat e interesit: norma ditore ndërbankare, në vit (%)	4)	4.47 w	0.73 w	0.65 w	1.55 w	3.20 w	2.90 w
Kursi i këmbimit të euros: mesatarja e periudhës (1 euro = ... valutë kombëtare)		139.04 0	123.770	122.460	118.980	108.800	100.710
Indeksi efektiv i kursit të këmbimit të peshëzuar me tregtinë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
*Ndryshimi 3-vjeçar (T/T-3) në indeksin efektiv të kursit të këmbimit të peshëzuar me tregtinë, 42 vende (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Vlera e aktiveve rezervë (përfshirë arin) (milion euro)		:	654.9	938.9	- 71.8	911.5	262.5

Tregtia e jashtme e mallrave

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Vlera e importeve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		3 797	4 860	6 545	8 002	8 038	8 889
Vlera e eksporteve: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		1 531	2 190	3 012	4 090	4 044	3 698
Bilanci tregtar: të gjitha mallrat, të gjithë partnerët (milion euro)		- 2 267	- 2 670	- 3 533	- 3 912	- 3 994	- 5 191
Termat e tregtisë (indeksi i çmimeve të eksportit / indeksi i çmimeve të importit * 100) (numër)		98.4 iw	104.1 iw	104.5 iw	99.6 iw	97.6 iw	:
Pjesa e eksporteve drejt vendeve të BE-27 në vlerën e eksporteve totale (%)		75.5 iw	74.7 iw	72.2 iw	73.4 iw	70.8 iw	71.6 iw
Pjesa e importeve nga vendet e BE-27 në vlerën e importeve totale (%)		62.2 iw	57.9 iw	54.4 iw	51.6 iw	50.9 iw	51.4 iw

Demografia

Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
------------	------	------	------	------	------	------

Norma bruto e ndryshimit natyror të popullsisë (norma e rritjes natyrore): numri i lindjeve minus vdekjeve (për mijë banorë)		5.0	0.2	- 1.2	0.2	:	0.5
Norma e vdekshmërisë foshnjore: vdekjet e fëmijëve nën një vjeç (për mijë lindje të gjalla)		8.8	10.0	8.4	6.5	6.1	:
Pritshmëria e jetës në lindje: meshkuj (vite)		:	75.2	73.6	77.4	:	:
Pritshmëria e jetës në lindje: femra (vite)		:	79.6	77.7	80.9	:	:

Tregu i punës

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Norma e aktivitetit ekonomik për personat 20–64 vjeç: pjesa e popullsisë 20–64 vjeç që është ekonomikisht aktive (%)		71.9 ew	75.3 ew	75.1 ew	79.1 ew	81.4 w	:
Norma e punësimit për personat 20–64 vjeç: pjesa e popullsisë 20–64 vjeç që është në punë (%)		62.4 ew	66.3 ew	66.3 ew	70.4 ew	73.4 w	:
Norma e punësimit për meshkuj 20–64 vjeç (%)		70.1 ew	74.0 ew	74.6 ew	77.4 ew	79.6 w	:
Norma e punësimit për femra 20–64 vjeç (%)		54.9 ew	58.8 ew	58.3 ew	63.7 ew	67.5 w	:
Norma e punësimit për personat 55–64 vjeç: pjesa e popullsisë 55–64 vjeç që është në punë (%)		56.3 ew	60.3 ew	60.0 ew	67.4 ew	70.9 w	:
Punësimi sipas sektorëve kryesorë							
Bujqësia, pylltaria dhe peshkimi (%)		46.1 ew	36.1 ew	33.8 ew	33.9 ew	39.4 w	:
Industria (%)		9.1 ew	13.4 ew	13.8 ew	14.3 ew	11.8 w	:
Ndërtimi (%)		8.2 ew	7.0 ew	8.1 ew	7.6 ew	7.2 w	:
Shërbimet (%)		36.6 ew	43.5 ew	44.3 ew	44.2 ew	41.7 w	:

Persona të punësuar në sektorin publik si pjesë e punësimit total, moshat 20–64 vjeç (%)		15.7 ew	16.2 ew	17.1 ew	16.1 ew	15.9 w	:
Persona të punësuar në sektorin privat si pjesë e punësimit total, moshat 20–64 vjeç (%)		84.3 ew	83.8 ew	82.9 ew	83.9 ew	84.1 w	:
Norma e papunësisë: pjesa e forcës së punës që është e papunë (%)		13.4 ew	11.8 ew	11.6 ew	11.0 ew	9.6 w	:
Norma e papunësisë për meshkuj (%)		14.6 ew	11.6 ew	11.4 ew	10.6 ew	9.3 w	:
Norma e papunësisë për femra (%)		11.7 ew	12.0 ew	11.8 ew	11.4 ew	9.9 w	:
Norma e papunësisë së të rinjve: pjesa e forcës së punës 15–24 vjeç që është e papunë (%)		29.8 ew	26.5 ew	27.1 ew	24.9 ew	24.5 w	:
Norma e papunësisë afatgjatë: pjesa e forcës së punës që ka qenë e papunë për 12 muaj ose më shumë (%)		10.3 ew	7.0 ew	7.3 ew	7.4 ew	6.8 w	:
Norma e papunësisë për personat (25–64 vjeç) me arsim maksimalisht të mesëm të ulët (ISCED 0–2) (%)		10.5 ew	9.6 ew	9.8 ew	9.3 ew	8.3 w	:
Norma e papunësisë për personat (25–64 vjeç) me arsim të lartë (ISCED 5–8) (%)		:	10.0 ew	8.4 ew	8.4 ew	7.3 w	:

Kohezioni social	Shënim	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Paga dhe shpërblime mesatare mujore nominale (valutë kombëtare)	5)	50 093 ew	53 662 ew	57 190 ew	61 898 ew	70 539 ew	:
Indeksi i pagave dhe shpërblimeve reale (indeksi i pagave nominale pjesëtuar me indeksin e inflacionit) (2016 = 100)		:	105 ew	110 ew	111 ew	121 ew	:
Koeficienti Gini		:	33.2	33.0	:	:	:
Hendeku i varfërisë		:	26.0	25.5	:	:	:

Standardi i jetesës	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Numri i automjeteve për pasagjerë në raport me popullsinë (numër për mijë banorë)		:	191.0	212.0	232.0	292.0	328.0
Numri i abonimeve në telefoninë celulare në raport me popullsinë (numër për mijë banorë)		1 937.5 w	1 176.2 w	1 239.1 w	1 357.8 w	1 608.3 bw	1 415.1 w
Penetrimi i internetit celular (për 100 banorë)		:	70.4 w	73.1 w	77.0 w	86.7 bw	87.1 w
Penetrimi i internetit fiks (për 100 banorë)		6 w	17 w	20 w	21 w	26 bw	29 w

Infrastruktura	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Dendësia e rrjetit hekurudhor (linja në funksion për mijë km ²)		:	:	7.8 i	7.1 i	8.8 i	:
Gjatësia e autostradave (kilometra)		:	22	25	25	25	:

Arsimi, Inovacioni dhe Kërkimi	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Përqindja e personave 30–34 vjeç me arsim të lartë (ISCED 2011 nivelet 5–8)		14.3 ew	33.2 ew	32.1 ew	38.4 ew	36.5 w	:
Përqindja e personave 30–34 vjeç me arsim të lartë (ISCED 2011 nivelet 5–8), meshkuj		11.9 ew	26.7 ew	25.4 ew	31.9 ew	31.2 w	:
Përqindja e personave 30–34 vjeç me arsim të lartë (ISCED 2011 nivelet 5–8), femra		16.4 ew	40.0 ew	39.3 ew	45.5 ew	42.0 w	:
Pjesëmarrja në arsimin e hershëm (fëmijë 3 vjeç e lart)		:	79.9 w	76.9 w	82.2 w	82.9 w	:
Pjesëmarrja në arsimin e hershëm (fëmijë 3 vjeç e lart), meshkuj		:	81.9 w	78.5 w	83.1 w	84.3 w	:
Pjesëmarrja në arsimin e hershëm (fëmijë 3 vjeç e lart), femra		:	77.9 w	75.2 w	81.1 w	81.5 w	:
Nxënësit 15-vjeçarë me arritje të ulëta në lexim		52.3	:	:	73.7	:	:

Nxënësit 15-vjeçarë me arritje të ulëta në matematikë		60.7	:	:	73.9	:	:
Nxënësit 15-vjeçarë me arritje të ulëta në shkencë		53.1	:	:	67.4	:	:
Largimi i hershëm nga arsimi dhe trajnimi: pjesa e personave 18–24 vjeç me arsim maksimalisht të mesëm të ulët (ISCED 2011 niveli 2) që nuk ndjekin më arsimim ose trajnim		31.6 ew	15.6 w	16.8 w	15.5 w	15.7 w	:
Largimi i hershëm nga arsimi dhe trajnimi: pjesa e meshkujve 18–24 vjeç me arsim maksimalisht të mesëm të ulët (ISCED 2011 niveli 2) që nuk ndjekin më arsimim ose trajnim		:	:	:	:	:	:
Largimi i hershëm nga arsimi dhe trajnimi: pjesa e femrave 18–24 vjeç me arsim maksimalisht të mesëm të ulët (ISCED 2011 niveli 2) që nuk ndjekin më arsimim ose trajnim		:	:	:	:	:	:
Pjesa e personave 25–64 vjeç që kanë marrë pjesë në arsim dhe trajnim (4 javët e fundit)		1.1 w	0.7 w	0.8 w	0.6 w	0.7 w	:
Pjesa e personave 25–64 vjeç që kanë marrë pjesë në arsim dhe trajnim (4 javët e fundit), meshkuj		1.4 w	0.8 w	0.8 w	0.7 w	0.6 w	:
Pjesa e personave 25–64 vjeç që kanë marrë pjesë në arsim dhe trajnim (4 javët e fundit), femra		0.8 w	0.6 w	0.8 w	0.6 w	0.8 w	:
Ekspozimi i të diplomuarve në arsimin profesional (VET) ndaj të nxënësve në vendin e punës (% e popullsisë 20–34 vjeç)		:	:	2.5 w	2.4 w	1.6 w	:
Pjesa e individëve me te pakten aftësi digjitale bazë (% e popullsisë 16–74 vjeç)		:	:	23.8	:	23.3	:
Pjesa e individëve me te pakten aftësi digjitale bazë, meshkuj (% e popullsisë 16–74 vjeç)		:	:	24.2	:	25.1	:
Pjesa e individëve me te pakten aftësi digjitale bazë, femra (% e popullsisë 16–74 vjeç)		:	:	23.5	:	21.6	:
Shpenzimet publike për arsim ndaj PBB-së (%)		3.3 iw	3.3 iw	3.1 iw	2.9 iw	2.9 piw	:
Shpenzimet e brendshme bruto për K&Zh ndaj PBB-së (%)		:	:	0.19	0.20	:	:

Shpenzimet ose fondet buxhetore të qeverisë për K&Zh (GBAORD), si përqindje e PBB-së (%)		:	C	:	0.06	0.19	:
Përqindja e familjeve që kanë akses në internet në shtëpi (%)		:	87.2	90.9	98.4	97.7	98.2

Mjedisi

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Indeksi i emetimeve të gazeve serrë, ekuivalente CO ₂ (1990 = 100)		:	:	:	:	:	:
Intensiteti energjetik i ekonomisë (kg ekuivalent naftë për 1 000 euro PBB me çmime konstante të vitit 2015)		207.1	196.3	:	:	:	:
Energjia elektrike e prodhuar nga burime të rinovueshme ndaj konsumit total të energjisë elektrike (%)		72.4	100.0	94.4	103.0	105.4	:
Pjesa e transportit rrugor në transportin e brendshëm të mallrave (bazuar në ton-km) (%)		:	:	:	:	:	:

Energjia

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
Prodhimi primar i të gjitha produkteve energjetike (mijë TNE)		1 670	1 494	1 823	1 607	1 799	:
Prodhimi primar i naftës bruto (mijë TNE)		1 031	758	712	657	642	:
Prodhimi primar i lëndëve të ngurta djegëse (mijë TNE)		1	69	131	148	188	:
Prodhimi primar i gazit (mijë TNE)		13	41	44	38	38	:
Importet neto të të gjitha produkteve energjetike (mijë TNE)		316 i	793 i	553 i	705 i	488 i	:
Konsumi i përgjithshëm energjetik i brendshëm (mijë TNE)		2 023	2 183	2 298	2 209	2 202	:
Prodhimi i përgjithshëm i energjisë elektrike (Gëh)		4 725	5 313	8 963	7 003	9 006	:

Bujqësia

	Shëni m	2012	2020	2021	2022	2023	2024
--	------------	------	------	------	------	------	------

Indeksi i volumit të prodhimit bujqësor (me çmimet e prodhuesit) (2015 = 100)		:	:	:	:	:	:
Sipërfaqja bujqësore e përdorur (mijë hektarë)		1 195.3	1 165.7	1 165.6	1 164.4	1 044.6	1 126.5
Numri i bagëtive: gjedhë të gjalla (mijë krerë, në fund të periudhës)		:	362.6	336.8	297.7	263.4	272.0
Numri i bagëtive: derra të gjallë (mijë krerë, në fund të periudhës)		:	158.4	159.2	137.3	114.8	104.0
Numri i bagëtive: dele dhe dhi të gjalla (mijë krerë, në fund të periudhës)		:	2 332.2 i	2 255.8 i	2 093.3 i	1 846.5 i	1 791.7 i
Qumështi i papërpunuar i disponueshëm në ferma (mijë ton)		:	:	:	:	:	:
Prodhimi i kulturave të korrura: drithëra (duke përfshirë orizin) (mijë ton)		697.4	684.0	691.4	690.9	701.3	649.9
Prodhimi i kulturave të korrura: panxhar sheqeri (mijë ton)		:	27.0	24.4	21.3	20.4	17.8
Prodhimi i kulturave të korrura: perime (mijë ton)		:	:	:	:	:	:

Burimi: Eurostat dhe/ose autoritetet statistikore në Shqipëri

= jo e disponueshme

b = ndërprerje në seri

C = vlerë konfidenciale

d = përkufizimi ndryshon

e = vlerë e vlerësuar

p = paraprake

i = vlerësim i Eurostat-it

ë= të dhëna të furnizuara nga autoriteti kombëtar

statistikor dhe të publikuara “siç janë”, pa asnjë garanci në lidhje me cilësinë e tyre ose përputhjen me metodologjinë statistikore të BE-së

* = tregues i Procedurës së Pabarazive

Makroekonomike (PPM)

Shënime shpjeguese:

- 1) Bazuar në NACE Rev. 2. Mbulesa përfshin Seksionet B deri në D
 - 2) Bazuar në NACE Rev. 2. Mbulesa përfshin Divizionet 05 deri në 82 dhe 95.
 - 3) Të dhënat përfshijnë të gjitha klasat e madhësisë, përfshirë ndërmarrjet e mëdha, për të gjitha seritë kohore.
 - 4) Mesatarja vjetore e normës Tribor – norma ndërbankare për huatë brenda natës.
 - 5) Vetëm sektori publik.
- : = jo e disponueshme